

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTESISË
ПРАВЕH ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

PUNIMI I MAGJISTRATURËS

Teza:

**Fitimi, realizimi dhe mbrojta e të drejtave nga pronësia
industriale sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë,
duke krahasuar me atë të Unionit Evropian**

Mentori:
Prof.Dr.Alba Dumi

Punoi/Kandidati
Valzon Limani

Id:108913

DEKLARATË E ORIGINALITETIT

Unë Valzon Limani , student i Universitetit të Evropës Juglindore – Tetovë në studimet pasdiplomike pranë Fakultetit Juridik drejtimi Civil, deklaroj se ky punim i magjistraturës është rezultat i punës sime kërkimore e shkencore, publikimeve dhe botimeve të tjera u jam referuar duke i paraqitur të dhënat e tyre në fusnota, përfshirë këtu edhe burimet nga interneti dhe të dhënave statistikore të marura prej institucioneve përkatëse .

ABSTRAKTI

Duket patur parasysh faktin, se si çdo vend evropian edhe Maqedonia posedon ligje me të cilat rregullohet çështja e pronësis industriale, zgjedha pikërisht këtë temë për punimin tim pasi që në shikim të parë duket gjithçka në rregulluar siç duhet dhe e thjeshtë.

Analizimi i mëtejshëm i çështjeve me të cilat rregullohen në bazë të ligjit mbi pronësin industriale, shifet se na, si shumica e vendeve të Evropës Juglindore, kemi mangësi në zbatim konkret në teren, ku vjen në dukje një fakt se në Maqedoni kemi diku mbi 60% mos thënë më shumë, pirateri të produkteve, kemi shkelje, mos respektimi i markës tregëtare, treguesi gjeografik i produkteve dhe ky është një fakt i cili me të vërtet na shqetson.

Fakti i Pirateris është një luftë e cila po zhvillohet edhe në vendet perendimore, duke ditur se me zhvillimin e hovëshëm të teknologjisë kjo sfidë është vështirësuar. Gjersa vendi jonë pretendon me vite të tëra antarsimin në këtë union të madhë të vendeve të zhvilluara, duhet që të jemi të bashkuar edhe në luftën për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale.

Në tregun tonë shkelen hapur të drejtat nga pronësia industriale porë veprimet që ndërmeren për parandalimin e tyre janë shumë të pakta, mos thënë aspak.

Njëkohësisht motivimi i shpikësve të rrinjë për të patentuar idet, inovacionet e tyre dhe krijimi i kushteve që ato shpikje të jenë të zbatueshme në industrinë e vendit apo ndërkombëtare, duke ju garantuar mbrojtje dhe mbështetje maksimale.

Në kuadër të këtij punimi njëkohësisht do të shqyrtohen edhe problematikat procedurale në lidhje me proceduar e regjistrimit, krijimit, si çdoher duke patur si bazë legjislacionin e vendit, konventat ndërkombëtare, për përmisimet e mundshme në sferën e pronësis industriale në Republikën e Maqedonisë.

Besoj që me këtë punim, dua që të kontribuoj në shoqërin tonë, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet tona që dalin në lidhje me pronësin industriale dhe njëkohsisht do të nxis interes tek lexuesit që të njihen më së afërmi në lidhje me temën “Fitimi, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave nga pronësia industriale sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë, duke krahasuar me atë të Unionit Evropian.”

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	10
------------	----

KAPITULLI I PARË

Pronësia industriale, instrumentet dhe organizatat ndërkombëtare

1.Kuptimi dhe rëndësia e Pronësisë Industriale	13
1.1. Të drejtat e autorit (copyright)	13
1.2. Pronësia industriale	15
2. E drejta subjektive e pronësis industriale.....	16
2.1. Subjektet e pronësis shtetërore	17
2.2 Objektet e pronësis shtetërore	18
2.3. Pronësia Private	18
2.4. Bashkpronësia në subjektet me pronësi private.	19
3. Instrumentet ndërkombtare në lidhje me pronësin industriale	19
3.1. Burimet e brendëshme	19
3.2. Marveshjet ndërkombtare mbi pronësin industriale.....	21
3.2.1 Marveshja e TRIPS.....	21
3.2.2 Konventa Parisit për mbrojtjen e pronësisë industrial nga Marsi i vitit 1883.....	24
3.2.3. Marveshja ndërkombëtare e Madridit për rregjistrimin e Markave Tregëtare (1891), si dhe Protokoli i Madridit.	28
3.2.4. Marveshja e Hagës mbi rregjistrimin ndërkombëtar të dizajnit industrial.....	30
3.2.5 Marveshja e Lokranos mbi klasifikimin e dizajnit industrial.....	31

3.2.6 Marveshja e Singaporit për të drejtën e Markave Tregëtare	32
3.2.7 Marveshja e Nicës mbi klasifikimin ndërkombëtar të markave tregtare të mallrave dhe shërbimeve (e sjellur në Nicë, Francë më 1957).	33
3.2.8 Marveshja e Vjenës për klasifikimin e elementeve figurative të markave tregëtrare.....	35
3.2.9 Marveshja e bashkpunimit në fushën e patentave (PCT).....	35
3.2.10 Marëveshja ndërkombëtare e Strasburgut për klasifikimin e Patentave (1971 e ndryshuar më 1979).	36
3.2.11 Marveshja e të drejtave mbi Patentat (PLT).	37
3.3 Regullativi dhe direktivat e Unionit Evropjan mbi Pronësin industriale...37	
3.3.1 Direktiva e Paramentit Evropjan dhe Këshillit mbi zbatimin e të drejtës së pronësis intelektuale 48/2004 EC	38
3.3.2 Direktiva për mbrojtje juridike të zbulimeve bioteknologjike 98/44/EC	39
3.3.3 Rregullativa e Këshillit të Evropës <i>EEC 1768/92 në lidhje me dhënjen e certifikatave shtesë në lidhje me mbrojtjen e prodhimeve medicinale</i>	40
3.3.4 Direktiva e këshillit EEC 89/104 për harmonizim të legjislacionit të vendeve antare në lidhje me markat tregtare e ndryshuar me vendim të këshillit EEC92/10	40
3.3.5 Direktiva e Parlamentit Evropjan 98/71/EC mbi mbrojtjen e të drejtave nga dizajni industrial	41
4. Organizatat ndërkombëtare në lidhje me fushën e pronësi industriale ..	41
4.1. Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale (OBPI ang. WIPO).....	42
4.2. Zyra Evropiane e Patentave <i>EPO-</i> (European Patent Office)	45

4.3. Zyra Evropiane për Pronësi Intelektuale (EUIPO-Europen Union Intellectual Property Office).....	46
4.4. Asociacioni ndërkombëtar për mbrojtje të Pronësisë Intelektuale (AIPI)	47
4.5. INTA (Asociacioni ndërkombëtar i markave Tregtare).....	48
5. Biodiversiteti dhe lidhëshmeria me pronësin industriale	48

KAPITULLI DYTË

Koncepti mbi patentat, njohja mbi Entin për Pronësi industriale

2.1. Historiku dhe koncepti mbi patentat	54
2.2. Procesi i aplikimit të patentave (sipas Ligjit pr pronësi industriale të Maqedonisë).....	57
2.3. Rëndësia e informimit mbi patentat dhe ndikim në zhvillimin ekonomik	63
2.4 Llojet e Patentave	66
2.4.1 Revokimi i Patentës.....	70
2.5 Enti shtetrorë për pronësi industriale të Maqedonis (ESHPI)	70

KAPITULLI I TRETË

Markat tregtare procesi i regjistrimit, falcifikimi si një dukuri negative

3.1. Markat tregtare historiku dhe kuptimi i tyre	75
3.2 Procesi i regjistrimit dhe llojet e markave tregtare	79
3.2.2 Llojet e markave tregtare	86
3.3 Markat e gjeneratës së re, sekreti tregtarë dhe know-how të	90
3.3.1 Know how-të.....	96

3.3.2 Sekreti Tregtar	96
3.4 Markatregtare domejnat e internetit (adresat e internetit).	101
3.5 Falcifikimi si dukuri e kriminalitetit Ekonomik.	105
3.5.1. Historiku i falsifikimit.	105
3.5.2. Kuptimi dhe definimi i falsifikimit.	106
3.5.3. Ndikimi i falsifikimit të markave të produkteve në Ekonomin e vendit	107

KAPITULLI I KATËRT

Dizajni industrial, emri gjeografik si dhe mbrojtja ligjore e të drejtave nga pronësia industriale në vendin tonë

4.1 Kuptimi dhe historiku i Dizajnit industrial	114
4.2. Procesi i regjistrimit të dizajnit industrial.....	117
4.3. Procesi i regjistrimit të dizajnit industrial pranë Entit shtetrorë për pronësi industriale të Maqedonisë (ESHPI).	118
4.3.1. Procesi i regjistrimit të dizajnit industrial sipas marrëveshjes së Hagës mbi dizajnin industrial.....	124
4.3.2 Procesi i regjistrimit të dizajnit industrial pranë Zyrës Evropiane për Pronësi Industriale(EUIPO).....	125
4.4 Emri gjeografik.....	125
4.5. Mbrojtje e të drejtave nga pronësia industriale në Maqedoni	130
4.5.1 Mbrojtja Civile	131
4.5.2. Dënimi Civil dhe Penal.....	132
4.6 Analizë e Punës së doganës dhe Inspektoratit Shtetrorë të tregut në mbrojtje të drejtave nga Pronësia Industriale.....	133

4.6.1. Inspektorati Shtetërorë i Tregut	136
4.6.2 Analizë e punës së inspektoratit shtetrorë të tregut në bazë të raporteve vjetore gjatë periudhës 2010-2015.	140
PËRFUNDIMI.....	144
LITERATURA.....	148

HYRJE

Për të folur për pronësin industriale së pari duhet të bëjm një hyrje të shkurtër mbi **pronësin intelektual**, dhe si zakonisht shtrojm pyetjen se në fakt çka nënkuptojmë me pronësia intelektuale?

Pronësia intelektuale ka të bëj me të drejtat ligjore që burojnë nga aktiviteti krijues i njeriut në fushën industriale, shkencore, letrare dhe artistike. Pronësia Intelektuale tradicionalisht ndahet në dy degë:

1. **Të drejta e autorit (Copyright)** ku me termin e drejta e autorit nënkuptojm atë pjesë të legjislacionit që siguron mbrojtjen për një vepër të caktuar duke i garantuar autorit të saj një grumbull të drejtash ekskluzive dhe duke ua ndaluar të tjerëve për një afat të caktuar kohorë. Ku pas përfundimit të këtij afati të caktuar vepra kalon në pronësi të shoqëris, dhe për shfrytëzimin e saj nuk nevojitet leje nga autori i veprës. E drejta e autorit shërben si mbrojtje dhe inspirim për autorin që munda të ketë një vlerë të caktuar morale dhe ekonomike.

2. **Pronësia Industriale** është një fushë e gjërë e cila në vete ngërthen disa nënkategori të cilat variojnë varësisht nga legjislacioni i vendit. Në vendi tonë dhe njëkohësisht në vendet fqinje si nëngrupime të pronësis industriale janë: **Patenta, Marka tregtare, Dizajni industrial , Shenja e prejardhjes dhe Shenja gjeografike**¹. Ku si veçori e përbashkët e të gjitha këtyre formave të mbrojtjes së pronësis industriale është se objektet e krijimtarisë intelektuale, që kërkohet të mbrohen, rregjistrohen nga organet kompetente, kundrejt hapjes për publikun nga pronari i tyre, në përputhje me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni përkatës .

Me zhvillimin e hovshëm të industrisë, si dhe përsoshmëris gjat procesit të punës me futjen e teknologjive të reja lindën edhe idetë të cilat filluan të gjenin zbatim në këtë fushë, sollën nevojën për mbrojtjen e tyre, duke sjellur rregulla, pastaj ligje të cilat në tërësi rregullojnë çështjen e pronësis industriale. Pothuajse të gjitha vendet që karakterizohen nga përtrirja e industrisë kanë ligje të cilat rregullojnë çështjen e kopjimit të shpikjeve, identifikuar simbolet, shprehjet krijuese, që nxisin inovacionet.

¹ [Ligji për pronësi industriale](#) gazeta zyrtare e R.Maqedonisë nr:47/2002,42/2003,09/2006 dhe 79/2007

Si hulumtim i kësaj teme ka të bëj pikërisht me mënyrat se si fitohet, realizohet dhe mbrohet, në kuadër të legjislacionit të vendit tone konkretisht Republika e Maqedonis, duke krahasuar me atë të vendeve fqinje, si dhe atë të vendeve të Unionit Evropian si shembull dhe si model. Një ndër problemet më të theksuar është mbrojtja e pronësis industriale, me theks të veçant Markat tregëtare nga produktet pirate, duke cenuar edhe të drejtën e konsumatorve, krijimi i hutis gjat procesit të blerjes.

Fakti i Pirateris është një luft e cila po zhvillohet edhe në vendet perendimore, duke ditur se me zhvillimin e teknologjisë kjo sfidë është vështirësuar, gjersa ne si vend i cili ka aspirate për antarsim në këtë Bashkësi të madhe të vendeve të zhvilluara², duhet që të jemi të bashkuar edhe në luftën për mbrojtjen e Pronësis industriale. Në vendin tonë shkelen hapur të drejtat nga pronësia industriale porë veprimet që ndërmeren nga intitucionet kompetente jan hiç më shumë se formale. Duke luftuar këtë fenomen kontribuojm për krijimin e një standardi mbi produktet e mirëfillta, mos haruar edhe motivimin e shpikësve të rrinjë për të patentuar idet, inovacionet e tyre dhe krijimin e kushteve që ato shpikje të gjejnë zbatim në industrinë e vendit pse Jo edhe në tregun ndërkombëtar, duke ju garantuar kushte dhe mbështetje maksimale.

² **Bashkimi Evropian** (*shkurtesa shqip: BE, zyrtarisht: EU^[4]*) është një bashkësi e disa shteteve Evropiane e themeluar me qëllim të lirisë së qarkullimit të mallrave (https://sq.wikipedia.org/wiki/Bashkimi_Evropian).

Mcccclxxiii. die xviij Martij. 32.

Sap Consilio. vi.
 p. Marzuz Cor mil.
 p. Ludomaz fustar tota
 p. paulus amanoa
 p. Zuzardus iustm mil.
 p. Vital' lardo dacti mil.

Sap tre firme.
 p. Anton' de puolus
 p. Ludomaz fustar
 p. Zachar' Barbaro mil.
 p. Endricus t'zuziano.

Sono i questa Cita / et anche ala zornada p la qrandeza et bonta da
 Concorre homeni da diuersi bande / et acutissimi frategni / apti ad excogetar
 et trouar varij ingegnosi artificij. Et sel fosse promisto / che le opere et artificij
 trouade da loro . altri viste che le haneffeno / no podesseno farle se tuoz honor
 suo / Simel homeni exercitaziano lingegno / troueriano / et fariano & le chosse
 che fariano de no picola vtilita et beneficio al stato nro . pero L andara parte
 che p auctorita de questo ofero / chadany che fara i questa Cita alqun nuouo
 et ingegnoso artificio / no facto panti nel dno nro / Reducto chei fara a
 pfectio / Et che el se possi vsar / et exercitar / sia retruido darlo i nota al officio
 di nri proueditori de Comm. Siando prohibito a chadany altro i alguna terza
 e luogo nro / far alqun altro artificio / ad imagine et similitudine & quello senza
 consentimeto et licentia del auctor fino ad ani. x. Et tamen se alqun el fesse
 L auctor et truentor pedito / habia liberta poderlo citar achadany officio de
 questa Cita / dalenal officio el dicto / che hanesse cotrafuto / Sia astreto apagarli
 duc. Cento / et lartificio subito sia destrutto . Siando po i liberta de la nra signor
 ad ogni suo praxer / tuoz et vsar nel suo bisogni chadany di dicti artificij / et
 instrumeti / Cum questa po condition / che altri cha i auctori no li possi exercitar .

de parte ——— 116
 de non ——— 10 non sine ——— 3

3

³ Statuti Venecian Patentave është një ndër hapat e parë për mbrojtjen e shpikjeve, miratuar nga Senati i Venedikut në 1474, është një nga sistemet më të hershme patentave në botë. (<https://www.wired.com/2012/03/march-19-1474-venice-enacts-a-patently-original-idea/>).

KAPITULLI I PARË

Pronësia industriale, instrumentet dhe organizatat ndërkombëtare

1.Kuptimi dhe rëndësia e Pronësisë Industriale

Pronësia industriale nënkuptohet në kuptimin më të gjerë dhe ka të bëjë jo vetëm me industrinë dhe tregtinë në kuptimin e plotë të fjalës, por edhe me degët e industrisë bujqësore dhe ekstraktive dhe ndaj të gjitha produkteve të fabrikuara apo natyrore si për shembull: vena, drithëra, gjethet e duhanit, pemët, bagëtinë, mineralet, ujërat minerale, birra, lulet, mielli.⁴

Pikërisht zgjedhja nën nr 2 paragrafi 3 i Konventës së Parisit, pasi që siç dimë Pronësia industriale është lëmi e veçantë e pronësisë intelektuale.

Të rikujtojmë se Pronësia intelektuale ndahet në:

1. **Të drejtat e Autorit (copyright)**
2. **Pronësia industriale**

Të gjitha vendet që karakterizohen nga përtëritja e industrive të tyre kanë ligje të tilla që duke rregulluar kopjimin e shpikjeve dhe duke identifikuar simbolet dhe shprehjet krijuese, njëkohësisht nxisin edhe inovacionet .

Pronësia intelektuale ka shumë tipare të përbashkëta me pronën e luajtshme dhe të paluajtshme. E përbashkëta është **prona**, pra si çdo lloj prone edhe pronësia intelektuale mundet të blihet, shitet, licencohet dhe dhurohet. Prona intelektuale është vlerë e cila zotëruesit të saj i jep të drejt të parandaloj përdorimin, shitjen apo shfrytëzimin e pa autorizuar nga pronari. Dallimi kyç i pronës intelektuale nga format tjera të pronësisë është se pronësia intelektuale nuk mund të identifikohet me parametra fizik.

1.1. Të drejtat e autorit (copyright)

Lindja e të drejtës së autorit është e lidhur ngushtë me paraqitjen e teknologjisë së shtypit si metodë e re e të shkruarit dhe kopjuarit, që për herë të parë u shfaq në Angli. Para se të fillonte të përdorej shtypi, për të kopjuar

⁴ Konventa e Parisit për mbrojtjen e Pronësisë Industrial (Neni 1 p3) nga 30 Mars 1883.

shkrimin përkatësisht punën e dikujt tjetër është dashur që të investohet shumë kohë dhe mund, kështu që nuk kishte arsye për ndonjë shqetësim të madh për kopjimet ilegale, apo si filloi të quhej më vonë piraterinë, ngase kopjimet dhe shumëzimet e pa autorizuar ishin përjashtim i rrallë.

Teknologjia e shtypit bëri një kthesë pozitive në sferën e të shkruarit duke krijuar lehtësime të mëdha, shkurtim të kohës e mundit dhe zvogëlim të shpenzimeve për të shkruar një libër apo një produkt tjetër. Mundësitë e mëdha të teknologjisë së shtypit, filluan ti keqpërdornin kopjuesit dhe tregtarët ilegal të veprave të ndryshme, të cilët filluan të përdorin metoda të reja më të avancuara të piraterisë, për të kopjuar e shumëzuar edhe më lehtë, më shpejt dhe me çmim më të lirë, një libër apo një produkt tjetër, duke cënuar kështu të drejtat morale dhe ekonomike të autorit.

Me qëllim të parandalimit të piraterisë, shkruesit e librave, tipografët, libërlidhësit dhe shitësit e librave në Angli u organizuan me një shoqatë që njihet si “Shoqata e Librave”.

siguroi për veti monopolin për veprimtarin e botimeve, kurse shkrimtarët paguheshin vetëm për punën e tyre dhe nuk gëzonin asnjë të drejtë për krijimet e tyre. Ky monopol i “Shoqatës së librave” vazhdoi deri në vitin 1709, kur Anglia aprovoj një akt ligjor, që njihet si Ligji i parë për të Drejtën e Autorit, sipas të cilit të drejtat ekskluzive për punën e tyre u takojnë autorëve e jo botuesve **Statuate of Anne**⁵

E drejta e autorit është një e drejtë ekskluzive për të riprodhuar një vepër origjinale me një autorësi të caktuar në çfarëdo mjeti material, për të përgatitur punë me prejardhje nga baza e veprës origjinale si dhe për ta e shfaqur veprën në rastin kurë bëhet fjalë për vepra muzikore, dramatike, koreografike si dhe skulpturore. Kjo e drejtë është tërësia e normave juridike që i përkasin autorit mbi veprës artistike, me qëllim mbrojtjen, pas vendosjes në qarkullim civil të saj. Në këtë kuadër autori, nëpërmjet dispozitave ligjore dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara gëzon një arsenal juridik të përshtatshëm dhe mbrojtës, në mënyrë që vepra e tij artistike “të jetojë.

Si çdo vend edhe Maqedonia të drejta e autorit janë të rregulluar me akte ligjore⁶, ku autorit i jep të drejt absolute për veprën e tij, për benifitet që ai përfiton, gjatë jetës së tij si dhe 50 vite pas vdekjes së tij, ku pas kalimit të periudhës së caktuar këto vepra kalojnë në pronësi publike.

⁵ <https://www.britannica.com/topic/copyright#ref157947>

⁶Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta "Gazeta zyrtare e Republikës Maqedoni "No.115 nga 31.08.2010.

1.2. Pronësia industriale

Termi **Industrial** së pari doli në pah në Konventën e Parisit për mbrojtjen të Pronësisë Industriale⁷. Kuptimi i pronësisë industriale nuk është aq i ngushtë sa edhe emërimi, që mer pra pronësia industriale që do të thotë jo vetëm aplikimi, zbatueshmëri në industri, dhe tregti pore gjen zbatim edhe në agrikulturë, në industrinë e nxjerrjes dhe njëkohësisht edhe produktet si verërat, gruri, gjethet e duhanit, frutat, minerale të ndryshme, birra, lule të ndryshme.

Lënda e mbrojtëse sipas Konferencës së Hagës⁸ janë Patenta, Marka tregtare, Dizajni industrial, Modelet e shfrytëzueshme në industri, Emri tregtar, Shenja e origjinës së produktit, Treguesi gjeografik si dhe luftimi i konkurrencës jo lojale. Viteve të fundit janë inkorporuar edhe **know-how** të.

Me sjelljen e Marrëveshjes të TRIPSIT⁹ (Aspekte të tregtisë, që lidhen me pronësinë intelektuale) që ka për qëllim mbrojtja dhe ushtrimi i të drejtave të pronësisë industriale duhet të kontribuoj për avancimin e inovacioneve teknologjike dhe për bartjen dhe përhapjen e teknologjisë, të përfitimeve të përbashkëta të prodhuesve dhe përdoruesve të njohurive teknologjike dhe në mënyrë që kontribuon në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik si dhe për arritjen e baraspeshës midis të drejtave dhe detyrimeve¹⁰.

Me zhvillim e hovshëm të teknologjisë dhe futjen e internetin në jetën e përditshme, si një ndër mjetet kryesore të punës me zhvillimin e marketingut, dhe biznesit online bëhet përpjekje për futjen e domenit (domani name) në grupimin e pronësisë industriale.

Karakteristik tjetër për këtë grup të drejtave shikuar nga aspekti i rregjistrimit dhe mbrojtjes është se mund të ndahen në dy grupim edhe atë :

Janë ato të drejta të cilat janë të rregjistruara dhe njëkohësisht të mbrojtura

⁷ Konventa e Parisit mbi Pronësinë Industriale 20 Mars,1883, artikulli 1 pjs.3.

⁸ The **Hague Act (1925)**.

⁹ Marrëveshja për aspektin tregtar të drejtave të pronësisë industriale në Marakesh, Maroko 15 Prill 1994.

¹⁰ Neni 7(Marrëveshja për aspektet tregtare të drejtave të Pronësisë industriale në Marakesh 15,Prill 1994).

1. **Patentat**
2. **Marka tregtare**
3. **Dizajni industrial**
4. **Treguesi gjeografik**
5. **Internet domain**

Ndërsa në grupimin e dyt bëjnë pjesë ata të drejta të cilat nuk regjistrohen si

1. **Sekreti tregëtar** (informata e pazbuluar)
2. **Know-how** të.

Këta të drejta mbrohen vetëm mbi rregulla e mbrojtjes së konkurrencës jo lojale, ku gjat punimit do të ndalemi në pika të veçanta të analizojm dhe të shqyrtojmë në veçanti.

Si konkluzion mbi pronësisë industriale, nënkuptojmë se kjo formë pronësie ka shumë tipare të përbashkëta me pronën e luajtshme dhe të paluajtshme. Për shembull prona industriale si e tillë ajo mund të blihet, shitet, të licencohet, të shkëmbehet ose të jepet falas (dhurohet), sikurse çdo formë tjetër prone. Përveç kësaj, zotëruesi i pronës gëzon të drejtën që të parandaloj përdorimin ose shitjen e pa autorizuar të pronës së vet. Megjithatë, dallimi më i dukshëm midis pronës industriale dhe formave të tjera të pronësisë është se prona **industriale** është **jomateriale** që do të thot se ajo nuk mund të përkufizohet ose të identifikohet me parametra fizikë. Për tu mbrojtur duhet të shprehet në disa forma të dallueshme.

2. E drejta subjektive e pronësisë industriale

Në një përcaktim të përgjithshëm të së drejtës të pronësisë duhet të përfshihet tiparet e përgjithshme kryesore të cilat janë specifike për të drejtën e pronësisë duke përfshirë të gjitha formacionet shoqërore dhe për të gjitha llojet dhe format e pronësisë brenda të njëjtit formacion dhe të cilat e dallojnë atë në mënyrë të prerë nga të drejtat subjektive civile në lidhje me sendet. E drejta e pronësisë ndryshon nga të drejtat e tjera subjektive, veçanarisht nga e drejta e detyrimit, dhe sa i përket karkaterit absolut dhe real. Prona fitohet me dhurim, trashigimi, dhe me blerje, dhe me çdo formë klasike që parashef ligji i vendit të caktuar. E drejta e pronësisë i referohet një prone të caktuar që në një interpretim të gjërë përfshin çdo gjë materiale dhe jo materiale. E drejta e pronësisë ndahet në dy drejtime si një e drejtë objektive, dhe si një e drejtë

subjektiv ku në kuptimin objektiv e drejta e pronësis paraqet një tërësi normash juridike që rregullojnë marrëdhënjet e pronësis, ndërsa në kuptimin subjektiv e drejta e pronësis i përket një personi (fizik apo juridik), të caktuar, si pronarë, të një pasurie (sendi) të caktuar.

Llojet dhe format e pronësisë

- Prona shtetërore
- Prona private

Prona shtetërore, në periudhën e monizmit, në disa vende nuk ekzistojnë fare prona private, gati se gjithçka është pronë shtetërore, në fakt në organizimin e till konsiderohej se gjithçka është e popullit. Një sistem i till totalitar funksiononte në Shqipëri, ndërsa më liberale edhe pse shumica e pronës ishte shtetërore, mirpo egzistonte edhe pronësia private, në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë ku bënte pjesë edhe Republika e Maqedonisë që konsiderohej një miks i pronës shtetërore, dhe asaj private. Ku shteti përveç funksionit si sistem politik, ka rol të veçant edhe subjekt i së drejtës së pronësis. Dhe subjektet kyçe për ekonomin e vendit ishin në pronësi të shtetit.

Një sistem i tillë është jo funksional me ndryshimin e sistemit politik, nga ai monist në atë demokratik. Ku roli i shtetit në ekonomin e lirë është sigurimi i garancis për zhvillimin ekonomik të vendit.

2.1. Subjektet e pronësis shtetërore

Në ekonomin e kontrolluar nga Shteti ku pronësia subjekt i së drejtës është vetëm shteti, ku ekzistojnë edhe në ekonominë e globalizimit kemi të bëjmë me subjekte të cilat janë në pronësi shtetërore. Subjektet kyçe që kanë të bëjnë me vitalitetin dhe veprimtaritë që janë me rëndësi të veçant si energjetika, hekurudhat, menaxhimi i xeheve, menaxhimi i shërbimeve publike për qytetarët, edhe ditëve të sodit janë në pronësi shtetërore. Pasi që paraqesin rëndësi të veçant për vendin dhe qytetarët e saj. Pra ditëve të sodit nuk mund të themi se kemi të bëjmë me një sistem të pastër të pronësis private, pasi që kemi edhe subjekte me pronësi shtetërore dhe paraqet një sistem mix të pronësis.

2.2 Objektet e pronësis shtetërore

Për objektet që mund të jenë në pronësi shtetërore nuk janë të kufizuara dhe kemi disa që janë vetëm në pronë të shtetit . Kalimi i këtyre objekteve në atë në subjekte private bëhet në raste të veçanta me ligj, si të tilla janë subjektet nga fusha e energjetikës, minierave, naftës , gazit, postat, portet, rrugët. Si burime kyçe të krijimit të pronësis shtetërore janë taksat dhe tatimet. Poashtu administrimi i pronës shtetërore mund të administrohet nga vet shteti apo ndërmarje të krijuara nga organet shtetërore, administrimi i pasurisë shtetërore u është besuar organeve shtetërore të caktuara, si dhe organeve të pushtetit lokal, ku janë të ngarkuara me drejtimin ku veprojnë si persona juridik më vete. Veprimtaria e subjekteve shtetërore, është e ndryshme duke nisur nga prodhimtaria, tregtia , ofrimi i shërbimeve dhe si çdo subjekt tjetër i krijuar është realizimi i fitimit. Siç theksuam në fillim nuk kemi ekonomi të pastër me pronësi shtetërore apo private, porë në ekonominë moderne kemi një gërshetim sa i përket pronësis edhe atë pronësia private, dhe ajo shtetërore.

2.3. Pronësia Private

Pronësia private buron nga zotërimi i mjeteve të prodhimit të cilat individi apo një grupim personash që kontribuon për të nxjerë produkte apo shërbime për interes të tij personal apo të grupit të caktuar ku si qëllim kyç është realizimi i fitimit. Legjislacioni nuk kufizon objektet që përbëjnë pronën private, ku në ekonominë e lirë të tregut gati se çdo fushë e ekonomisë është e lirë për privatizim, si sektori bankar, industrial, artizanal, buqësis, ndërtimtari, shërbime transportit publik, tregtisë së brendëshme apo të jashtëme, duke patur kufizime në disa pjesë të ekonomisë kombëtare, si energjetika, postat, telekomunikacioni, transporti hekurudhor, porë edhe këta sektore të ekonomisë edhe pse janë me rëndësi kombëtare, kan filluar apo janë në proces të privatizimit. Në vendin tonë gati se gjithçka ka kaluar në privatizim, apo në proces të privatizimit, edhe pse sipas regullave ekonomike, sektorët të cilët janë në rëndësi të veçant për qytarët duhet që jenë në administrim të shtetit, duke rruajtur dhe garantuar të drejtat primare të qytetarit. Subjekte të pronësisë private mund të jenë persona fizik dhe juridik, këto subjekte mund të jenë qytetarë apo subjekte vendore, apo të jashtëm. Organizimi i subjekteve të pronësis është i përcaktuar edhe në bazë të legjislacionit, ku subjektet për të ushtruar veprimtarinë e tyre duhet të rregjistrohen në regjistrin qendror. Dhe

sipas veprimtarisë që ushtrojnë, kemi të bëjmë me ndërmarrje të individëve, bashkimi i dy individëve paraqet një shoqëri, në vendin tonë më të shpeshta format organizative të subjekteve është Shoqërit me Përgjegjësi të Kufizuara(shpk), ndoshta edhe nga forma dhe detyrimet është më e lirë dhe më e përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë, Poashtu kemi edhe shoqërit aksionare, ku si formë e organizimit janë kryesisht subjektet e mesme dhe të mëdha, si në sektorin e industrisë, sektorin bankarë. Ku secila nga këta veprimtari ka karakteristikat e veta.

2.4. Bashkpronësia në subjektet me pronësi private.

Një nga format më të thjeshta të organizimit të subjekteve ku kemi të bëjmë me dy e më tepër pronarë është bashkpronësia në pjesë ku është e përacktuar. Në kapitalin apo materialet, kemi të bëjmë me ndarje të përacktur dhe e prezumuar barazia e pjesëve. Zakonisht forma e tillë e bashkpronësis lind si shkak i trashigimisë, blerja e sendit prej dy e më tepër personave së bashku. Ku pronarët në bashkpronësinë e pjesës kanë të drejtë e gëzimit dhe të disponimit të lirë të pasurisë së përbashkët në përpjestim me pjesën e tij. Nga ana tjetër çdo bashkpronarë duhet të marrë pjesë në detyrimet që lindin për sa i përket pasurisë së përbashkët si pagesa e tatime, taksave të ndryshme, shpenzimeve të administrimit e gjitha obligimeve që ka subjekti. Poashtu njëri nga bashkpronarët e pjesës që në tërësi përbëjnë pronën e plotë të subjektit ka të drejtë me marrëveshje apo kontratë që të blej pjesën e bashkpronarit të pjesës.

3. Instrumentet ndërkombtare në lidhje me pronësin industriale

Për të vazhduar me instrumentet ndërkombëtare të pronësis industriale në fillim duhet të cekim se në tërësi e burimet e së drejtës në një vendi ndahet në dy grupe: *burime të brendshme dhe të jashtme !*

3.1. Burimet e brendëshme të së drejtës vendore ku kemi :

1.Kushtetuta

Është burimi kryesor i së drejtës së vendit si akti më i lartë juridik dhe radhitet në krye të hierarkisë së sistemit juridik të vendit . Republika e Maqedonisë me ndarjen nga Federatës socialiste Jugosllave solli kushtetuten e

Republikës së Maqedonisë më 1991¹¹. Me sjelljen e kushtetutës vendi jonë promovoj konceptin e ri të pronësis industriale në vend si shumica e vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim, ku sipas nenit 47 të Kushtetutës së RM vendi jonë garanton të drejtat që dalin nga puna shkencore, artistike dhe obligohet që të motivoj , ndihmoj zhvillimin teknologjik në vend, poashtu sipas kushtetutës garantohet edhe tregu i lire për subjektet në vend duke siguruar të drejta të njejta të gjitha subjekteve në Republikën e Maqedonisë.

2. Ligji

Në vendin tonë fusha e pronësis industriale e rregullohet me ligje, akte nënligjore ku si burime kyçe meren ligjet në vazhdim: **Ligji për pronësi industriale**¹², **Ligji mbi mardhëniet obligative**¹³, **Ligji për mbrojtje topografike dhe qarqe të integruara**¹⁴, **Ligji për mbrojtje të konkurrencës**¹⁵, **Ligji për luftim të konkurrencës jo lojale**¹⁶, **Ligji për mbrojtje të konsumatorëve**¹⁷. Me sjelljen e ligjeve të lartëshënuara u vendosën themelet parimet e pronësis industriale në Republikën e Maqedonisë.

3. E drejta zakonore

E drejta zakonore përfshinë rregullat ku si burim i tillë në sistemin tonë të vendit nuk është burim primar i së drejtës së vendit, ku siç dimë një problem të caktuar, një proces gjyqësorë së pari meret kushtetuta që vendi sjellë nga organi të mos jetë në kundërshtim me kushtetutën, pastaj shifet se cka parashef ligji adekuat i vendit mbi problemin e caktuar nëse kemi zbrastirë ligjore (nuk parashifet me akte ligjore), zgjidhja e problemit të paraqitur atëher vjen në shprehje e drejta zakonore. Me fjalë të tjera mund të themi se e drejta zakonore është pjesë plotësuese e burimeve të së drejtës të vendit tonë.

4. Shkenca Juridike

Konsiderohet si burim i cili ka rol të rëndësishëm në formimin e së drejtës së pronësis industriale, ajo vepron nga përfaqsimi i ekspertëve juridik, persona shkencorë të lëmisë konkrete për sjelljen e rregullave juridike në fushën e së drejtës në përgjithësi e në theks të veçantë pronësis industriale në rastin tone

¹¹ Gazeta zyrtare e RM-së nr 08-4642/1 më 17 Nëntor 1991.

¹² Gazeta zyrtare e RM-së nr 21/2009, 24/2011, 12/2014, 41/2014, 152/2015 dhe 53/2016.

¹³ Gazeta zyrtare e RM-së nr 18/2001, 78/2001, 04/2002, 59/2002, 05/2003, 84/2008, 81/2009 dhe 161/2009.

¹⁴ Gazeta zyrtare e RM-së nr 05/2008, 33/2006, 136/2011 dhe 53/2016.

¹⁵ Gazeta zyrtare e RM-së nr 145/2010, 136/2011, 41/2014 dhe 53/2016.

¹⁶ Gazeta zyrtare e RM-së nr 80/1999.

¹⁷ Gazeta zyrtare e RM-së nr 38/2004, 77/2007, 103/2008, 24/2011, 164/2013, 97/2015 dhe 152/15.

konkretë. Shkenca juridike nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë porë indirekt dhe si e tillë luan një rol të rëndësishëm, poashtu është pjesë plotësuese e burimeve të së drejtës të Republikës së Maqedonisë

5. Praktika gjyqësore

Me praktikën gjyqësore nënkuptojmë zgjidhja e një procesi gjyqësorë në bazë se për një çështje të caktuar nuk parashifet në ligj atëherë gjykatësi është i detyruar që të kërkon vendimet e mëparëshme që janë marë nga e kaluar për një proces gjyqësor të njëjtë. Në vendin tonë nuk meret burim kyç pasi që sistemi Civil (sistemi romak i së drejtës) si burim i së drejtës meret ligji, ndërsa është mjaft e theksuar në sistemin anglosakson (common law) që do të thotë gjykatësi vendos në bazë të vendimit të mëherëshëm për një lëndë të njëjtë dhe rethana të njëjta, ky sistem funksionon në Angli, Kanada, Australi, SHBA dhe disa vende të tjera që kanë qenë koloni të Mbretërisë të Bashkuar.

3.2. Marveshjet ndërkombtare mbi pronësin industriale

3.2.1 Marveshja e TRIPS

Një ndër marveshjet më të rëndësishme për harmonizim të të drejtave nga pronësia intelektuale ndërkombëtare është padyshim marveshja TRIPS. Në suaza të marveshjes së Uruguajt u shtrua pyetja për efektivitetin e të drejtave nga pronësia intelektuale nën suaza të marëveshjes së përgjithshme të tregëtis dhe doganave. U punua për krijimin e një sistemi në bazë të nevojave ekonomike nën kornizat e GATT¹⁸, me zbatimin e principit të reciprocitetit nga vendet e industrializuara si bartësit më të mëdhej të të drejtave nga pronësia intelektuale. Gjatë raundit të bisedimeve të Uruguajt u krijua institucioni i përhershëm ndërkombëtar si Organizata Botërore Tregëtis, ku me krijimin e OBT –së të drejtat nga pronësia intelektuale fituan kahje të globalizimit dhe me zhvillimin e hovëshëm të tregëtis, zhvillimi teknologjik forma të ndryshme të tregëtis si e- business etj.

Po ashtu u bë e pamundur kontrollimi dhe mbykqirja adekuate i të drejtave nga pronësia intelektuale me sistemin egzistues dhe me normativiat kombëtare gjë që arsyeton përdorimin e mekanizmave të OBT-së, dhe solli në krijimin e

¹⁸General Agreement on Tariffs and Trade (GATT) marveshje mbi tregëtinë dhe tarifimin, e krijuar pas Luftës së dytë botërore që më vonë u zëvendësua nga Organizata Botërore e Tregëtis.

marveshjes mbi pronësin intelektuale TRIPS ku u vendosën standarde sa i përket rregullimit të çështjes së pronësis intelektuale në aspektin ndërkombëtar, ku standardet e tilla duhet të respektohen nga çdo vend që ka të ratifikuar këtë marveshje.

Vendet antare të Organizatës Botërore të Tregëtis ku bën pjes edhe Republika e Maqedonisë duhet të implementojnë këtë marveshje, e cila nuk kufizon vendin antarë të OBT-së, që të kufizoj dispozitat për kundrazi vendi mund që të përforcoj dispozitat për mbrojtje të pronësis intelektuale me normativin e vet kombëtare porë nuk duhet që të bjer ndesh me dispozitat që parashifen me marveshjen e TRIPS.

TRIPS është e ndarë në katër pjesë të rregullimit të drejtave nga pronësia intelektuale edhe atë

- Të drejtat e autorit,
- Të drejtat nga pronësia industriale,
- Të drejtat nga qarqet e integruara,
- Mbrojtja e informacionit sekret.

Në fushën e të drejtave të autorit marveshja TRIPS si bazë merë Konventën e Bernës mbi të drejtat e autorit, ku dallimi nga kjo konventë është në faktin se sipas TRIPS parashihet zgjerimi i fushës së të drejtës së autorit ku nën mbrojtje vëndohen edhe programet kompjuterike, si dhe baza e të dhënave(database), ku parashifet mbrojtje e njejtë dhe si të tilla njifen të drejtat e autorit, njëkohësisht rregullohet edhe çështja e huazimit, ku legjislacioni i vendit antarë duhet të parashef dispozita ndaluese kundrejt shfrytëzuesve të pa autorizuar të veprave të tilla .

Pjesa tjetër me rëndësi të veçant është pjesa ku rregullohet çështja mbi patentat, ku definohen kushtet që një inovacion (shpikje, zbulim) të patentohet. Poashtu hap i rëndësishëm është bërë edhe me harmonizimin e të drejtës amerikane me atë evropjane ku shprehjet **inovacion i dobishëm** dhe **i mirë për zbatim industrial** mund të llogaritet si sinonim për **padyshim** dhe **i vlefshëm** .

Njëkohësisht TRIPS rregullon edhe çështjen e të drejtat që dalin nga patentat duke siguruar mosdiskriminim nga vendi i zbulimit në fushën tekniko teknologjike pavarësisht se është i importuar apo nga vendi i origjinës. Parashifen edhe përjashtime sa i përket mbrojtjes të patentave kurë është në

pyetje rendi publik apo morali duke përfshirë mbrojtjen e jetës, shëndetit të florës dhe faunës në botë.

Sipas TRIPS marrëveshjes vendet anëtare të OBT-së mund të ndërpresin mbrojtjen e patentës në rastet të metodave diagnostifikues, terapeutike, kirurgjike për shërimin e njerëzve dhe kafshëve si dhe në raste për prodhimin e kafshëve, bimëve duke përjashtuar mikroorganizmat dhe procedurat jo biologjike. Vendet anëtare të OBT-së do të parashikojnë mbrojtjen të biodiversitetit me patentë apo sistem të veçantë si dhe marrëveshje ndërkombëtare, siç është marrëveshja e biodiversitetit.

Sipas nenit 38 të marrëveshjes së TRIPS për bartësin e patentës parashihen të drejta ekskluzive edhe atë si në vijim:

- a) Bartësi i patentës ka të drejtë ekskluzive për ndalim të **përdorimit, shfrytëzimit, ofrimit, shitjes dhe importimit** të produktit të patentuar pa autorizim nga bartësi i patentës.
- b) Në raste kurë lënd patentimi është ndonjë punë (proces) i cili është i patentuar dhe ndalon palën tjetër pa autorizim që të përdor, shfrytëzoj produktin i cili shfrytëzohet gjatë ati procesi.

Bartësi i të drejtës ekskluzive të patentës lejohet që këtë formë të pronësis të bart ndonjë subjekti tjetër në bazë të marrëveshjes paraprake ku parashifen kushte të caktuara **interpartes**.

Në pjesën tjetër të marrëveshjes TRIPS parashihen kushtet të cilat duhet të plotësohen nga parashtruesi i kërkesës (aplikacionit për patentim të inovacionit), ku sipas dispozitave që dalin nga kjo marrëveshje vendet anëtare të OBT-së do të kërkojnë që parashtruesit të aplikacionit për patentim të jetë i qartë, i zbatueshëm në lëmin e industrisë apo lëmi të tjera dhe të jetë i realizueshëm.

Në bazë të marrëveshjes TRIPS-it rregullohet po ashtu edhe çështja e shfrytëzimit të patentës nga organet shtetërore apo subjekte të cilat i autorizon organi shtetërorë i vendit anëtarë pa autorizim nga bartësi i patentës edhe atë në raste të caktuara si në gjendje të jashtëzakonshme në vend apo kushte të tjera për shfrytëzim publik por duke informuar bartësin e patentës, hapësira dhe kohëzgjatja e një shfrytëzimi të tillë. Sipas marrëveshjes së TRIPS afati i mbrojtjes së patentës është 20 vite nga data e parashtrimit të kërkesës (flet aplikacionit) pranë organit kompetent për patentim (në Maqedoni aplikacioni për patentim dorëzohet pranë Entit Shtetërorë për pronësi Industriale).

Duke shikuar aspektin e procedurave gjyqësore civile në lidhje me pronësin intelektuale duhet të vlej parimi i pa anshmërisë i si në të drejtën në tërsi. Poashtu parashifen edhe principe specifike konkretisht kanë të bëjnë me procedurat gjyqësore civile si pala e gjykuar ka të drejtë për njoftim me shkrim që do të dorëzohet në kohë dhe të përmbaj fakte dhe argumente mbi veprën që ngarkohet nga pala tjetër, si dhe e drejta e përfaqësimit nga ana e përfaqësuesve privat në seanca gjyqësore që për qëllim ka mos ngarkimi në lidhje me domosdoshmërinë e paraqitjes të personit. Poashtu parashifen edhe të drejta të veçanta gjatë procesit gjyqësor si grumbullimi i fakteve, shqiptimi i ndalesës, në rast se është bërë shkelje nga pala e gjykuar atëherë trupi gjykues shqipton masën varësisht nga lënda si e drejta e kompensimit të dëmit të shkaktuar, heqjen e mallrave apo edhe shkatërrimin e mallrave të caktuar.

Marrëveshja TRIPS kryesisht parashef dispozita në lidhje me mbrojtjen e markave tregtare dhe të drejtave të autorit, mirëpo vendi anëtar që ka të ratifikuar këtë marrëveshje nuk do të thotë që të kufizohet në këta masa, mund që të zgjeroj mbrojtjen por siç cekëm edhe më lart duke mos ardhur në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjes TRIPS.

3.2.2 Konventa Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale nga Marsi i vitit 1883.

Periudha e shekullit të kaluar ishte tepër e vështirë kur ishin në pyetje mbrojtja e të drejtave nga pronësia industriale, pasi që nuk egzistonte ndonjë legjislacion apo traktat, konventë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe detyrimeve nga pronësia industriale, pasi që egzistonin diversitete në legjislacionin e vendeve, dhe nuk kishte një harmoni ligjore. Çdo vend kishte sistemin dhe mënyren e vet të mbrojtjes. Aplikimi për ndonjë patentë duhej të bëhej në të njejtën kohë në të gjitha vendet pasi që egzistonte rrezik i shkatërrimit të risis apo shpikjes në vendin tjetër, këta dhe shumë probleme të tjera në fushën e pronësis industriale krijuan nevojën dhe dëshirën për krijimin e një konvente, apo traktati i cili do të bënte unifikimin e të drejtave dhe mbrojtjen e shpikjeve, zbulimeve që në të ardhmen do të kontribuonin në fusha të ndryshme të shoqërisë.

Me fillimin e procesit të industrializimit shumë vende posaqërisht vendet evropjane filluan orjentimin e tyre në fushën e futjes së teknologjis në proceset e prodhimit, dhe zhvillimi i hovëshëm i tregtisë ndërkombëtare lindi nevoja urgjente e harmonizimit të drejtave dhe mbrojtjes së pronësis industriale gjegjësisht tek **patentat** dhe **markat tregtare**.

Hapat e parë për harmonizim të të drejtave në fushën e pronësis industriale i hodhi qeveria e asokohe e mbretëris Austro-hungarze e cila ftoj

të gjitha qeverit e vendeve për participim në shfaqjen e organizuar në lidhje me prezentimin e zbulimeve inovacioneve të tyre e mbajtur në Vjenë 1873. Porë u vrejt fakti se shumë vende hezitnin të parqitnin zbulimet pasi që nuk kishin ndonjë mbrojtje juridike në lidhje me zbulimet e tyre, dhe thjesht egzistonte frika që mos të kopjohen zbulimet e tyre sepse aso kohë Mbretëria Austro-hungareze nuk kishte mbrojtje adekuate në lidhje me inovacionet e tyre.

Kjo solli dy vendime të rëndësishme të qeverisë së atëhershme edhe atë

1. Qeveria Austro-Hungareze solli vendim që me ligj special të mbrohen të gjitha shpikjet e të gjith pjesmarësve të huaj në fushën e **markave tregëtare** dhe **dizajnit industrial**.
2. Mbajtja e Kongresit të Vijenës e reformës mbi patentat e cila u mbajtë po të njejtin vit, si rrjedhoj ndaj qeverive që të ket një kuptim ndërkombëtar mbi mbrojtjen e patentave sa më shpejt të jetë e mundur .

Iniciativa e pare ishte nga mbretëria Austro-hungare ku si rrjedhoj e kësaj pasoj thirja e një konvente tjetër në Paris, Francë më 1878 ku si konkluzion i konferencës ishte se një qeveri duhej domosdoshmërisht të mer përsipër obligimin e hartimit të një projekti për unifikimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së pronësis industriale me karakter ndërkombtar, dhe njëkohësisht thirjen e një konference diplomatike në lidhje me të.

Drafti final propozonte një bashkim ndërkombëtar mbi mbrojtjen e pronësis industriale e pregaditur nga Qeveria franceze dhe dërguar vendeve tjera me një ftesë për pjesmarje në konferencë më 1880 në Paris që miratoj një projekt konëventë e cila përmbante dispozitat substanciale mbi rregullimin dhe mbrojtjen e pronësis industriale që edhe sot janë pikat kyçe të konventës së Parisiti mbi mbrojtjen e pronësis industriale. Në vazhdim konferenca diplomatike u thirë tre vite më vonë gjejgësisht në vitin 1883 në Paris e cila rezultoj me nënshkrimin e një konvente uniforme në lidhje me mbrojtjen e pronësis industriale, në fillim kjo konventë u nëshkrua nga 11 vende si **Belgjika,Brazili, El Salvador, Franca ,Guatemala,Italia,Portugalia,Serbia Spanja, Zvicra** dhe **Holanda**, ku deri sa hyri në fuqi kjo konventë u nënshkruajt edhe nga **Britania,Tunisi** dhe **Ekuatori** ku gjithsej ishin 14 vende. Rritja më e madhe e antarëve të Konëventës së Parisit ishte pikërisht pas Luftës së dytë botërore.

Konëventa e Parisit meret si bazë mbi mbrojtjen e Pronësis industriale edhe në ditët e sodit , edhe pse kjo konventë është rishikuar disa herë, mirpo shtyllat janë të njejtat, në vazhdim sjellim rishikimet e Konventës gjat periudhës nga aprovimi deri në ditët e sodit

- ✚ Rishikimi i Konventës në Bruksel 14,Dhjetorë 1900.
- ✚ Rishikimi në Washington më 2,Qershorë 1911
- ✚ Rishikimi në Hagë 6,Nëntorë 1925.

- ✚ Rrshikimi në Londër më 2,Qershorë 1934.
- ✚ Rrshikimi në Lisbonë më 31,Tetorë 1958.
- ✚ Rrshiki në Stokholllmë më 14 Korik 1967.

Në disa pika do të analizojm përmbajtjen dhe direktivat që dalin pikërisht nga konventa e Parisit ku theksuam se është një ndër konventat e cila është nëshkruar nga 173 antarë dhe më me ndikim në aspektin global në fushën e pronësis industriale.

Si një nga burimet më të vjetra dhe njëkohësisht më të vlefshme në fushën ndërkombëtare të pronësis industriale siç e përmendëm më lartë është Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësis industriale, me këtë konventë mbrohen të drejtat në vijim:

- ✚ Patenta inovative,
- ✚ Modelet e përdorimit,
- ✚ Modelet dhe monstat e vlefshme industriale,
- ✚ Markat tregëtare,
- ✚ Markat e vlefshme,
- ✚ Emrat tregëtar,
- ✚ Shenja apo emri i prejardhjes dhe
- ✚ Luftimi i konkurences jo lojale

Vlen të cekim edhe pse në vazhdim gjat punimit do të shtjellojm në mënyrë të veçant se sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë si të drejta nga pronësia industriale janë Patentat, Dizajni industrial, Marka tregtare, si dhe Shenja e prejardhjes së produktit.

Sipas rishikimit të Stokholmës mbi konventën e Parisit mbi mbrojtjen e pronësis industriale kemi të bëjm me tre ndarje të parimeve të konventës në fjalë edhe atë

- Dispozitat e së drejtës materiale
- Dispozitat organizative
- Aktet të cilat vlejné për të dy pjesët.

Si parime themelore të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësis industriale janë

- ✚ Parimi i tretmanit nacional
- ✚ Parimi i asimilimit
- ✚ Parimi i të drejtat minimale

Sipas parimit të trajtimit kombëtar vendet antare të unionit të Konventës së Parisit gëzojnë të drejta dhe obligime e njehta si qytetarët apo ndërmajret e vendit kurë janë në pyetje të drejta nga pronësis industriale. Nga pjesmarësit për gëzimin e këtyre të drejtave nuk mund të kërkohej as **domicile**¹⁹, as vendi

¹⁹[https://en.wikipedia.org/wiki/Domicile_\(law\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Domicile_(law)).

e as selia e kërkuesit të së drejtës, sipas këti parimi sigurohet tretmani i njejt dhe i barabartë nga antarët e vendeve të huaja në vendin amë.

Sipas parimit të asimimitit pjesmarësve të vendet antarte të unionit barazohen me vendet të cilat nuk janë antare të unionit me një kusht që personat fizik ose personat juridik të kenë seli të vërtet në teritorin e ndonjërit vend i cili është antar i Unionit.(union- ndryshe quhen antarët të cilët janë nëshkrusit e konventës së Parisit mbi mbrojtjen e pronësis industriale).

Sipas parimit të drejtave minimale të antarëve të unionit dhe parimit të asimilimeve do të zbatohet pamvarsisht ligjeve të vendit domicil edhe ashtuaquajtura të drejta minimale që janë të paraparë në konventë, që do të thotë të drejtat minimale **jureconventious** do të aplikohen pamvarësisht normativit të kombëtar të vendit të cilët e rregullojnë pronësin industriale.Vendet e ndryshme ku bën pjesë edhe Maqedonia të drejtat minimale janë të përfshira në legjislacionin e vendit.

Vlenë të theksohet fakti se të drejtat minimale nuk mund të referohen rregullave të brendëshme të procedurave gjyqësore dhe administrative në juridiksionin e zgjedhjes së vendbanimit, si dhe emrimit të përfaqësuesve ligjore. Për këtë problematik është kompetente e drejta e vendit amë.

Pjesa tjetër e konventës gjegjësisht neni 4-5 i konventës së Parisit rregullon çështjen mbi patentat dhe markat tregëtare, ku rregullohet çështja e përparsis e afateve të parashtrimit të kërkesës si dhe kushtet për paraqitje, njëkohësisht rregullimin e principit të teritorialitetit, vlefshmëria e patentës nga një vend në vendin tjetër. Neni 5-6 rregullon çështjen e dizajnit industrial dhe markave tregëtare, posaqërisht përdorimin e markave tregtare dhe dizajnit industrial në vendet antare, mënyrën e pagesës së tatimeve dhe mirmbajtja e të drejtave të lartpërmendura dhe të ngjajshme, njëkohësisht rregullohet edhe mbrojtja e veçant e markave të njohura(well-knownmarks) dhe obligimeve të veçanta që duhet të ofrojnë vendet antare të unionit. Njëkohësisht neni 8 i konventës parashef edhe mbrojtjen e Emrit tregëtar në të gjitha vendet antare, pa detyrim të paraqitjes apo regjistrimit të saj apo ndonjë pjese të markës tregëtare.

Poashtu për herë të parë në sferën ndërkombëtare me nene të caktuar rregullohet edhe luftimi i konkurrencës jo lojale, ku sipas dispozitave me konkurrencë jo lojale nënkuptojm si aktë konkurrence në kundërshtim me sjelljet e mira të industrisë dhe tregëtis.

Si konkluzion mund të konstatojm se Konventa e Parisit si një bazë më e vjetër e mbrojtjes së pronësis industriale në aspetin ndërkombëtar si dhe në vendin tonë edhe pse e rishikuar disa herë ngelet aktuale ku rishikimet e ardhëshme parashifen nën suazat e Organizatës Botërore të Pronësin Industriale (në vazhdim WIPO), duke u munduar plotësimin e kërkesave të së tashmes dhe të ardhmes duke u drejtuar kah zhvillimi i shoqëris me faktorë kryesorë gjenialitetin dhe mendjen e ndritur të **njeriut**.

3.2.3. Marveshja ndërkombëtare e Madridit për rregjistrimin e Markave Tregëtare (1891), si dhe Protokoli i Madridit.

Një ndër hapat e parë në unifikimin e rregullimit të së drejtës ndërkombëtare mbi rregullimin e rregjistrimit, mbrojtjes si dhe zbatimit të drejtave dhe detyrimeve nga pronësis industriale gjegjësisht mbi markat tregtare ndryshe quhet edhe sistemi i Madridit e cila përbëhet nga dy pjesë

-  Marveshja e Madridit mbi rregjistrimin e markave tregtare e mbajtur në vitin 1891 që hyri në fuqi në vitin 1892.
-  Protokoli i Madridit i cili i referohet marveshjes së Madridit e cila hyri në zbatim 1, Prill 1996.

Marveshja si dhe Protokoli i Madridit janë mbajtur në Madrid të Spanjës nga delegatët e vendeve të cilat atëherë ishin në këto marveshje.

Në disa pika të shkurta do të flasim në lidhje me historikun ku kaluan gati një shekull për kompletimin e sistemit të Madridit. Kjo marveshje nuk arriti qëllimin e vet për një periudhë të gjatë kohore pasi që kishte ngecje në antarsimin e vendeve, pra nuk u përkhate posaqërisht nga vendet e fuqishme të cilët në atë periudhë bënë bujë të madhe lëmin e rregjistrimit të markave tregtare siç ishin vendet e Azisë duke cekur Japoninë, Kontinentet Amerikane, Mbretëria e Bashkuar.

Në periudhën pas nënshkrimit të marveshjes së Madridit, Japonia bënte bujë të madhe me rregjistrimin e markave duke mos anashkaluar Kanadan, SHBA-të (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), mirpo këta nuk përkrahnin marveshjen gjë që solli në ngecje të aprovimit të sistemit ndërkombëtar mbi këtë sistem për unifikim të legjislacionit dhe thjeshtësim të rregjistrimit, mbrojtjes. Këto vende përdornin legjislacionet nacionale, byrot nacionale gjithcka që lidhej mbi markat tregtare.

Arsyeja tjetër ishte se formulari i aplikimit mbi rregjistrimin ishte shumë e thjeshtë dhe e njëjta për të gjitha vendet antare, kurë rregjistrimi kombëtar përjashtonte një sistem të tillë dhe këta vende ngelën jashtë Marveshjes së Madridit deri në një periudhë ku shihenin ndryshimet e mundëshme.

Gjatë periudhës një shekullorë, pati ngritje ulje gjegjësisht të cilat nuk u vrehëshin fare mbi marveshjen e Madridit ku një përpjekje rezultoi në vitin 1966-1967 me aritjen e Traktatit të rregjistrimit të Markave Tregtare (TRT) e mbajtur dhe miratuar në Vjenë të Austrisë në vitin 1977 e cila hyri në fuqi 1980 mirpo numri i anatrëve ishte shumë i ulët, ky traktat u nënshkruajt vetëm nga pesë vende edhe atë BurkinaFaso, Kongo, Gabon, Bashkimi Sovjetik, si dhe Tongo, dhe u pa qartë se ky traktat nuk mund të zëvendësonte Marveshjen e Madridit.

Me afrimin e vendeve të Bashkimit Evropjan, në fushën ekonomike, pastaj edhe politike, me realizimin e multijuridiksionit në Komunitetin Evropjan mbi markat tregtare u rrit relevanca e Sistemit të Madridit, i cili hyri në mbikqyrje gjegjësisht të WIPO-së (Organizata ndërkombëtare mbi Pronësin Intelektuale), e cila shtjelloj këtë sistem, dhe njëkohësisht duke shtuar presionin ndaj vendeve së pari të komunitetit e pastaj vendeve tjera të cilat nuk ishin antare të Marveshjes së Madridit, duke rritur dukshëm numrin e nënshkruesëve të Protokollit.

Protokolli i Madridit i cili u realizua më 1 Dhjetorë 1995 dhe hyri në fuqi më 1, Prill 1996.

Me një fjalë WIPO ndihmoj për krijimin e një protokollit, ku si bazë kishte marveshjen e Madridit mbi unifikimin ndërkombëtar të regjistrimit të markave tregtare.

Shumë vende filluan përshtatjen e legjislacionit që rregullonin çështjen e markave tregtare me protokollin në fjalë, si dhe ndryshimet e kërkuara nga WIPO.

Në Evropë u has në rezistencë nga avokatët e markave tregëtare, të cilët frigoheshin për humbje të biznesit të tyre, pasi që aplikimi për markë tregëtare mund të bëhej drejtpërdrejt në byron e Protokollit të Madridit e jo nga ata siç parashihte legjislacioni nacional.

Problemi dhe vonesa më e madhe qëndronte në ShBA ku kishte probleme për nënshkrimin e protokollit, pasi që dy biznesmenë të fuqishëm të cilët kishin ndikim në disa kongresmen, pasi që financuan fushatën e tyre elektorale, solli që në Kongres mos të kaloj votimi, ku ki proces rezultoj i përfunduar gjatë periudhës së Gorge W Bush që u aprovu tërësisht Traktati i Madridit mbi regjistrimin e markave tregëtare.

Poashtu edhe Japonia me nënshkrimin e marveshjes së Nicës²⁰ mbi klasifikimin e shërbimeve dhe të drejtave mbi regjistrimine markave tregtare rrishikioj legjislacionin kombëtare mbi regjistrimin e markave, gjithsesi edhe vendete e Unionit Evropjan harmonizuan ligjet për përshtatje me Protokolin e Madridit edhe vendet si Majlazia, Zelanda e Re dhe Afrika e Jugut poashtu kanë përshtatur ligjet e tyre për harmonizim me Protokolin e Madridit.

Në vazhdim një përmbledhje të shkurtë të Marveshjes së Madridit²¹ si dhe Protokolit të Madridit,²² që së bashku ndryshe quhet edhe ***Sistemi i Madridit***.

²⁰ Marveshja e Nicës mbi klasifikimin ndërkombëtarë të të drejtave dhe shërbimeve të aplikuara për regjistrimine Markave Tregëtare Nicë, Francë 1957.

²¹ Marveshja e Madridit e publikuar në Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.2/74 e publikuar në vitin 1974.

²² Protokolli I Madrdit e shpallur në gazetën zyrtare te Republikës së Maqedonis nr .12/02 më 16, Shkurt 2002.

Marveshja e Madridit për rregjistrimin ndërkombëtar të Markave Tregëtare (1891) e rishikuar disa herë si **Bruksel, Belgjikë(1900), Washington, ShBA(1911), Hagë, Holandë(1925), Londër, Mbretëria e Bashkuar (1934), Nicë, Francë (1957)dhe Stokholmë, Suedi(1967)** e amenduar më 1979.

Me këtë marveshje rregullohet çështja e rregjistrimit, vlefshmëria, kohëzgjatja e markës e rregjistruar pranë byros për pronësi industriale. Sipas marveshjes në fjalë procesi i aplikimit është i unifikuar për të gjitha vendet e unionit të marveshjes së Madridit.

Rregjistrimi i markave bëhet siç cekem me plotsimin e formularit i cili parashatohet pran byros me ndërmjetësim të byros kombëtare të vendit të origjinës të palës parashtruese të aplikacionit për rregjistrim dhe vlenë në të gjitha vendet antare, pra vlefshmëria është e njëjtë si në vendin e origjinës.

Vlefshmëria e markës e cila është e rregjistruar pranë byros mbi pronësin industriale është 20 vjet nga data e shpalljes në buletinin periodit me të drejt vazhdimi edhe nga 20 vite. Nuk përbën asnjë pengesë nëse marka është e rregjistruar në vendin e origjines dhe të parashatohet kërkesë pranë Byros ndërkombëtare për mbrojtje të pronësin industriale. Mbi procedurat gjatë rregjistrimit, kushtet gjat aplikimit, taksat e caktuara do të flasim në kapitullit në vazhdim ku do të shtjellohet mënyra, format e rregjistrimit, instrumentet mbrojtëse, të drejtat penalizimet, në bazë të marveshjes së caktuara dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Unioni i byros përbëhet nga Kuvendi si institucion vendimarrës ku çdo vend antarë ka delegatët e vet të caktuar me të drejt vote, ku kuvendi miraton ndryshimet e mundëshme, plotësimet, miraton buxhetin. Si institucion ,më i lartë është edhe Drejtori gjeneral i Byros .

Protokolli i Madridit që bashk me Marveshjen e Madridit përbëjnë Sistemin e Madridit, që me nënshkrimin e protokollit nënkuptojm vazhdimsin e Marveshjes, pra vendet që nuk janë antare të Marveshjes së Madridit dhe janë nënshkruese të Protokollit gëzojnë të gjitha të drejtat si antarët e Unionit.

Një ndër kushtet për atermim të protokollit të Madridit është se vendi duhet të jet nënshkrues i Konventës së Parisit mbi pronësin industriale .

3.2.4. Marveshja e Hagës mbi rregjistrimin ndërkombëtar të dizajnit industrial.

Kjo marrveshje u soll më 1925 e rishikuar më 1934 dhe 1960 që ka të bëjë me rregullat, direktivat sa i përket dizajni industrial, si një instrument që harmonizon sistemet kombëtare në mbrojtje të dizajnit industrial në rafshin ndërkombëtar, si shumë marveshje apo traktate të ndryhme ndërkombëtare edhe marveshja e Hagës ka qëllimin e saj unifikim, thjeshtësimin gjat procesit të

rregjistrimit, si dhe mbrojtjes së pronësis industriale, konkretisht **dizajnin industrial**.

Siç cekëm marveshja u soll më 1925 porë duke patur nevojën e revidimit dhe shtimin e disa dispozitave u rishikua disa herë ku më 1961 u shtuan disa dispozita, ndërsa më 1967 u plotësua me akte komplementare dhe e ndryshuar me protokol më 1975, ku vendimi komplementar u rishikua më 1979. Në vitin 1999 në Gjenevë të Zvicrës u mbajtë konferenca diplomaie e unionit²³ u soll **Akti i Gjenevës** mbi marveshjen e Hagës për rregjistrim ndërkombëtar të dizajnit industrial.

Sipas Marveshjes së Hagës mbrojtja e dizajnit industrial bëhet drejtpërdrejtë pranë Organizatës Botërore të Pronësis Intelektuale (**WIPO** ang.), apo në ndonjë byro shtetërore²⁴ të vendit antar të Unionit. Mbrojtja e dizajnit industrial është në afat prej 5- 25 vjetë varësisht nga parashtuesi i kërkesës nëse kërkon vazhdimin e afatit mbrojtës.

Sipas marveshjes së Hagës sistemi i rregjistrimit ndërkombëtar të dizajnit industrial pothuajse është i njëjtë si tek rregjistrimi ndërkombëtar i patentës apo markës tregëtare, ku parashtuesi i kërkesës për njohje të dizajit industrial plotëson forumlarin i cili është i unifikuar sipas marveshjes dhe aplikohet për njohje ndërkombëtare, nëse dizajni industrial njifet nga organet e WIPO-së si i tillë dhe nga subjekti i cili aplikon kërkohet që mbrojtja të shtrihet edhe në vendet tjera të unionit, këtë të drejtë mund që të shfrytëzon subjekti, mirpo vendi që ka pretendime për një dizajnë i cili rregjistrohet pranë unionint apo mos pajtim ka të drejt që të rrefuzoj rregjistrimin apo mbrojtje e një dizajni industrial të tillë në një afat kohorë të caktuar prej 6 muaj nga pranimi i aplikacionit për rregjistrim pranë unionit, duke arrsyetuar dhe dëshmuar sipas legjislacionit të vendit.

3.2.5 Marveshja e Lokranos mbi klasifikimin e dizajnit industrial

Me sjelljen e Marveshjes së Hagës mbi Dizajnin industrial si dhe me protokolin e Gjenevës mbi marveshjes e Hagës që u sollën dispozit në lidhje me thjeshtësimin e procedurave dhe unifikimin e aplikacionit për njohje ndërkombëtare të dizajnit industrial, ishte e patjetërsueshme që të kemi edhe një sistem unifikimi për klasifikim, pasi që vendet kishin forma të e tyre kombëtare të klasifikimit dhe si pasoj kishte probleme gjat klasifikimit të Dizajnit industrial.

²³ **Unioni –paraqet vendet të cilat kanë ratifikuar marveshjen e Parisit, dhe vendet quhen antarë të Unionit.**

²⁴ Në Maqedoni si organë shtetërore është Enti Shtetrorë për Pronësi industriale i themeluar që nga Dhjetor 1993.

Marveshja e Lokranos mbi klasifikimi e dizajnit industrial u soll të nënshkruar në Lokarno më 8 tetor të vitit 1968 dhe të ndryshuar më 2 tetor të vitit 1979²⁵. Sipas marveshjes së lartpërmendur dizajni industrial klasifikohet në klasë në produkte të ndryshme edhe atë në 32 klasë dhe 223 nënklasë, poashtu parashifet edhe radhitja sipas sistemit alfabetik latin, ku lista përmban 6320 shenja nga mallra të ndryshëm

Numrat e klasave dhe nënklasave të Klasifikimit të Lokarnos patjetër duhet të kenë shkurtesën “LOK”, kurse edicioni i atij klasifikimi sipas të cilit klasifikohen modelet dhe mostrat industriale shënohet me numër arab si në shembullin që vijon (për shembull, LOK (6) Kl.8-05)²⁶.

Vendet të cilat kanë ratifikuar këtë marveshje janë të detyruar të respektojnë këtë formë të klasifikimit gjat shpalljes, apo dokumenteve që dalin nga byrot e vendeve kombëtare, ndërsa parashtruesi i kërkesës për mbrojtje të dizajnit industrial nuk janë të obliguar të respektojnë rradhitjen, pasi që radhitja në vazhdim bëhet nga byrot kombëtare dhe ata bëjnë klasifikimin në grupe e nëngrupe.

3.2.6 Marveshja e Singaporit për të drejtën e Markave Tregëtare²⁷

E mbajtur në Mars, 2006 në Singapor në një konferencë diplomatike u soll si një përgjigje e zhvillimit të teknologjisë, dinamikës moderne të shoqërisë dhe sjelljen e një marveshje mbi harmonizimin e kornizave të procedurave administrative për rregjistrimin e **markave tregtare** e bazuar në marveshjen mbi markat tregëtare 1994. Marveshja e Singaporit zbatohet tek të gjitha markat tregëtare në vendet të cilat kanë ratifikuar këtë marveshje janë të lira të zgjedhin mënyrën e komunikimit me byron ndërkombëtare duke futur edhe komunikimin elektronik, ku sipas Marveshjes së Singaporit si formë komuniçi njifet edhe forma elektronike si formë zyrtare e komunikimit pasi që dinamika e zhvillimit dhe shkurtimi i pengesave kohore, si dhe komunikimi i vendimeve për liçencime mbi markat tregëtare. Si dhe mënyra e paraqitjes për rregjistrim në më shumë klasifikime duke përdorur klasifikimin e Nicës në bazë të Marveshjes të 1994 ku të dy marveshjet mund të ratifikohen bashkërisht ose në mënyra të ndara.

Dallimi më i theksuar nga Marveshja e 1994 është se sipas marveshjes së Singaporit mund të rregjistrohen të gjitha markat sipas legjislacionit të vendeve

²⁵Publikuar në Gazetën zyrtare të R,Maqedonisë nr.5/74.

²⁶Neni 15pjs4 e Marveshjes së Lokranos

²⁷Publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 19/10 .

nënshkruese, poashtu dallimi tjetër qëndron në faktin se sipas marveshjes së lartpërmendur për her të parë mund të rregjistrohen edhe markat jo tradicionale dhe si të tilla njihen në instrumentet ndërkombëtare, ku si **marka jo tradicionale** njihen hologramet, markat 3D, ngjyrat, markat e pozicionuara të lëvizëshme, poashtu edhe markat e padukshme si zëri, aroma, shija, prekja. Poashtu edhe sipas marveshjes së Singaporit nuk është e nevojshme verifikimi apo kontrollimi i nënshkrimeve në komunikim dhe vendet që kanë të ratifikuar marveshjen janë të lira të zgjedhin mënyrën e verifikimit.

Si një risi paraqiten edhe lehtësime kurë është në pyetje kufizimi kohorë për parashtruesin e aplikacionit për rregjistrim pranë byros, pra vendet që kanë ratifikuar këtë marveshjen duhet që të praktikojnë një lehtësim si vazhdimi i afatit apo kthimi nga fillimi i procedurës në raste se pa dashje është shkelur afati apo pa fajin e palës parashtruese të aplikacionit.

Marveshja e Singaporit vendos mënyrat e rregjistrimit të licencave për Markat tregëtare dhe parashef kushte maksimale për kërkesën për rregjistrim, ndryshim apo çregjistrim të licencës.

Formimi i Kuvendit nga vendet nënshkruese të marveshjes sjell një fleksibilitet sa i përket detajeve që kanë të bëjnë me procedurat që duhet të implementohen nga byrot kombëtare të vendeve antare të unionit, poashtu u soll edhe pjesa shtesë e marveshjes që vendet kontraktuese nuk janë të obliguara të rregjistrojnë marka të reja, si dhe implementojmë sistemin elektronik apo atë automatik, si sistem komunikimi poashtu vendet të cilat janë më pak të zhvilluara tu sigurohet përkrahje teknike teknologjike me qëllim që të përfitojnë dhe zbatojnë detyrimet nga marveshja. Vendet që janë më pak të zhvilluara të jenë shfrytëzuesit primarë të përkrahjes teknike e teknologjike. Kuvendi ka për detyrim vëzhgimin të përkrahjes që u jepet këtyre vendeve nën mbykqyrjen ekskluzive dhe të vazhdueshme nga Drejtori gjeneral²⁸ i Organizatës Botërore të Pronësis Intelektuale.

3.2.7 Marveshja e Nicës mbi klasifikimin ndërkombëtar të markave tregëtare të mallrave dhe shërbimeve (e sjellur në Nicë, Francë më 1957).

Sipas marveshjes në fjalë kemi të bëjmë me klasifikimin e markave tregëtare të mallrave dhe shërbimeve në fushën ndërkombëtare, pra nga vendet të cilat kanë të ratifikuar këtë marveshje.

Klasifikimi i markave tregëtare sipas marveshjes përbëhet nga lista edhe atë

- 1. 34 lista mallra**
- 2. 11 lista shërbime**

²⁸Drejtori gjeneral i WIPO-së Francis Gurry nga 2008 –(<http://www.wipo.int/about-wipo/en/dgo/>)

Si dhe klasifikimi sipas renditjes së alafatetit për markat e mallrave dhe shërbimeve, qëllimi i klasifikimit është thjeshtësimi gjatë procesit të regjistrimit të markës, lehtësime gjatë procesit të kërkimit të një të tille, si dhe gjatë procesit vërtetimit.

Klasifikimi bëhet në bazë të klasave të lartpërmendura, në rastë se Marka për mallra apo shërbime nuk gjendet në klasifikimin e mësipër sipas marveshjes së Nicës aplikohet kriteret në vazhdim.

-për mallra

1. Nëse marka e produktit të caktuar nuk gjendet në listën e caktuar paraprakisht atëherë klasifikimi bëhet në bazë të funksionit apo qëllimit, nëse nuk zbatohet ky kriterium atëherë shifet baza analogjike me produktet e njejta të gatshme, nëse edhe ky kriterium nuk është i zbatueshëm atëherë zbatohet kriteriumi në bazë të materialit që është realizuar produkti, apo nga mënyra e përdorimit.

2. Produktet e gatshme të cilat paraqiten si një produkt a në faktë përmbajnë dy e më tepër produkte (si radio me orë alarmi, apo televizion me DVD) atëherë klasifikimi i tyre bëhet në bazë të qëllimit për të cilin janë prodhuar.

3. Produktet natyrore të përpunuara apo të pa përpunuara si (mineralet e ndryshme, mermet) klasifikohen në bazë të përbërjes së materialit.

4. Produktet të cilat dedikohen si pjesë e përbërse e produktit tjetër atëherë klasifikohen në të njejtën klasë si produkti final.

5. Produktet të cilat janë të gatshme apo gjysëm të gatshme klasifikohen në bazë të materialit, nëse materiali përbëhet nga dy e më tepër elemente atëherë klasifikimi i tyre bëhet në bazë të elementit dominues në atë produkt.

6. Kutitë e paketimit të materialeve klasifikohen në bazë të materialit që shërben kutia si mbrojtje të atë materialit.

-për shërbime

1. Shërbimet në princip klasifikohen në bazë të lëmis apo aktivitetit që më gjerësisht janë klasifikuar në klasë në bazë të analogjisë të shërbimit të njejtë.

2. Shërbimet klasifikohen në të njejtën klasë si funksioni për të cilin janë krijuar (shembull blerja e veturës).

Çdo vendë që pranon këtë marveshje mund të përdor këtë klasifikim si bazë të sistemit të tyre kombëtar për klasifikim të markave tregtare apo si sistem ndihmës apo të kombinoj të dy sistemet atë kombëtar dhe këtë sipas marveshjes së Nicës.

3.2.8 Marveshja e Vjenës për klasifikimijn e elementeve figurative të markave tregëtrare²⁹

(Përpiluar në Vjenë më 12 qershor të vitit 1973 si dhe e ndryshuar dhe plotësuar më 1 tetor të vitit 1985). Qëllimi i kësaj marveshje pothuajse është i njejtë si Marveshja e Nicës, pra lehtësimi gjatë procedurave të rregjistrimit, klasifikimit dhe thjeshtësimi gjatë kërkimi i markës së caktuar. Çdo vendë antarë i unionit është i obliguar që të përdor sistemi e klasifikimit të lartpërmendur dhe shpalljet dhe lejet për klasifikim të shënojnë me simbolet adekuate të klasifikimit. Sipas Marveshjes së Vjenës klasifikimi i elementeve figurative ndahet në

- **29 Klasë**
- **152 Grupe**
- **1567 Nëngrupe.**

Çdo kontest midis dy apo më shumë vendeve të Unionit të veçantë, që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, e që nuk është zgjidhur me bisedime, mundet nga ana e cilit do vend të përfshirë të paraqitet para Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë në pajtim me statutin e gjykatës për ta zgjidhur atë kontest, me përjashtim të rastit kur vendet për të cilat ka të bëjë kontesti merren vesh përmes metodave të tjera. Vendi që del para gjykatës duhet ta njoftojë Byronë ndërkombëtare, ndërsa Byroja ndërkombëtare për këtë do t'i informojë të gjitha vendet e Unionit të veçantë.³⁰

3.2.9 Marveshja e bashkpunimit në fushën e patentave (PCT)

Marveshja e bashkpunimit në fushën e patentave³¹ (Washington, 1970) nga vet emri nënkuptojmë se me këtë marveshje rregullohet bashkpunimi ndërkombëtar në fushën e patentave, ku sipas shumicës së ekspertëve kjo marveshje llogaritet pas marveshjes së Parisit për nga rëndësia. Është një marveshje që racionalizon dhe thjeshtëson procedurat të rregjistrimit, kërkimit dhe kontrollit të kërkesave për patentim të inovacioneve në aspektin ndërkombëtar gjegjësisht vendet të cilat kanë të ratifikuar këtë marveshje. Sipas direktivave të marveshjes dhënja, njohja rregjistrimi bëhen pranë byros kombëtare (në vendin tonë Instituti shtetëror për pronësi industriale-në Maqedoni) Sipas marveshjes për bashkpunimin në fushën e patentave në

²⁹Shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 19/10.

³⁰Neni 11 pjesa e parë e Marveshjes së Vjenës për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurativ të Markave tregëtare.

³¹Publikuar në "Gazetën zyrtare të RM-së" nr. 49/97 më 30 shtator 1997

vazhdim (PCT) mundësohet që inovacioni që paraqet aplikacionin për patentim mund të paraqitet në më shumë vende dhe të paraqes edhe kërkesë për njohje ndërkombëtare.

Aplikimin për patentim ndërkombëtar mund të paraqes cili do person që është shtetas i vendit që ka të ratifikuar këtë PCT , apo ka leje qëndrimi në njërin nga vendet ratifikuese të marveshjes.

Në bazë të marveshjes rregullohet forma e kërkesës që duhet të plotësohet për njohje ndërkombëtare të Patentës. Ku një ndër karakteristikat kyçe sipas marveshjes PCT është se kërkesa parashtrrohet një kontrolli në bazën e të dhënave (*database*) se inovacioni a është i patentueshëm apo Jo, ku njëkohësisht njoftohet byroja e vendit kombëtar në lidhje me kërkesën për njohje ndërkombëtare, poashtu konsultimi me ekspertë në lidhje me plotsimin e kushteve të patentimit ndërkombëtarë.

Sipas marveshjes së bashkpunimit në fushën e patentave kemi të bëjmë me dy faza edhe atë ajo kombëtare, dhe ndërkombëtare, faza kombëtare ka të bëjë me patentimin pranë Entit shtetrorë për pronësi industriale dhe njohja e patentës ndërkombëtarisht paraqitet pranë Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale (WIPO). Karakteristike është fakti se parashifen lehtësime dhe përshejtime që Patenta e njohur sipas PCT të gjejë përdorim në industrin adekuate dhe sektore të tjera, poashtu edhe përkrahje e vendeve në zhvillim që më lehtë të kenë qasje në shpikjet e reja teknologjike.

3.2.10 Marëveshja ndërkombëtare e Strasburgut për klasifikimin e Patentave (1971 e ndryshuar më 1979).

Periodha para sjelljes së Marveshjes së Strasburgut u përdorën klasifikime të ndryshme varësisht nga vendi, duke u nisur nga fakti se **patenta** është një zbulim në fusha të ndryshme të shoqërisë dhe me zhvillimin e shpejtë dhe dinamik lind nevoja e klasifikimit të patentave në fushën ndërkombëtare dhe që do të jetë një sistem unik për vendet ratifikuese të Marveshjes së Strasburgut që në mënyrë më të lehtë të gjenden gjatë kërkimit dhe grupimi i tyre.

Sipas marveshjes së lartpërmendur patentat klasifikohen në 8 seksione që shënohen me shkronja të alfabetit edhe atë si në vijim

A- Nevoja jetsore

B- Punim dhe përpunim

C- Kimi dhe metalurgji

D- Tekstiil dhe letra

E- Ndërtimtari dhe xehtari

F- Maqineri ,ndriçim,nxemje,armatim,minim.

G- Fizik

H- Elektroteknik

Ku çdo seksion ndahet në më shumë klasa kë shënohet simboli i seksionit dhe numri dyshifrorë arab. Titulli i klasës jep përmbajtjen ku çdo klasë e ndarë në grupe, çdo grup në nëngrupe, ku çdo grup shënohet me simbol të nënklasës dhe nr arab të ndarë me / dhe , ku grupa kryesore shonohet me (/00) dhe titullin që është më adekuat për kërkim.

Gjatë gjith këtyre ndarjeve sipas Marveshjes së Strasburgut mbi klasifikimin e patentave kemi diku reth **67,000** nën ndarje ku shenja e klasifikimit është e patjetërsueshme të shënohet në çdo dokument që shënohet patenta. Vendet ratifikuese të marveshjes obligohen që në klasifikimin të bëjnë në bazë të marveshjes mbi klasifikimin e patentave.

3.2.11 Marveshja e të drejtave mbi Patentat (PLT).

Kjo marveshje u soll në vitin 2000 nën mbykqirje të WIPO-s që edhe administrohet nga organizata e cila me seli gjendet ne Gjenevë të Zvicrës, qëllimi kyç i kësaj marveshje është harmonizimi i formaliteteve gjatë procedurave të aplikimit për patentim. Rregullohen dhe definohen kërkesat maksimale që kërkohen nga byrot kombëtare dhe rajonale për patentim, si shënimi i datës së aplikimit që të mund të konstatohet data e parashtrimit të kërkesës për patentim.

Thjeshtësimi i aplikacioneve nga byrot kombëtare gjatë aplikimit për patentim edhe atë aplikacioni duhet të përmbaj : elementet e pranuar të indikohen se janë për patentim, byroja kombëtare të mund të identifikoj dhe të mund të kontaktoj parashtruesin e aplikacionit për patentim, pjesa ku duhet të përshkruhet inovacioni për patentim .

3.3 Regullativi dhe direktivat e Unionit Evropjan mbi Pronësin industriale.

Me krijimin e Unionit Evropjan, lëvizjen e lirë të mallrave, fuqisë puntore, krijimin e institucioneve Evropjane, poashtu lind edhe nevoja e krijimit të një sistemi unik sa i përket pronësis industriale. Edhe pse konventat, marveshjet, traktatet mbi pronësin industriale në fushën ndërkombëtare, vendet e Unionit Evropjan shkojnë një hap më tej duke shfrytëzuar sistemin unitar të që të

sigurojnë të drejta minimale nga konventat, marveshjet ndërkombëtare që poashtu të jenë pjesë e sistemit të legjislativ të vendit si dhe sigurimin e të drejtave për qytetarët e vendi dhe të huaj. Tentimi i krijimi i një sistemi unifikimi të dispozitave juridike në fushën e pronësis industriale të Unionit Evropjan ndikim të veçant ka Parlamenti Evropjan dhe Këshilli Evropjan me intervenimin me dy burime të rëndësishme edhe atë

- **Regullativat** janë rregulla të krijuara për dispozitat në fushën e caktuar me ndikim të pjesëshëm në sistemin juridik të vendit antar të UE-së, si dhe si instrument unifikimi i së drejtës nën korniza të Unionit Evropjan.
- **Direktivat** paraqesin udhëzime për vendet antare dhe definojnë qëllime të cilat duhet të realizohen, ndërsa sa i përket implementimit lejohet të vendos nga vendi antar i Unionit Evropjan . Poashtu direktivat përdoren edhe si instrumente për harmonizim të së drejtës të vendeve antare të Unionit Evropjan. Në vazhdim në pika të shkurta do cekim disa rregullativa dhe direktiva me rëndësi të veçant mbi pronësin industriale në Unionin Evropjan.

3.3.1 Direktiva e Paralementit Evropjan dhe Këshillit mbi zbatimin e të drejtës së pronësis intelektuale 48/2004 EC³²

Si një ndër direktivat më të rëndësishme të Unionit Evropjan mbi mbrojtjen e pronësis intelektuale e posaçërisht në fushën e pronësis industriale ku dhe realizimi është më i madh pasi që në të drejtën e autorit dhe të drejtat e ndërlidhura ka ngecje në harmonizim të plotë të së sistemit të së drejtës evropjane, bazohet në faktin se pa zbatimin efektiv të së drejtës së pronësis intelektuale nuk kemi motivacion për inovacione të reja poashtu edhe kreativiteti e humb rëndësin e saj dhe pika më kyçe se bien edhe investimet. Masat që parashifen në direktivën mbi pronësin intelektuale pothuajse janë plotësisht të përputhura me Marveshjen e TRIPS-it.

Baza e direktivës bazohet në masat, procedurat, si me masat juridike që nevojiten të ndërmeren për të garantuar zbatim të drejtave nga pronësia intelektuale. Sipas aspektit juridik direktiva në fjalë dedikohet vendeve antare te Unionit Evropjan ku obligohen të implementojn në sistemin normativ të vendit kombëtar. Për dallim nga rregullativa direktiva obligon vendin antarë të implementoj tërësisht detyrimet dhe obligimet që dalin nga direktiva si dhe

³² Directive of European Parliament and Council about the rights of intellectual property 48/2004 EC (**Official Jurnal L195/16 from 02.06.2004**).

zbatim të plotë në fushën e pronësis intelektuale, si unifikim i sistemit të krijimit, përmbajtjes, fushveprimin e mbrojtjes të së drejtave.

Vlenë të theksohet se direktiva në fjalë krijohet një set standardesh evropjane për implementim të drejtave në fushën e pronësis intelektuale, standardet e tilla janë si udhërefyes për implementim të standardeve ndërkombëtare nga TRIPS marveshja si dhe formimin e standardeve evropjane sa i përket zbatimit të sistemit të unifikuar në fushën e pronësis intelektuale. Direktiva e unionit evropjan siç thamë përputhet me marveshjet traktatet ndërkombëtare dhe nuk është aspak në kundërshtim përkundrazi parashef rregulla më të detajuara sa i përket zbatimit, të sistemit të së drejtës në fushën e pronësis intelektuale dhe për dallim nga marveshja ka karakter imperativ për vendet antare të unionit .

Qëllimi përfundimtar i Unionit Evropajn me mekanizmat juridike, si direktiva, rregullativa si dhe vendime të gjykatës evropjane të drejtësis të kompletj iden mbi tregun e brendëshëm të Unionit Evropjan, dhe në anën ndërkombëtare të shfaqet si një tërsi e vendeve antare.

Direktiva EC48/2004 përmban disa pricinpe kyçe edhe atë

1. Principi i panshmëris gjat zbatimit të masave, procedurave, dhe mjeteve juridike.
2. Principi i kontrllit të argumenteve nga pala e tretë.
3. Principi i sigurimit të fakteve gjatë procesit.
4. Principi i informimit.
5. Principi i shqiptimit të masës të përkohëshme, si ndalesa, kufizimit, shfyqizimi.
6. Principi dhe masa që rregulloht çështja e zgjidhja e rasteve pozitive
7. Principi i publicitetit.

3.3.2 Direktiva për mbrojtje juridike të zbulimeve bioteknologjike 98/44/EC³³

Direktiva në fjalë u soll me qëllim të harmonizimit të rregullave e vendeve antare në fushën e zbulimeve bioteknologjike në fakt për njohjen e të drejtës mbi mbrojtjen e zbulimeve bioteknologjike në vendet antare të cilat nuk e njofin si e drejtë e tillë. Sipas direktivës 98/44/EC parashifen obligime për vendet antare që njofin zbulimet industriale dhe inovative të zbatueshme edhe

³³ Directive 98/44/EC of the European Parliament and Council of 6 July 1998 on the Legal Protection of Biotechnological Inventions(*official jurnal L 213, 30.07.1998 p. 0013-0021*).

pse të njejtit mbi produktet që kanë material biologjik apo procesi i prodhimit, procesi i shfrytëzimit të materialit biologjik. Kemi disa procese të cilat nuk njifen sipas direktivës dhe nuk janë në mbrojtje si procesi i klonimit, modifikimi gjenetik, shfrytëzimi i embrioneve të njeriut për qëllime tregëtare apo qëllime industriale, apo modifikimi gjenetik i kafshëve(me përjashtime). Poashtu direktiva në fjalë rregullon edhe hapsirën e mbrojtjes të zbulimeve bioteknologjike si dhe kufirin e mbrojtjes.

3.3.3 Rregullativa e Këshillit të Evropës EEC 1768/92 në lidhje me dhënjen e certifikatave shtesë në lidhje me mbrojtjen e prodhimeve medicinale³⁴

Me rregullativën e lartpërmendur EEC/1768/92 e ndryshuar me Regullativën EC No1901/2006 rregullohet çështja e dhënjes së certifikatave shtesë për produktet mejksore nën suaza të Unionit Evropian ku patentimi mbrohet dhe vazhdohet në afat për periudhen e caktuar me një zgjatje maksimum 5-vite dhe u lejohej që produkti i patentuar të lëshohet në treg.

3.3.4 Direktiva e këshillit EEC 89/104 për harmonizim të legjislacionit të vendeve antare në lidhje me markat tregtare e ndryshuar me vendim të këshillit EEC92/10³⁵

Sipas direktivës në fjalë fusha e veprimit janë individët, grupet, dhe markat të cilat janë të çertifikuara. E veçanta e direktivës janë mbrojtja e shenjave ku në shumë legjislacione të vendeve antare kishte ngecje në legjislacionin e tyre sa i përket mbrojtjes të **shenjave** ku nuk e kishin trajtimin e njejt si markat tregtare që arsyetohej me rrënjën ndesh me legjislacionin e më herëshëm, sipas konceptit të lartpërmendur bëhet një dallim sa i përket arsyetimit absolut dhe ati relevant sa i përket refuzimit të rregjistrimit. Direktiva poashtu përmban edhe rregulla mbi autorizimin e bartësve të markës tregëtare, kufizimin e markës, pushimin e saj, obligimet gjat përdorimit si dhe pasojt e mos përdorimit. Harmonizimi i sistemit të së drejtës mbi markat tregëtare është një punë e gjatë ku me disa rregullativa u afruan që të kalohen barrierat pasi që një gjë të till nevojtej në Unionin Evropajn me krijimin e tregut të brendshëm dhe lëvizjen e lirë të mallrave dhe fuqisë puntore.

³⁴ Cuncil of Regulation (EEC) No 1768/92 of 18 June 1992 concerning the creation of a supplementary protection of certificate for medicine products(**Official Jurnal L 182, 02.07.1992, p.1**) amendet by Regulation (EC) No 1901/2006(**Official Jurnal L 378, 27.12.2006, p1**).

³⁵ Cuncil Directive 89/104/EEC of 21 December 1988 to approximate the laws of the member states relating to trade marks (**Official Jurnal L40, 11.02.1989, p.1**) amendet by Cuncil Decision 92/10/EEC (**Official Jurnal L6, 11.01.1992, p.35**).

3.3.5 Direktiva e Parlamentit Evropjan 98/71/EC mbi mbrojtjen e të drejtave nga dizajni industrial³⁶

Si direktiva mbi markat tregtare poashtu edhe direktiva mbi mbrojtjen e dizajnit industrial vlen për vendet antare të unionit, kryesisht rregullon çështjen të drejtës së përjashtimit personave që kanë të regjistruar dizajni industrial, ati që është i ri, që ka karakter individual, poashtu direktiva parasheh edhe parimet mbi ndalesën e rregjistrimit të dizajnit apo pamundësin e rregjistrimit, apo kufizimit të fushveprimit të ndonjë dizajni që bie ndesh me sigurinë publike dhe moralin. Sipas direktivës 98/71/EC mbrojtja e dizajnit industrial është 5 vite nga data e parashtrimit të kërkesës për rregjistrim porë me mundesi vazhdimi në çdo 5 vite porë jo më shumë se 25 vite, që do të thotë vazhdimi i mund të bëhet maximum 5 herë nga 5 vite.

4.Organizatat ndërkombëtare në lidhje me fushën e pronësi industriale

Një nga fushat më aktive dhe më të zhvilluara në botë në fushën e përafrimit harmonizimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe implementimit e parimeve që dalin nga marrëveshjet në fjalë si në fushën e organizimit, procedurat e aplikimit dhe mbrojtjes të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga ta padyshim që është mbrojtja e pronësisë industriale.

E drejta e rregullimit të pronësisë industriale ku sipas subjektivizmit të së drejtës ndahet në dy grupime edhe atë a.) mbrojtja e pronësisë industriale ku si subjekt kemi mardhëniet që lindin dhe krijohen nga objekti, ku në rast si objekt kemi inovacionin dhe dizajnon, dhe b.) rregullimi i së drejtës ku si subjekt kemi procesin e krijimit të markave tregtare, emri tregtar, shenja e prejardhjes dhe mbrojtja dhe luftimi i konkurrencës jo lojale.


³⁶ Directive 98/71/EC of the European Parliament and of the Council of 18 October 1998 on the protection of designs(Official Jurnal L 289, 28.10.1998 p.0028-0035).

4.1. Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale (OBPI ang. WIPO)³⁷



Një nga 17 Organizatat e specializuara nga Kombet e Bashkuara (UN-Unitet Nations) është padyshim WIPO e krijuar më 1967 për inkurajim të zbuluesve kreatorëve se gëzojnë një mbrojtje maksimale në procesin punën e tyre të lodhshme për të krijuar patenta, marka tregtare, dizajn, të drejta të autorëve dhe për të promovuar atë në aspektin ndërkombëtare.

WIPO nga viti 1967 zëvendëson ose thënë ndryshe është pasues i Byrosë ndërkombëtare për mbrojtjen e pronësisë intelektuale e cila u krijua më 1893 ku si qëllim kryesor ishte mbrojtja e dy shtyllave kyçe të Pronësisë Intelektuale, të Drejtat e Autorit dhe Pronësisë Industriale.



BIRPI (Byroja Ndërkombëtare për Pronësi Intelektuale)³⁸, ku si qëllim kishte administrimin e dy konventave kyçe të Pronësisë Intelektuale :

- Konventa e Parisit mbi Pronësinë Industriale dhe (20, Mars, 1883)
- Konventa e Bernës për të mbrojtur punën letrare dhe artistike (9, Shtatorë, 1886).

WIPO si vazhdimi vazhdoj punën e BIRPI-së në qëllimin e njëjtë dhe kuptohet me përsosmëri gjatë viteve në vijim ku formalisht u krijua me konventën për krijimin e WIPO-së, e cila hyri në fuqi në vitin 1970, ku si qëllim ishte mbrojtja, promovimi i kreativitetit, transferimi i teknologjive në vendet në zhvillim, për të vetmen arsye arritjen dhe zhvillim ekonomik të tyre. Një nga karakteristikat e veçanta të WIPO-së është se është organizatë e

³⁷ Në tekstin në vazhdim do të përdorim shkurtësën WIPO- (World Intellectual Property Organization) ,- www.wipo.int.

³⁸ BIRPI- akronim i **Bureaux for the Protection of Intellectual Property** e krijuar më 1893 në Bernë të Zvicrës.

karakterit global dhe gjeneron vet të ardhurat e nevojshme për funksionim diku rreth 90% të tyre, nga tatimet e procesit të regjistrimit të pronësisë industriale.

WIPO po ashtu është një nga organizatat që është në kontakt të vazhdueshëm dhe përhershëm me vendet anëtare të saj me ndryshimet e mundshme përmasimet në aspektin pozitiv sa i përket pronësis intelektuale, dhe funksionimi si forum, sa i përket politikave, ofrimit të shërbimeve, informimit. Si organizatë e tillë numëron një anëtarësi prej 189 vendeve anëtare me një mision të vetëm harmonizim, mbështetje, drejtim, zhvillim dhe balancim të sistemeve të së drejtës në fushën e pronësis industriale. Mënyra e organizimit funksionimi, financimi si dhe objektivat e WIPO-së janë të parapara në Konventën e formimit të organizatës³⁹.

Sipas konventës së lartpërmendur si lëndë apo objekt mbrojtës të organizatës përfshihen të drejtat që kanë të bëjnë me :

- Punën artistike, shkencore, letrare.
- Preformancat e reformimeve artistike fonogramet dhe të drejtat që dalin nga transmetimit.
- Shpikja(zbulimi) në gjitha fushat .
- Zbulimet shkencore.
- Dizajni industrial.
- Markat Tregtare(të produkteve dhe shërbimeve), emrat tregtar.
- Mbrojtja e konkurrencës jolojale.

Si dhe të gjitha të drejtat, ku si rezultat i punës së intelektit të njeriut në industri, shkencë, literaturë dhe fushën artistike.

Sistemi organizativ i WIPOS përbëhet nga asambleja gjeneral, ku çdo vend anëtarë ka përfaqësuesin e vet si delegat dhe me të drejtë vote. Ku Asambleja gjeneral njëkohësisht zgjedh Drejtorin Gjeneral të WIPOS⁴⁰, aprovon buxhetin e organizatës, shqyrton raporte, aprovon dhe redukton masa të propozuara nga drejtori gjeneral i organizatës. Poashtu asambleja determinon e cili nga vendet jo anëtare, organizata në mes vendeve, apo organizata jo qeveritare do të observoj mbledhjet e asamblesë. Një nga organet e WIPOS, është edhe komiteti koordinativ ku poashtu çdo vend anëtarë ka përfaqësuesin e vet në Komitetin

³⁹ Konventa mbi formimin e WIPO-së nënshkruar në Stokholmë, Suedi 14,Korik, 1967,dhe rishikuar më 28,Shtatorë,1979 po në Stokholmë.

⁴⁰ Director General Francis Gurry nga 1 Tetor, 2008 i rizgjedhur në Maj,2014 me mandate deri më 2020.

Kordinativ, puna e komitetit kordinativ është paraparë në Artikullin 8, pika 3 ku si punë e komitetit është :

- Këshillim, i organeve të organizatës,(asamblenë,drejtorin gjeneral,administratën) .
- Përpilon draft agjendat e Asamblesë gjeneral si dhe draft buxhetin e organizatës.
- Nominim të drejtorit gjeneral të ardhshëm të organizatës.

Puna e komitetit kordinativ është si organ këshillues dhe njëkohësisht mbrojtja e interesave të vendeve anëtare nga përfaqësuesit e tyre në komitet dhe në organizatë si tërësi.

Byroja ndërkombëtare e WIPO-së ku me byronë nënkuptojmë sekretariatin e organizatës, e cila administrohet nga drejtori gjeneral ku drejtori zgjidhet me mandat nga 6 vite i propozuar nga komiteti , drejtori gjeneral është shëf i organizatës, dhe njëkohësisht përfaqësues , prezantues i organizatës. Drejtori gjeneral raporton në bazë të instruksioneve tek Asambleja gjeneral, ai pregaditje draft programin, buxhetin si dhe raportet preliminare të punës që më pas u shpërndanë organeve shtetërore të vendeve anëtare, dhe njëkohësisht organizatës. Roli i drejtorit është aq i rëndësishëm në WIPO, sa që ai s’duhet të pranoj instruksione nga asnjë vend anëtarë, apo organizatë e jashtme, në lidhje me politikat dhe vendimet që merë organizata.

Po ashtu pranë WIPO nga vitin 1994 me seli në Gjenevë të Zvicrës dhe me zyrë nga viti 2010 në Singapor⁴¹, operon edhe qendra për ndërmjetësim dhe arbitrazhi që ofron ndërmjetësim për zgjedhje të çështjeve që kanë të bëjnë me mosmarveshjet, kundërshtimin ndërmjet palëve, nga fusha e pronësis intelektuale duke përfituar në kohë palët dhe në pagesë. Qendra e arbitrazhit dhe ndërmjetësimit operon nga ekspert të lëmi së caktuar, poashtu kjo qendër ofron, mban bazën e të dhënave në lidhje me emrat e domenit, ku njëkohësisht ndërmjetëson për tejkalimin dhe mënjanimin e konflikteve të paraqitur.

⁴¹ <http://www.wipo.int/amc/en/center/background.html>.

4.2. Zyra Evropiane e Patentave EPO- (European Patent Office)



EPO- është organizat ndërqeveritare e vendeve të Unionit Evropian e themeluar më 7, Tetor 1977 në bazë të konventës mbi Patentat Evropiane⁴² në Minhen të Gjermanisë, ku si objektiva kyçe të Zyrës mbi Patenta Evropiane është bashkëpunimi në mes vendeve të Unionit Evropian në fushën e patentave si mbrojtja, në këtë raste duke krijuar një patentë evropiane që do të thotë vendet anëtare të Unionit gëzojnë të drejtën e regjistrimit të patentës evropiane dhe si e drejtë bartësit të Patentës i njihet në gjitha vendet e UE-së. EPO-ja gjithsej ka 38 vende anëtare, vendet e UE-së duke përfshirë Shqipërinë, Maqedoninë, Lihtenshtajnin, Monaco, Norvegjinë, San Marino, Serbinë, Zvicrën dhe Turqinë.

Organet kyçe të EPO-së janë :

1. Zyrat e EPO-së në Minhen të Gjermanisë, me degët e saja në Hagë të Holandës, dhe përfaqësi në Berlin, dhe Vjenë.

2. Këshilli administrativ i EPO-së.

EPO-ja është person juridik dhe udhëhiqet nga presidenti, si përgjegjës për punën dhe raporton pranë këshillit administrativ, presidenti njëkohësisht është edhe prezantues i EPO-së si përfaqësues dhe njëkohësisht edhe udhëheqës i Zyrës Evropiane të Patentave. Presidentin e zgjedh këshilli administrativ, me $\frac{3}{4}$ e votave ku Këshilli administrativ përbëhet nga një delegat i vendit anëtarë.

Gjuha zyrtare pranë EPO-së është gjuha Gjermane, Angleze dhe Franceze, siç shihet në Logon e organizatës, dhe çdo komunikim i organizatës realizoi në 3 gjuhë, si dhe përpilimi i raporteve. Ku edhe aplikacioni që dërgohet pranë Zyrës për Patenta Evropiane patjetër duhet të jetë në njërën nga gjuhët e lartpërmendura, ose në gjuhën e shpikësit mirëpo dokumentacioni i tillë përsëri të përkthehet në njërën nga gjuhët zyrtare të EPO-së.

⁴² The European Patent Convention (<http://www.epo.org/law-practice/legal-texts/epc.html>).

1. Seksioni i pranimit të aplikacioneve	2.Seksioni i Ekzaminimi	3.Devizioni i opozitimit	4.Bordi i Apelit	5.Bordi i apelit i zgjeruar.
Pranimi i aplikacioneve dhe ekzaminimi formal i tyre.	Zhvillon kërkime sa i përket aplikacionit të pranuar.	Përgjegjëse për ekzaminim të çdo kundërshtimi për Patentën Evropiane.	Përgjegjëse për ekzaminimin e Patentave	Shqyrton vendimin e bordit të apelit.

Po ashtu Zyra Evropiane e Patentave ndahet në 5 drejtorët gjeneral, të udhëhequr nga nënkryetarët e EPO-së edhe atë si vijon

Drejtori gjeneral i funksionimit	Drejtori gjeneral i mbështetjes	Drejtori gjeneral i aplikacionit	Drejtori gjeneral i Administratës,	Drejtori gjeneral për punë juridike dhe të jashtme.

Po ashtu EPO-ja ofron edhe shërbimin e parashtrimit të fletëparaqitjeve për patentën online, që është në dispozicion në webfaqen zyrtare dhe krahas bazave të dhënave për Patenta ofron shërbim 24/7 .

4.3. Zyra Evropiane për Pronësi Intelektuale (EUIPO-European Union Intellectual Property Office)



43

EUIPO është zyra Evropiane mbi Pronësinë Intelektuale lartë poshtë e karakterit të WIPO-së porë nën suaza të Unionit Evropian, e cila është organizatë e Unionit Evropian dhe nën kompetenca dhe mbikëqyrje të saj të vazhdueshme me krijimin e zyrës EUIP-it, EPO-së dhe me krijimin e tregut të brendshëm të Unionit Evropian dhe shumë zyra të tjera nga fusha dhe këndvështrime të tjera Evropa dëshiron që të krijoj një unifikim të sistemit të

⁴³ EUIPO (<https://euipo.europa.eu/ohimportal/en>).

funkcionimit, me një centralizim të organeve një proces tejet i vështirë, dhe ndoshta shumë i gjatë. Zyra Evropiane për pronësi Intelktuale me seli në Alikante të Spanjës, më 23 Mars, 2016 si vazhdimësi e OHIM (Organizata për Harmonizim të Tregut të Brendshëm) që kryesisht merrej me regjistrimin e markave të komunitetit dhe dizajnit të komunitetit, kryesisht është organ i ri i krijuar siç thamë nga Parlamenti Evropian dhe Komisioni Evropian.

EUIPO po ashtu ka bazën e të dhënave për marka dhe dizajn të Unionit, dhe po ashtu ofron edhe mundësi të kërkimit online, dhe regjistrim të dizajnit, dhe markës së Unionit. Si patenta evropiane markat dhe dizajni i regjistruar pran EUIPO njihet nga të gjitha vendet anëtare me një regjistrim të vetëm, një karakteristik e veçantë është se komunikimi i zyrës bëhet në të gjitha gjuhët e vendeve anëtare të Unionit Evropian dhe njëkohësisht aplikacioni për regjistrim të markës apo dizajnit të Unionit mund të dërgohet në gjuhën e vendeve anëtare të Unionit.

4.4 Asociacioni ndërkombëtar për mbrojtje të Pronësisë Intelktuale (AIPI)⁴⁴

Ndryshe nga format e mëparshme të paraqitjes të organizatave ndërkombëtare të pronësisë intelektuale AIPI është një shoqatë e vjetër mbi një shekullorë gati 120 vjeçare, ku themelet e krijimit i ka kryesisht menjëherë pas Konventës së Parisit (1883) mbi pronësinë industriale, kryesisht në vitin 1897 si organizatë jo fitimprurëse, jo politike, e cila fushëveprimin e vet e ka globalisht duke grumbulluar rreth 9000 antarë, kryesisht ekspertë të fushës së pronësisë intelektuale, avokat të ndryshëm, agjent të pronësisë industriale, gjyqtarë, shkencëtar, inxhinier duke përfshirë edhe korporatat, dhe një nga asociacionet që merret me analizimin, propozim të ndryshimeve të marrëveshjeve, propozim të harmonizimit të legjislacionit të vendeve, ku si qëllim kyç është promovimi dhe përmasimi i mbrojtjes së pronësisë intelektuale, Asociacioni selinë e vetë e ka në Zvicër. Çdo vit mbahet mbledhja vjetore e anëtarëve të asociacionit ku janë të ftuar diku 2000 antarë që shtjellojnë pikat kyçe programet strategjike për të ardhmen. Mbledhja e fundit u mbajt në Sidnej të Australisë nga 13-17, Tetor 2017.

⁴⁴ AIPI - Association Internationale pour la Protection de la Propriété Intellectuelle (<https://aippi.org/>).

4.5. INTA (Asociacioni ndërkombëtar i markave Tregtare)⁴⁵

Si asociacioni AIPI po ashtu edhe INTA ka të njëjtin karakter dallon fushëveprimi pasi që INTA është asociacion për markat tregtare e cila përbën një shoqatë e cila u krijua si shoqatë jo fitimprurëse e themeluar më 1878 nga 17 . Tregtarë dhe prodhues të cilët e panë të nevojës krijimin e një asociacioni të tillë për mbrojtjen e markave tregtare, sigurimin e legjislacionit të nevojshëm për nevojat e tyre, inkurajimin e të tjerëve si dhe respektimin e të drejtave të Markave Tregtare. INTA me seli në New York City (SHBA) me zyra gati anembanë botës si Shanghai, Santiago, Bruksel, Uashington, dhe me përfaqësues në Gjenevë dhe New Delhi .Si Asociacion i tillë i specializuar në fushën e markave tregtare numëron mbi 30,000 anëtarë të cilët po ashtu janë ekspertë të markave tregtare, jurist, student, korporata të mëdha , me një fjalë kontribues të markave tregtare.

5. Biodiversiteti dhe lidhëshmeria me pronësin industriale

Definimi i biodiversitetit është kompleks mirpo me disa fjalë mund të nxjerrim një kuptim biodiversiteti është një turrje e diversitetit biologjik. Biodiversiteti reflekton numrin, shumëllojshmëri dhe ndryshueshmërinë e organizmave të gjallë.

Ai përfshin shumëllojshmërinë brenda specieve (diversitetit gjenetik), në mes të specieve(llojeve të diversitetit), dhe ndërmjet ekosistemeve (diversiteti ekosistemit⁴⁶).

Termi “diversitet biologjik” u përdor për herë të parë në vitin 1968 nga shkencëtari i faunës së egër dhe ambientalisti Raymond F. Dasmann në librin e tij *A Different Kind of Country advocating conservation*. . Megjithatë, termi u përdor gjerësisht vetëm pas më shumë se një dekadë, duke gjetur përdorim të përbashkët në fushën e shkencës dhe të politikave mjedisore në vitet 1980. Ishte Thomas Lovejoy i cili, në parathënien e librit *Conservation Biology*, ia paraqiti termin komunitetit shkencor.

Biodiversiteti përbën aktualisht një ndër problemet më të mëdha në botë. Është vlersuar se rrjedha ne këtë trend e kërcënimit të ekosistemeve natyrore do të paraqes rrezik për të ardhmen e njerëzimit dhe mund te sjell pasoja të rënda në natyrë.Të dhënat flasin se vetëm ne 100 vitet e fundit, zhdukja e specieve e

⁴⁵ INTA- Internation Trademark Association (<http://www.inta.org/Pages/Home.aspx>).

⁴⁶Konëventa ndërkombëtare mbi biodiversitetin. <https://www.cbd.int/convention/text>

shkaktuara nga njeriu është shtuar rreth 1000 here. Po ashtu rreth 12 % e shpendëve, 23 % e gjitarëve, 25 % e haloreve dhe 32 % e ujëtokësorëve kërcënohen për zhdukje, ndërkaq që rezervat peshkore të botes janë reduktuar deri në 90 % që nga fillimi i industrisë së peshkimit.

Rruajtja e biodiversitetit është detyrim i joni moral që t'iu lemë pasardhësve një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë.

Në konferencën mbi Tokën e mbajtur në vitin 1992 në Rio de Janeiro, Brazil⁴⁷, sollën vendime të rëndësishme mbi biodiversitetin në sferën globale, si dhe sfidat të cilat duhet të përmbushen për rruajtjen e biodiversitetit, ekosistemi. Konventa mbi Tokën cila hyri në fuqi në vitin 1993 është një traktat ndërkombëtar për rruajtjen e biodiversitetit, përdorimin e qëndrueshëm të përzierjeve të biodiversitetit si dhe ndarjen e barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i burimeve gjenetike .

Lidhshmëria në mes biodiversitetit dhe pronësisë Industriale është e karakterit ndërkombëtarë në disa traktate dhe procese duke përfshirë edhe WIPO dhe këshillin TRIPS në Organizatën Botërore të Tregtisë. Me 193 pjesëmarrës të shteteve konventa mbi **biodiversitetin** ka karakter global, ku kërkon të adresoj të gjitha kërcënimet ndaj biodiversitetit dhe ekosistemit, duke përfshirë edhe kërcënimet klimatike, përmes vlerësimeve shkencore, praktikave pozitiv, si dhe përfshirjen e plotë e komuniteteve indigjene.

Protokolli i Cartagenës⁴⁸ mbi biosigurinë është një marrëveshje degë e konventës mbi biodiversitetin , ajo kërkon mbrojtjen e diversitetit biologjik nga rreziqet potenciale që vijnë nga organizmat e gjalla të modifikuara gjenetikisht nga bioteknika moderne .

Traktati përcakton biodiversitetin si ndryshueshmëria mes organizmave të gjalla nga të gjitha burimet duke përfshirë biodiversitetin tokësorë, ujorë dhe komplekset ekologjike, kjo përfshinë shumëllojshmërinë **brenda specieve, ndërmjet specieve dhe ekosistemeve.**

Në Terminologjinë e thjeshtë shumëllojshmëria apo larmi tek format e jetës në biosferë i referohet biodiversitetit. Biodiversiteti është baza e jetës në tokë dhe parësore për funksionimin e ekosistemit, e cila na ofron produkte dhe shërbime pa të cilat nuk do mund të jetojmë. Me ndryshimin e biodiversitetit

⁴⁷ The Rio "Earth Summit", 1992 <http://www.un.org/geninfo/bp/enviro.html>

⁴⁸ Protokolli i Kartagenës mbi biosigurinë 1999 e nënshkruar më 15, Maj 2000 në Montreal, Kanada.

ne ndikojmë fuqishëm tek qeniet njerëzore si dhe tek çdo krijesë e gjallë në tokë.

Një fakt i vërtetuar se vendet në zhvillim janë shumë shumë të pasura me florën dhe faunën e tokës ku 80% e biodiversitetit tokësor është e koncentruar në këto vende e cila është lëndë e parë për bioteknologjinë. Vendet e zhvilluara nuk janë të pasura me burime biogjenetike por janë të pajisura me teknologji zhvillimore dhe hulumtuese. Ata përdorin burimet nga biogjenetike nga vendet në zhvillim. Si rezultat i këtij procesi kemi rrjedhje të pambrojtur të informacionit gjenetik nga vendet e pa zhvilluara drejt vendeve të zhvilluara, dhe në drejtim të kundërt nga vendet e zhvilluara në drejtim vendeve të pa zhvilluara por karakteristik është fakti se rrjedhoja gjenetike nga vendet e zhvilluara në drejtim të atyre në zhvillim është e mbrojtur në të shumtën e rasteve nga Patenta si dhe Të drejtat e mbarështuesve bimor⁴⁹(PBR).

Këmbimi i tillë në mes vendeve në zhvillim dhe atyre të zhvilluara ka ndikimin në biodiversitetin në tokë. Erozioni gjenetik është një ndër faktorët të padukshëm që ndikon në zhdukjen e biodiversitetit.

50



⁴⁹ **Plant breeders' rights (PBR)** https://en.wikipedia.org/wiki/Plant_breeders%27_rights

⁵⁰ <https://s-media-cache-ak0.pinimg.com/564x/e4/87/2c/e4872c4cfc50496842d874ac9312fc83.jpg>

Mardhëniet në mes biodiversitetit dhe pronësinë industriale është subjekt i debateve të vazhdueshme mbi pozicionin e rregullave ndërkombëtare si dhe aplikimin e pronësisë industriale mbi burimet biologjike duke përfshirë bioteknologjinë përdorimin dhe mbrojtjen e dijes të fiseve indigjene dhe komuniteteve lokale. Për të kuptuar lidhshmërinë e biodiversitetit me pronësinë industriale të kthehemi edhe njëherë tek Samiti i Tokës në Rio de Janeiro, Brazil në Qershor, 1992 ku si objektiva u vendosën 3 pika kyçe edhe atë

- **Konservimi i diversitetit biologjik (llojlojshmëria e specieve në natyrë, ajër, ujë) shkurt biodiversiteti për gjeneratat e ardhshme.**
- **Shfrytëzimi i biodiversitetit në mënyrë të qëndrueshme dhe proporcionalisht të barabartë.**
- **Ndarja e përfitimit në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.**

Duke analizuar objektivat e lartpërmendura vijmë në konkluzion se faktori njeri është kyç dhe ka një rol substancial për mbrojtjen e specieve dhe njëkohësisht me menaxhimin burimeve të çmuara për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme. Rruajtja e biodiversitetit është në interes të veçantë në fushën e kërkimeve të bazuara në industrinë farmaceutike. Ku dimë se pamvarsisht të avancimit në zbulimet e medikamenteve nga laboratorët e ndryshëm dhe njëkohësisht pamvarsisht avancimit të inxhinierisë gjenetike, shkencëtarët vazhdojnë të mbështeten tek zbulimet e barërave nga komponent natyral, ku përfshinë kërkimet në komponentët bioaktive të varura nga burimet natyrore si bimë të ndryshme, këpurdha, insekte, mikroorganizma të ndryshme si dhe nga organizmat e botës ujore ku shumica e tyre gjenden në vendet tropikale. Një fakt vërtet interesant në Shtetet e Bashkuara të Amerikës çereku i barnave janë me bazë natyrore⁵¹.

Gjatë konventës mbi **biodiversitetin** pronësia industriale ishte temë debati në mënyrë të vazhdueshme nga pjesëmarrësit, ku si pjesë debati ishte transformimi i teknologjive nga vendet e zhvilluara tek ata në zhvillim, gjë e cila kundërshtohet nga vendet të zhvilluara, pasi që së pari kërkonin harmonizim, siguri dhe zbatim të mirëfillti në lidhje me mbrojtjen e pronësisë industriale në vendet në zhvillim, si një garancion për tejkalim të dallimeve që kishin palët në konferencë.

Dimë se konventa mbi tokën nuk është e vet implementueshme në juridiksionin e vendeve nënshkruese dhe vendimet janë të arsyetueshëm, hapi i ardhshëm

⁵¹ <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/25617672>.

vjen pas disa viteve me nënshkrimin e marveshjes TRIPS, nga 125 vende nga gjithsej 167 të cilët kanë nënshkruar konventën mbi biodiversitetin që tani janë anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë, dhe me nënshkrimin e marveshjes të TRIPS, janë pajtuar mbi të drejtat dhe obligimet që dalin nga kjo marveshje. Ku në kapitullin në vazhdim do të folëm në pika të veçanta mbi TRIPS-in.

Si përmbledhje në fund mund të konstatojmë se me një implementim të drejtë biodiversiteti dhe pronësia industriale janë në harmoni të përhershme pamvarsisht luhatjeve gjatë periudhave nga vendet e ndryshme, për përfitimet e tyre nacionale.

Transferimi i teknologjive në fushën e zbulimit, përpunimit të specieve për të mirën e njerëzimit në botë kërkon njëkohësisht një legjislaturë të mirëfilltë në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave që dalin nga pronësia industriale si një nga faktorët sigurues që mund në proporcion të drejtë të funksionoj harmonia në mes biodiversitetit dhe pronësisë industriale në gjitha vendet pavarësisht të zhvilluara apo në zhvillim të sipër.

Dimë se 80% e biodiversitetit në botë gjendet në vendet në zhvillim dhe në këtë grupim bëjnë pjesë edhe vendet tropikale, ku më së miri do të shpjegojmë lidhjen e biodiversitetit transferimin e teknologjive në vendet në zhvillim.

Investimet në fushën farmaceutike në vendet e ndryshme të botës dhe me suksese të theksuara qoftë aspektin ekonomik, apo atë shkencorë.

Do të ilustrojmë lidhshmërinë në mes biodiversitetit dhe transferimit të teknologjive në vendet tropikale me një shembull hipotetik

Kompania farmaceutike A zbulon një kompleks me komponent kimik që ka interes në industrinë farmaceutike në pyet tropikale, ku një zbulim i tillë ka benificione potenciale si për kompaninë farmaceutike poashtu edhe për komunitetin, vendin. Porë thelbësore është se në vazhdim procesi kërkon punë për zbulimin e mëtejshëm, si pastrimin e komponentit, riprodhimin, apo mënyra tjera eksperimentuese për të ardhur deri tek komponenti final i cili është i sigurt dhe efikas në përdorim. I gjithë ky proces është tepër i kushtueshëm qoftë në aspektin financiarë por edhe në njerëz, teknologji etj. Për një mbrojtje të mirëfilltë të zbulimit dhe përfitimeve potenciale nga ana e kompanisë dhe palëve të involvuara duhet një mbrojtëse maksimale të punës përpjekëse në legjislacionin dhe sistemin e vendit në të cilin mund të bëhet zbulimi, nëse jo atëherë kompania nuk mund të ndërmer asnjë hap të mëtejshëm dhe

komponenti kimik ngelet në vendin dhe formën siç kurë ishte zbuluar dhe pa interes shkencorë dhe pa vlerë.

Po ashtu variacioni i bimorë është i mundur si të regjistrohet si e drejtë ekskluzive e një zbuluesi, i cili krijon nga lloji më i ulët i bimëve variacione të reja konkretisht nga një takon, dhe kjo e drejtë ekskluzive për të disponuar poseduar këtë zbulim të tij atë e regjistrojnë si formë e veçantë e së drejtës nga Pronësia intelektuale, fusha e krijimit, zbulimit, kombinimit të taksonëve të bimëve është e rregulluar në bazë Konventës mbi variacionin e reja bimore⁵² e cila numëron 74 vende të cilët përbëjnë Unionin mbi mbrojtjen e variacioneve të reja bimore si një institucion ndërqeveritarë dhe i pavarur.

Poashtu regjistrimi i variete të reja bimore, ka një rëndësi të madhe në fushën e agrikulturës që mundëson përfitime, rritje të prodhshmërisë së produkteve, efikasitet në luftim e sëmundjeve të bimëve, gjatë krijimit të varietetit të ri bimore me ndërhyrje gjenetike duke bërë edhe më imun bimën e re që zbulohet në qendra të ndryshme për zhvillim dhe eksperimentim të llojeve të reja të bimëve. Zakonisht raste të variacioneve të reja bimore, kemi tek misrat gjenetike të modifikuar, gruri, orizi, pambuku. Një formë e re e regjistruar e Mandarinave në Spanjë me emrin Tango në Maj, 2016⁵³.



⁵² Konventa ndërkombëtare mbi mbrojtjen e variacioneve të reja të bimëve, Maqedonia ka të ratifikuar UPOV Convention më 9, Maj 2011 (International Convention for the Protection of New Varieties of Plants (The UPOV Convention was adopted on December 2, 1961))

⁵³ <http://www.freshplaza.com/article/158911/EU-confirms-protection-for-the-Tango-mandarin-against-the-Nadorcott>.

KAPITULLI DYTË

Koncepti mbi patentat, njohja mbi Entin për Pronësi industriale

2.1. Historiku dhe koncepti mbi patentat

Njeriu është një ndër krijesat që për të realizuar nevojat e veta logjikon dhe mendon për lehtësuar përditshmërinë e tij. Çdoherë është munduar që të krijoj diçka për të lehtësuar për punët e përditshmërisë si mjete për gjah që të sigurojnë kafshatën e gojës më pas krijimi i veglave të punës që në mënyrë më të lehtë të punojnë tokën. Duke u nisur nga ky koncept njeriu çdoherë ka qenë në një far mënyre kreator, inovator, që është munduar të krijoj diçka për të mirë të vetë dhe të njerëzimit atëherë mund të kemi një ide se shpikjet e njeriut kanë ekzistuar dhe ditëve të sodit si inovacion. Me zhvillimin tekniko teknologjik me bumin e industrisë u krijuan kushte dhe lindin nevoja e mbrojtjes të zbulimeve të tilla.

Idet dhe kreativiteti i njeriut siç cekëm është i lashtë sa është i lashtë edhe njerëzimi në tokë, mirëpo si formë e ide e mbrojtur daton shumë herët pikërisht në Greqin e lashtë diku rreth vitit 500 para erës sonë në qytet të Greqisë ku dominohej nga persona të cilët ishin të pasionuar dhe të dhënë pas artit të kuzhinës, ushqimeve të shijshme, pikërisht këtu e ka zanafillën mbrojtja e ideve kreative të njeriut pasi që ky grup njerëzish kishin të drejtën ekskluzive të shitjes së pjatave të tyre shijshme si dhe komoditet të tjera dhe më pas si praktikë u zgjerua edhe në qytete e tjera të asaj kohe që njiheshin si **monopol** (**mono**=i vetëm, **polein**=shitje).


Duke shikuar në aspektin e përgjithshëm edhe **patenta** është në një far forme pjesë e monopolit, ku shpikësit i mundëson kontroll dhe e gjitha kjo kuptohet me një çmim të caktuar përfiton shpikësi për patentën e tij. Në shekullin XVI Gjermani, pikërisht princesha gjermane shpërblente shpikësit e arteve të reja dhe makinerive, njëkohësisht kishte konsideratë të veçantë për shpikjet dhe risit. Po ashtu edhe legjislacioni i hershëm i kolonive Amerikane inkurajonte industrinë e vendeve të jashtme të hapnin prodhimtari në kolonit e tyre duke u siguruar treg të mbrojtur në ata koloni. Po ashtu gjatë periudhës të shekullit XVII-XIX edhe vendet të tjera si Anglia, Franca bënë përpjekje për mbrojtje të shpikjet dhe inovacionit që tu garantonin të drejtën ekskluzive mbi atë shpikje, risi që

njëkohësisht do të kishte benificione për bartësin po ashtu edhe industria e vendit do të kishte përfitime të mëdha pas procesit të futjes në treg, gjë që nuk kaloi edhe pa kundërshtime.

Patentimi i parë në industri ju dha **Filippo Brunelleschi** më 1421 si një arkitekt dhe inovator nga Republika e Firences mbi krijimin e një barke më ndryshe që ishin asokohe, dhe që shërbeu për transportimin e ngarkesave të rënda posaçërisht mermerit përgjatë lumit Arno dhe që njihej me emrin **il Badalone** që nënkupton diçka monstruoze e madhe. Periudha e të drejtës ekskluzive të Patentës ju dha për një periudhë 3 vjeçare.

Poashtu në Venecia në vitin 1450 u krijua sistemi për mbrojtje të patentave, institucion shtetëror që mundësonte mbrojtje të inovacioneve dhe njëkohësisht inkurajonte shpikësit e ideve që të patentojn dhe të realizojn të përfitojn me futjen në industri, mbrojtja zgjate në periudh 10 vjeçare.

Këtë periudh dominonte patentimet në fushën e prodhimit të qelqit.



Konsolidimi i parë i sistemit të patentave u krijua gjatë revolucionit Francez 1791 ku inovatorëve u jepej të drejtë mbi patentën pa ndonjë egzaminim

paraprak dhe konsiderohej si një e drejtë natyrale, mirpo procesi i patentimit ishte një rrugëtim i shtrenjtë gjë që krijonte bariera për patentim të inovacioneve, ku mundësohej edhe rregjistrimi i patentave të importuara, ku më 1844 Ligji mbi patentat u rrishikua dhe në mënyrë drastike u ulën shpenzimet e procesit të patentimit, dhe njëkohësisht u hoq e drejta e patentave të importuara.

Po ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 1787 u propozua edhe neni mbi **patentat dhe markat tregëtare** si pjesë e Kushtetutës së Amerikës ku më 10 Prill 1790 kongresi kaloi ndryshimin e titulluar *një aktvendim që promovon progresin e artit të dobishëm*. Patentimi i parë në SHBA(Shtetet e Bashkuara të Amerikës) ju dha Samuel Hopkins më 31 Korrik 1790 mbi metodën e prodhimit të **patosh**(një kemikal që gjeti përdorim në industri, si dhe për prodhimin e detergjentëve,prodhimin e qelqit). Poashtu në SHBA më 1802 u krijua edhe zyra e parë mbi patentat dhe markat si institucion i ndarë dhe i veçant. Ku sot gati çdo vend i botës ka byrot, institutet kombëtare mbi pronësin industriale.

Të krijojmë, të zbulosh ndonjë metodë mënyrë,të shpikësh që të jetë shpikje e re, të gjej zbatim në industrinë e vendit dhe jo vetëm, të gëzosht të drejtën ekskluzive mbi atë shpikje, inovacion, metodë e cila është e mbrojtur nën emrin **patentë**. Sipas ligjit mbi pronësin industriale të Maqedonisë me patent mbrohet shpikja në të gjitha sferat e teknologjisë, nëse është inovativ, përmban kontribut inventiv dhe i zbatueshëm në industri, poashtu me patentë mbrohet edhe shpikja që ka të bëjë me prodhimin që përbëhet ose përbëhet nga materiale biologjike, procedura për fitimin e materialit biologjik, përpunimin ose përdorimin e tij⁵⁴. Sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë **patenta** jepet për shpikje në të gjitha fushat e teknologjisë me kusht që të përbëjë risi, të përmbaj hap shpikës, të jetë i zbatueshëm në industri⁵⁵ pa asnjë ndryshim e parashef edhe Ligji mbi patenta i Republikës së Kosovës.

Sipas Organizatës botërore të Pronësin intelektuale (WIPO) Patena është një dokument i cili i cili lëshohet nga institucioni kombëtar apo rajonal, që shpjegon zbulimin dhe krijon të drejtë që bartësit të patentës i mundësohet dhe

⁵⁴ Neni 25 pika 1 dhe 2 Ligji për pronësin Industriale (Gazeta zyrtare e RM-së nr21/2009, 24/2011, 12/2014, 41/2014, 152/2015 dhe 53/2016).

⁵⁵ Neni 5 pika 1 ,i ligjit mbi pronësinë industriale të Shqipërisë Nr.9947 i datës 7.7.2008(Ndryshuar me ligjin nr. 10/2013, datë 14.2.2013, nr.55/2014, datë 29.5.2014, nr. 17/2017, datë 16.2.2017).

i jepet e drejt ekskluzive që të përdor në industri të shes të importoj për një periudhë të caktuar zakonisht 20 vite⁵⁶.

2.2 Procesi i aplikimit të patentave (sipas Ligjit pr pronësi industrial të Maqedonisë)⁵⁷

Një ndër format më efikase të mbrojtjes në fushën e shpikjeve, inovacioneve të njeriut padyshim është **patenta**. Si objekt mbrojtje të patentimit është puna e intelektit (mendjes së ndritur të njeriut). Një shpikje që të gëzoj mbrojtje dhe të drejta mbi atë shpikje duhet të plotësohen disa kushte të parapara me ligjet kombëtare të vendit që kërkohet mbrojtje e shpikjes. Shpikja që të mund të patentohet duhet që të jetë në fushën e teknologjisë, duhet të jetë risi (e re) që sjell inovacion në fushën e caktuar dhe e zbatueshme në industri, po ashtu me patentë mbrohen edhe shpikjet në fushën biologjike, shpikjet të cilat përbëhen nga materiale biologjike dhe produkte biologjike.

Sipas marrëveshjes **TRIPS** (neni 27, pika 2 dhe 3) shpikjet që ndikojnë në rendin publik, moralin, mbrojtjen e jetës të njerëzve, kafshëve dhe bimëve si dhe prishja e rendit, duke përfshirë edhe çdo zbulim në fushën e kurimit, diagnostifikimit terapeutic si metodat kirurgjikale për shërimin e njerëzve, kafshëve duke përjashtuar mikroorganizmat dhe proceset biologjike nuk mund të patentohet. Nuk mund të patentohet edhe shpikjet që kanë të bëjnë me klonimin, modifikimin gjenetik në vijë trashëgimore të njeriut, shfrytëzimin e embrioneve të njeriut për qëllime industriale, duke përfshirë edhe shpikjet që kanë të bëjnë me procesin e modifikimit gjenetik të kafshëve që u shkaktojnë vuajtje dhe pa interes të rëndësishëm mjekësorë për njeriun dhe kafshët.

Që një shpikje të mund të patentohet dhe të zbatohet në industri patjetër të jetë risi (e re) nuk është publike pra nuk e njih opinionin si patentë, dhe nuk është e cekur në asnjë fletë aplikacion kombëtar apo të çfarëdo vendi tjetër, duke përjashtuar fleteaplikacionet të cilat janë hedhur poshtë nga enti për X arsye refuzimi të patentimit, patenta përmban kontribut inventiv e konstatuar nga ekspertët se është e qartë dhe siç cekëm e zbatueshme në industri duke përfshirë edhe bujqësinë.

⁵⁶ Wipo Intellectual Property Handbook: Policy, Law and Use. Chapter 2: Fields of Intellectual Property Protection WIPO 2008 (<http://www.wipo.int/export/sites/www/about-ip/en/iprm/pdf/ch2.pdf>).

⁵⁷ Gazeta zyrtare e RM nr 21/2009, 24/2007, 81/2007, 152/2008, 36/11, 18/13, 164/13, 41/14, 33/15, 61/15 dhe 53/16.

Si shpikje e patentueshme nuk konsiderohen teoritë shkencore, metodat matematikore, krijimet estetike, lojërat, programet kompjuterike, paraqitja e informacioneve, trupi i njeriut në të gjitha fazat e evoluimit, apo ndonjë element i izoluar në trupin e njeriut ose i prodhuar në proces teknik i cili përmban sekuenca të gjenit të njeriut.

Procedura për pranimin e të fleteaplikacionit për patentim të shpikjes paraqitet pran Entit, për çdo shpikje që kërkohet patentimi është unike, është unike mirëpo nëse vizitojmë webfaqen e Entit për pronësi industriale të Maqedonisë (www.ippo.gov.mk) shohim se ka disa formular mirëpo në përmbajtje janë të njëjta ku kemi formën e parë si

- P1 formulari i për njohje të patentës pranë EPSHI ,
- P5 formularë për njohje të patentës në bazë të marrëveshjes për zgjerim të Patentave evropiane
- P4 formulari për njohje të patentës në bazë të paraqitjes ndërkombëtare
- P3 formulari për parashtrim ndërkombëtar të fletëparaqitjes sipas PCT⁵⁸

Прилог 1

БАРАЊЕ ЗА ПРИЗНАВАЊЕ НА ПРАВОТО НА ПАТЕНТ
Државен завод за индустриска сопственост

(да се пополни со машина за пишување)

1. Назив на пронајдокот				
2. Подносител на пријавата				
Презиме, име и адреса за физичко лице одделение фирма и седиште за правно лице	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="border-bottom: 1px solid black; padding: 2px;">Телефон</td> </tr> <tr> <td style="border-bottom: 1px solid black; padding: 2px;">Факс</td> </tr> <tr> <td style="border-bottom: 1px solid black; padding: 2px;">e-mail</td> </tr> </table>	Телефон	Факс	e-mail
Телефон				
Факс				
e-mail				
☐ Постојат повеќе подносиители (ДЗИС П1 дополнение 1)				
☐ Изјава за заеднички претставник				
3. Пронајдувач				
Презиме, име и адреса	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="border-bottom: 1px solid black; padding: 2px;">☐ Пронајдувачот не сака да биде познат</td> </tr> <tr> <td style="border-bottom: 1px solid black; padding: 2px;">☐ Пронајдувачот е подносител</td> </tr> </table>	☐ Пронајдувачот не сака да биде познат	☐ Пронајдувачот е подносител	
☐ Пронајдувачот не сака да биде познат				
☐ Пронајдувачот е подносител				
☐ Постојат повеќе пронајдувачи (ДЗИС П1 дополнение 2)				
4. Застапник				
Регистарски број				
☐ Податоци за останати застапници				
5. Адреса за кореспонденција				
Презиме, име и адреса Одделение фирма и седиште	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="border-bottom: 1px solid black; padding: 2px;">Телефон</td> </tr> <tr> <td style="border-bottom: 1px solid black; padding: 2px;">Факс</td> </tr> <tr> <td style="border-bottom: 1px solid black; padding: 2px;">e-mail</td> </tr> </table>	Телефон	Факс	e-mail
Телефон				
Факс				
e-mail				

Об. ДЗИС П1

⁵⁸ Системи ndërkombëtar mbi patentat nga Organizata Botërore e pronësisë intelektuale(PCT- sistem)

6. Начин на спроведување на постапката	
☐ потполно ☐ билатерални договори ☐ во Заводот	
7. Право на првенство	
Сопствено право <i>Име на изобретача односно сопственик</i> <i>Датум на првото изложување</i>	Уческо право <i>Датум на пријава, Број на пријавата,</i> <i>Држава</i>
8. Разделена пријава	
Број на преодната пријава _____ П _____ Датум на преодната пријава _____	
Прилози ☐ Декларација за платената такса ☐ Барање за редукција на таксите и декларација ☐ Полномогство за застапување ☐ Гигералтно полномогство ☐ Податоци за други подносителски ☐ Пријава за заеднички првенственик на подносителскиот ☐ Податоци за други претпоставки ☐ Пријава од претпоставката дека не сака да биде паведено пријавата ☐ Документи за правото на првенството ☐ Потврда за изложување на изготвената изложба на претпоставки ☐ Декларација за датографирање на листи биолошки и/или микробиолошки материјал ☐ Попис на претпоставките и/или амплуаментистички системи ☐ Пријавата е подготвена на странски јазик ☐ Електронска форма (дигитална, CD) ☐ Барање за повторно воспоставување на правото на првенство	Содржина Опис на претпоставки _____ страници Патентни барања _____ страници Нацрти _____ страници Листа на нумерирани амплуаменти _____ страници Вкупен број на страници _____ број на патентни барања _____ број на нацрти _____
Број на нацртот кој се објавува со апстрактот односно патентното барање _____	
Потпис и печат на подносителот односно потпис и печат на застапувачот	Потпис и печат на Државниот завод за индустриска сопственост

59

Duhet të cekim se sipas Ligjit mbi pronësinë industriale të Maqedonisë formulari plotësohet në gjuhen Maqedone, dhe vetëm me shkrimin kirilik, siç duket edhe në formularin dhe nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj si i tillë duhet që të përkthehet .

Formulari për njohje të së drejtës së patentës për shpikjen e caktuar dorëzohet pranë EPSHI(Enti për pronësi industriale) dhe përmban :

⁵⁹ Marur nga webfaqe e Entit për pronësi industriale të Maqedonisë (<http://www.ippo.gov.mk/docs/xFiles/forms/Patent/P-1.pdf>)

1. **Kërkesën për pranim të patentës** ku shënohet shenja e qartë që kërkon pronari për patentim, emrin e shpikësit që pasqyron thelbin e shpikjes, të dhënat e parashtruesit të kërkesës dhe për shpikësin.
2. **Përshkrim i shpikjes** duhet të jetë preciz , dhe i qartë në përmbajtje, që të mundësoj ekspertët të mund të zbatojnë.
3. **Kërkesa e patentës** përcaktohet lënda për të cilën kërkohet patentimi, po ashtu kërkesa duhet të jetë e qartë dhe koncize në përshkrim të patentës duke shënuar kërkesat e varura dhe pavarura duke përmbajtur karakteristika të rëndësishme dhe risit e shpikjes.
4. **Përmbajtja e shkurtë e shpikjes** jepen informata teknike ,vizatime, dizenjoj për shpikjen.

Data e paraqitjes së formularit për patentim është një element i rëndësishëm ku është e domosdoshme të shënohet, po ashtu gjatë dorëzimit të formularit vjen në shprehje e drejta e përparësisë ku nga data e paraqitjes së formularit pranë ESHPI bartësi i shpikjes ka të drejtë përparësie ndaj çdo personi tjetër që dorëzon formular për njohje të patentës në lidhje me shpikjen në fjalë.

Ligji për pronësi industriale njeh disa përparësi edhe atë

- **E drejta e përparësi së panairit** nënkuptojmë të drejtën ku një personi kërkon përparësi në bazë të panairit që nënkupton ekspozimi i shpikës në panair të caktuar në vend, apo vendet anëtare të unionit të Parisit, apo OBT në, ku këtë të drejt mund të kërkoj në afat prej 90 ditëve nga ekspozimi i shpikjes në panair.
- **E drejta e përparësisë së unionit** nënkupton, nëse një person ka të dorëzuar formularë për patentim të shpikjen në ndonjë vend anëtarë të unionit të Parisit,apo OBT, që Maqedonia ka ateruar atëher atë shpikësi do ti njihet e drejta e përparësisë së unionit. këtë të drejt mund të kërkoj 90 ditë nga data e parashtrimt të fletëparaqitjes në njërin nga vendet e unionit.
- **E drejta e shumëfishtë** sipas të drejtës së shumëfish parashtruesi i fletëparaqitjes për patentim mund që në kërkesën për pranim të thirret në të drejtën e shumëfish t ë përparësisë në bazë të më tepër fletëparaqitjeve paraprakisht në një apo më shumë vende anëtare të unionit të Parisit apo OBT-së (neni 40 pika 1, 2.)

Pasi parashtrohet kërkesa për njohjen e të drejtës së përparësisë ENTI jep vërtetim për të drejtën e përparësisë e cila llogaritet nga data e përcaktuar si datë e fletëparaqitjes së patentës.

Procesi i aplikimit për patentim të shpikjes që është e zbatueshme në industri, përmban risi, çdo formular për regjistrim të patentës evidencohet në regjistrin e fletëparaqitjeve të patentave ku më pas pason **kontrolli formal** i formularëve të dërguar pranë Entit, ku kontrollohet paraprakisht se a është paguar taksa administrative e caktuar nga Enti për procesin e patentimit, dokumentacioni formulari, si dokumentet shtesë për patentën në fjalë a janë në gjuhën Maqedoni, a është deklaruar parashtruesi për zbatimin e procesit të kontrollimit, a janë dorëzuar kërkesa për patentim dhe projekti që thirret kërkesa për patentim, a është parashtruar autorizim i rregullt nëse fletëparaqitja është dërguar nga ndërmjetës.

Nëse konstatohen mangësi në dokumentacionin përkatës atëherë Enti njofton parashtruesin e kërkesës për patentën për mënjanim të mangësive në afat prej 60 ditëve të kompletoj kërkesën, pas procesit të kontrollit formal, që thënë ndryshe një kontroll teknik i dokumentacioneve të parashtrës të kërkesës për patentim vazhdon Enti përsëri kontrollon nga fillimi se a është shënuar shpikësi, a është kërkuar e drejta e përparësisë, shpikja a është unike, lënda shihet se shpikja në fjalë a është e patentueshme. Po ashtu nëse enti konstaton mangësi informon bartësin për mangësitë e paraqitura dhe në afat prej 60 ditëve të mënjanoj ose në të kundërtën kërkesa do të hidhet poshtë.

Nëse Enti konstaton se janë plotësuar kushtet e parapa për patentim dhe shpikja është e patentueshme, atëherë njoftohet parashtruesi i kërkesës për patentim se në një afat prej 30 ditësh të shlyej detyrimet e pagesave dhe shpenzimeve për patentim, ku më pas Enti sjell vendim për njohje të patentës dhe regjistrimin në regjistrat e patentave, në ditën e miratimit, dhe publikohet në Buletinin e Entit në afat prej 90 ditëve nga data e miratimit.

Shpikja e cila patentohet nga Enti kombëtar për pronësi industriale, gëzon të drejtat ekskluzive bartësi i patentës në afat prej 20viteve me të drejtë vazhdimi për 5vite.

Në vazhdim një publikim të një patente të rastësishme dhe më të thjeshtë nga baza e të dhënave mbi patentat pranë Entit për Pronësi Industriale

(51) **B 65D 85/804**

(11) **6840**

(13) T1

(21) **2016/568**

(22) 25/08/2016

(45) 30/04/2017

(96) 21/09/2012 EP12805759.3

(97) 06/07/2016 EP2847098

(73) **Hausbrandt Trieste 1892 SPA**

Via Foscari 52

31040 Nervesa della Battaglia (TV), IT

(74) **БЕРИН Д.О.О. СКОПЈЕ**


ул.Македонија бр.27/2/22, 1000 Скопје

(72) **ZANETTI, Fabrizio**

(54) **КАПСУЛА**

(57) 1 Капсула (10) за подготовка на пијалок од прашкаст или гранулиран сиров материјал, којшто содржи тело (12) изработено од полимерен материјал,

споменатото тело (12) има горен завршеток (14) и долен завршеток (16), барем еден од споменатиот горен завршеток (14) и споменатиот долен завршеток (16) е покриен со фолија (18, 20) погодна за затворање на барем еден завршеток (14, 16); телото (12) содржи долен зид кој има барем еден отвор (30), и горна комора (32) која се наоѓа помеѓу горната комора (18) и долниот сид (28); споменатата фолија (18, 20) има јазиче (22, 24), споменатата горна комора има филтер (36) поставен на долниот сид (28) и се состои од слој на пропустлив материјал, споменатата капсула се карактеризира со тоа што филтерот (36) има јазиче на филтерот (38). има уште 5 патентни барања.



Publikimi në fjalë është përmban rubrika me nr ku paraprakisht në Gazetë sqarohen nr e publikuar

- (51) shënohet kodi ndërkombëtar për klasifikim të patentave si ne rastrin tone **B65D 85/804**.
- (11) në rubrikën numri regjistruar i dokumentit
- (13) lloji i dokumentit, ku **A**-patentë, **A1**-patentë me dëshmi, **T1**-përkthim të kërkesës për patentë të pranuar evropiane, **T2**-mbajtje të patentës evropiane me ndryshime në kërkesë.
- (22) data e parashtrimit të fletëparaqitjes
- (45) shpallja e kërkesave të para mbi patentën

⁶⁰ <http://www.ippo.gov.mk/docs/xFiles/gazeta/GL2-2017/GL2-2017.pdf>

- (96) fletëparaqitje ndërkombëtare (Patentë Evropiane) ku shënohet data e fletëparaqitjes për patentën evropiane .
- (97) Shpallja e njohjes së Patentës evropiane. (data e njohjes, dhe nr i gazetës)
- (73) Bartësi i të drejtës së Patentës -
- (74) Përfaqësuesi i autorizuar nga bartësi i të drejtës së patentës
- (72) shpikësi .
- (54) emri i shpikjes
- (57) abstrakti i shpikjes për patentim që shpjegon, dhe sqaron gjithçka mbi shpikjen. Ku në rastin tonë kemi të bëjmë me skicën e një shpikje e titulluar si **Kapsula** ku Skica në vazhdim sqaron materialin që përmban .

Një trend i regjistrimit të patentave është në fakt në rritje, nga viti 2014 në 2015 kemi rritje mbi 20% (sipas Entit për Pronësi industriale) dhe i njëjti trend vazhdon rritjen edhe në 2016, porë një fenomen që vërehet nga analizimi i buetinit të Entit dominojnë shpikjet e huaja, të cilat shtrinë fushën e mbrojtjes edhe në vendin tonë, shpikje paraprakisht të patentuar në vende të ndryshme. Siç kemi të bëjmë me shpikjen në shembull Patentë Evropiane e patentuar në vitin 2012 (21.09.2012).Patentime nga shpikës vendas është tepër i ulët rreth 20-30 dhe nuk ndryshon aq shumë nga viti në vit me rritje 2 ose 3 shpikje.

2.3. Rëndësia e informimit mbi patentat dhe ndikim në zhvillimin ekonomik

Me ndikimin e madh në fushën e zhvillimit industrial në Evropë dhe me bumin e madhe të shekullit XIX –të në industrinë e prodhimit, pronësia industriale ishte një nga shtyllat kyçe të zhvillimit ekonomik e vende në fjalë si Anglia, Gjermania ,Franca, Italia . Pasi që u mundësua që e drejta pozitive e vendeve të mund të siguron mbrojtje më të lartë të ideve, shpikjeve ku shpikësve u jepej edhe një motivim më tepër pasi që industria ishte e uritur për përsosshmëri të procesit të prodhimit, dhe shpikjet e teknologjisë ishin më të kërkuarat kuptohet që materializimi ishte faktori kyç. Po ashtu edhe periudha kur filluan hapat e parë të harmonizim të legjislacioneve në fushën e mbrojtjes, të pronësisë industriale në përgjithësi krijimi i marrëveshjeve, traktateve u garanton shpikësve se shpikjet e tyre do tu përkasin tyre dhe nuk do tu cenohet e drejta ekskluzive.

Shtetet kanë ligje të veçanta që rregullojnë fushën e pronësisë në përgjithësi e në veçanti pronësinë industriale edhe atë për dy arsye kyçe e para të krijojnë një status të drejtave morale dhe ekonomike të krijuesve në vend dhe e dyta të promovojnë politikat qeveritare për inkurajimin e shpikësve të rrijë duke promovuar tregti e drejt që kontribuon në zhvillimin ekonomik të vendit. Me rëndësi është që krijuesve tu mundësohet që sa më lehtë të depërtojnë në tregjet e vendit apo ata rajonal në fushën e patentave me një rrezik të ulët dhe amortizim të investimeve për hulumtimet paraprake në lidhje me shpikjet që më pas patentohet, duket ditur faktin se jetojmë në periudhën e ndikimit të teknologjisë në çdo sferë të jetës është një fakti i pamohueshëm qoftë në prodhim apo ofrim të shërbimeve. Fusha e teknologjisë si proces i cili është në vazhdimësi në zhvillim dhe një trend që gati se nuk mund të ndjeke si në procesin e prodhimit por edhe në atë të ofrimit të shërbimeve në veçanti edhe në vendet në zhvillim.

Por duhet të theksojmë se kritikët e pronësisë intelektuale në përgjithësi dhe në veçanti të pronësisë industriale, nuk janë të mendimit me harmonizimin e sistemit të së drejtës me politikat e WIPO-së duke krahasuar të drejtat e pronësisë intelektuale si kontrollim i tregut, vetëm për qëllime përfitimesh të individëve të caktuar dhe grupeve të caktuara, duke krahasuar me monopolin, ku vetëm një personi(qoftë ai një individ apo grup individësh, organizatash) i jepet e drejtë absolute mi të drejtat, dhe në këtë mënyrë ata caktojnë si në rrafshi kombëtar me imponimin e detyrimeve ndaj institucioneve kombëtare të cilat ratifikojnë marrëveshjet e caktuara në fushën e pronësisë industriale, si në rrafshin global(ndërkombëtar) me dërgimin e dispozitave që duhet të përmbushen , me një qëllim të vetëm monopolizimin e shpikjeve të karakterit publik, duke arsyetuar me faktin se çdo e mirë në tokë është e drejt e çdokujt dhe atë e ka dhuratë nga natyra, posaçërisht shpikjet në fushën e medikamenteve, agrikulturës. Duke analizuar të dy arsyetimet, në kohën moderne në kohën e tregut të lirë të gjithçka duke përfshirë edhe idetë, shpikjet të cilat janë të dobishme në industri, kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit apo rajonit, shikuar në aspektin juridik është gjithçka në të mirë të shpikësve, ideatorëve pasi që u garanton një mbrojtje maksimale të drejtave të shpikjeve duke u siguruar një materializim të ideve të tyre, mirëpo nuk duhet anashkaluar edhe mendimin e kritikëve të pronësisë intelektuale në përgjithësi siç e quajnë **pronësia intelektuale = monopoli i ideve** nuk duhet të anashkalojmë faktin se çdo sistem juridik nuk është i përkryer dhe çdoherë ka zbrazëtira , apo thënë ndryshe interpretim ndër reshta mbrojtja e pronësisë

intelektuale ndonjëherë kalon edhe atë që gjithçka që është ide, shpikje mund të materializohet duke shkelur edhe parimet kyçe të shoqërisë vetëm e vetëm për të arritur tek të ardhurat financiare, me patentim të farave të bimëve, mikroorganizmave, medikamenteve vetëm e vetëm realizimit të profitit, dhe në një far mënyre bëhet kontrollimi i tregut që në terminologjinë ekonomike njihet si monopol për një produkt, apo shërbim të caktuar kurë një subjekt ka të drejtën ekskluzive mbi atë pronë (produkt,apo shërbim). Maqedonia një vend i vogël në gadishullin Ballkanik konkretisht në Pjesën e Evropës juglindore, është një urë lidhëse e Evropës Perëndimore me Lindjen ku kemi gërshetim të interesit, kulturës, ekonomisë por nuk është tu punuar aq sa duhet edhe pse ndikimi i Unionit evropian është i lartë në çdo fushë si standardi jetësor, klima ekonomike, politika duke përfshirë edhe atë të pronësisë industriale, ku siç dimë vendi jonë gati 3 dekada është shtet i pavarur nga Federata Jugosllave nuk jemi atje ku duhet të jemi ndoshta kokëfortësia jonë është një nga pengesat si dhe politika e pushtetit nuk është aq e interesuar për aterrimin e Maqedonisë në familjen e madhe Evropiane, në çdo fushë. Në fushën e pronësisë industriale, nëse bëjmë një analizë të legjislacionit me marrëveshjet ndërkombëtare ku një pjesë të madhe kemi ratifikuar kemi një progres të mirëfilltë posaçërisht dekadën e fundit, por me shumë pak rezultate në fushën ekonomike , arsimore sociale, ku mosha e re është në udhëkryq ndjehet e diskriminuar në aspektin motivimi inkurajimi i për të punuar në çdo drejtim e posaçërisht në fushën e pronësisë industriale ku në vendet e zhvilluara pronësia industriale është një faktor kyç në ekonominë e tyre. Rezultatet janë gati se të njëjta edhe në vendet në rajon si Kosovë, Shqipëri. Shtrohet pyetja ***Pse po ndodhë e gjitha kjo?***

Më mirë do të kisha thënë një pyetje pa përgjigje, sepse përgjegjësin duhet të kërkojmë nga të gjithë sepse të formulosh një përgjigje për pyetjen e tillë është një temë tjetër dhe na duhet të fokusohemi në fushën tonë konkrete pronësinë industriale e konkretisht në lidhje me patentat.

Enti për shtetërorë për pronësi industriale të Maqedonisë (ESHPI) nga periudha 2005-2016 ka bërë hapa me të vërtetë të rëndësishëm dhe pozitiv në ngritjen e çështjes së patentave, duke lehtësuar hapat për shpikësit e ri që të patentojnë shpikjet e tyre në dobi të ekonomisë së vendit dhe në përgjithësi të shoqërisë, në bashkëpunim të vazhdueshëm nga WIPO, EPO(Organizata Evropiane e patentave) si dhe marrëveshje bilaterale me vendet e Unionit në shkëmbim të ideve, përsosëshmëri duke marr shembuj pozitiv nga vendet në

fjalë. Por duhet të dimë se ESHPI nuk mundë që e vetme të përballet me gjitha pengesat që paraqiten pasi që duhet edhe ndihmë e institucioneve tjera si qeveria e RM-së , doganat, e gjitha institucionet tjera për motivim, inspirim të shpikësve për të krijuar shpikjet, duke nisur nga informon në lidhje me rëndësinë e patentave në ekonominë e vendit, realizuar trajnime, panaire të ndryshme, duke marr shembuj vendet e zhvilluara ku si pikësypnim kanë nxënësit që në bankat shkollore e në universitete.

Nga publikimet e Gazetave e ESHPI-së që janë 2 mujore vërejmë një fakte se shpikjet vendore janë të ulëta sa i përket patenta ku çdo vit sillen nga 20 -30 me një ndryshim në vit 3 ose 4 shpikje më shumë, ndërsa Patentat të cilat veç se janë të patentuar në vendet e ndryshme, apo patentat evropiane (EP) dominojnë me njohje e të drejtës së shpikjes në vendin tonë. ki fakt tregon se si vend nuk jemi aq kreativ, dhe nuk kemi vetëbesim se një shpikje e mirëfilltë teknologjike e patentuar ka rëndësi si në aspektin ekonomik për vendin por pik së pari përshpikësin. ***E drejta për të patentuar një shpikje inkurajon investimin me materializimin e patentës ku çon në shtimin e përpjekjeve në kërkim, hulumtim dhe zhvillim në fushën e patentave. Me dhënie e patentës po ashtu inkurajohen edhe investimet teknologjike në industrinë e prodhimit dhe shërbimeve .***

2.4 Llojet e Patentave

Një inovacion , një shpikje, një punë e lodhëshme e shpikësit që është e re në fushën e teknologjisë dhe i zbatueshëm në industri, me qëllim të përsosshmëris dhe lehtësimi në prodhimtari dhe njëkohësisht shpërblimi për punën e kryer, e gjithakjo punë nëse nuk çertifikohet me emrin Patentë e humb vlerën e gjithçkai, siç kemi përmendur disa herë çertifikimi bëhet nga institucionet kompetente në vend siç është **Enti për pronësi industriale** në Maqedoni, **Drejtoria e Përgjithshme e Pronësis Industriale** në Shqipëri apo **Zyra për Pronësi Industriale** në Kosovë, si dhe në çdo vend të ndryshëm të Botës.

Si objekt i patentës është mbrojtja, sigurimi i të drejtave ekskluzive bartësit të patentës si produkt inovativ dhe punë e materializuar, ndërsa si subjekte kemi individin si person i vetëm bartës i patentës apo grup individësh të cilët kuptohet plotësojnë kushtet sipas legjislacionit kombëtar të vendit ku aplikohet për patentim.

Përveç klasifikimit mbi patentat në bazë të përbërjes teknike të shpikjes ku si bazë meret **marveshja e Strasburgut** e sjellur më 1971, ku Maqedonia është antare dhe ka të ratifikuar këtë marveshje në Maj 2003, Patentat klasifikohen në **seksione, grupe, nëngrupe, klasë, nënklasë** e kështu me radhë, që sipas Organizatës Evropiane të Patentës (EPO) kemi diku rreth 67000 klasifikime të Patentave. Siç kemi cekur edhe në fillim tek instrumentet ndërkombëtare klasifikimi bëhet në 8 seksione siç vijon :

- A. Nevojat jetësore
- B. Prodhimtari dhe përpunim
- C. Kimi dhe metalurgji
- D. Tekstil dhe letra
- E. Ndërtimtari dhe xehtari
- F. Maqineri, ndriçim, nxemje, armatim, minim
- G. Fizik
- H. Elektroteknik.

Sipas Entit shtetrorë të Pronësis Industriale të Maqedonisë parashtruesi i fletaplikacionit është i detyruar që të shënoj klasën në fletaplikacion nëse bartësi nuk e bën një gjë të tillë atëherë ekspertët të fushës së caktuar të cilët bëjnë kontrollin e fletaplikacionit e bëjnë shënimin e klasës në të cilën tangon shpikja në fjalë. Përveç klasifikimit të Patentave në bazë teknike të përmbajtjes që është unike për të gjitha vendet të cilat kanë ratifikuar marveshjen e Strasburgut për klasifikim të patentave, sipas ligjit të Pronësis industriale të Maqedonisë kemi edhe lloje të Patentave siç vijon

1. Patenta e rëndomt
2. Patenta sekrete
3. Patenta plotësuese
4. Patenta e mvarur.

1. Patenta e rëndomt, një ndër format më të shpeshta që u jepen bartësve të shpikjeve është patenta e rëndomt, pas gjith proceseve që kalon një inovacion, nga ideja e shpikjes, që parashtruesi i kërkesës duhet të vërtetojë se shpikja në fjalë është e re në fushën e caktuar teknologjike, e zbatueshme në industrinë e vendit, është inovacion në agrikulturë deri tek konkluzioni që parashtruesit të kërkesës i njihet e drejta mbi patentën shpërndarja e çertifikatës nga Enti për Patentë që i siguron bartësit të drejtën ekskluzive që të shfrytëzojë, apo të shes patentën e tij dhe të zbatojë në të mirë të procesit tekniko industrial të vendit.

2. Patenta sekrete sipas Ligjit të Pronësin industriale (neni 71-73) sqaron qartë se çka nënkuptojmë me patentën sekrete, ku çdo shpikje apo inovacioni që ka të bëjë me fushën e mbrojtjes konsiderohet patentë sekrete, ku aplikimi për patentë sekrete bëhet pranë Ministrisë së mbrojtjes të R. Maqedonisë, dhe ministri i mbrojtjes vendos që shpikja në fjalë është sekrete dhe vendos se a plotësohen kushtet për patentë sekrete, nëse shpikja nuk është sekrete atëherë lënda me fletaplikacion dërgohet tek Enti për Pronësi industriale i Maqedonisë dhe zbatohen procedurat e njëjta si patentat e rëndomtë, dhe shpikësit i jepet certifikim si për çdo patentë tjetër.

Shfrytëzuesi i patentës sekrete është ministria e mbrojtjes apo palë e tretë e autorizuar nga ministria në fjalë, nga vet emri sekret ky lloj patentimi ngelet sekret për shoqërinë gjersa është në zbatim dhe shfrytëzim të ministrisë poashtu patentat sekrete nuk rregjistrohet në regjistrin e patentave. Bartësit të patentës sekrete i takon kompenzim të që duhet të jepet për shpikjen në fjalë, ku vlera caktohet nga ministri i mbrojtjes, nëse eventualisht ndodh që bartësi i patentës nuk bie dakord me kundërvlerën e patentës atëherë ka të drejtë që të ngren proces jo kontestimorë pranë gjykatës dhe Organi gjyqësor vendos për lartësinë e kompenzimit.

Nëse patentat sekrete nuk është më në funksion të ministrisë së mbrojtjes thjesht përfundon shfrytëzimi për qëllimet e caktuara, atëherë ministria informon Entin për pronësi industriale dhe dërgon fletaplikacionin tek Enti dhe patentat sekrete shuhet si patentë sekrete dhe rregjistrohet në regjistrin e patentave dhe liqencohet bartësi i patentës.

3. Patenta plotësuese sipas teorisë të së drejtës me patentë plotësuese nënkuptojmë atë patentë e cila është e regjistruar si patentë pranë Entit mirpo për nevojat të caktuara mund të përsoset me ndonjë element apo përbërës duke u përsosur porë që idea apo qëllimi i patentës ngelet i njëjti nga patentat bazë, porë nuk bëhet fjalë për patentë tjetër vetëm përsosmëri e të njëjtës. Afati i certifikimit të patentës plotësuese është aq sa është afati për patentën bazë, që në Maqedoni dhe shumicën e vende të rajonit është 20 vite me të drejtë të vazhdimet edhe 5 vite.

4. Patenta e mvarur definohet si patentë e cila nuk mund të kryej funksionin për qëllimin e vet si shpikje e vetme porë është e mvarur nga ndonjë patentë e dytë i cili është i patentuar veçmas më herët. Pra kemi të bëjmë me dy zbulime të cilat janë të ndërlidhura njëra me tjetrën për të gjetur zbatim në industrinë e

vendit. Si shpikës të patentës mund të të mvarur mund që të jenë dy shpikës të ndryshëm, Patenta A shpikësi 1 dhe Patenta B shpikësi 2 ose Patenta A, B shpikësi 1.

Nëse shikojm aspektin e fushveprimit teritorial kemi të bëjm me dy lloje të patentave edhe atë

1. Patenta nacionale, ku nënkuptojm patenta e cila lëshohet nga Enti kombëtar (si Eti mbi Pronësin industriale Maqedonis, Zyra Amerika e Patentave dhe Markave Tregtare në Amerikë, apo Zyra për pronësi industriale e Shqipërisë) dhe vlefshmëria e patentës është brenda kufijve të atij vendi.

1. Patenta rajonale kemi të bëjm me mbrojtje të patentës në fjalë në teritore më të zgjeruara siç kemi Organizatën Evropjane të Patentave, ku bartësi i patentës dëshiron të mbroj shpikjen e tij në më shumë vende antare të Organizatës në fjalë.

Vërejtje , edhe pse janë bërë përpjeje të shumtë në fushën e pronësis industriale në fushën ndërkombëtare me marveshje, traktate të ndryshme, organizata të fushës së caktuar, nuk egziston një mbrojtje ndërkombëtare për patentat.

Sipas Zyrës Amerika të Patentave dhe Markave tregëtare (**USPTO**) egzistojnë 3 lloje të rëndësishme të patentave edhe atë

1. Patentat e dobishme (utility patents) është një ndër llojet më të shpeshta të patentimit në SHBA që jepet për patentimet e reja dhe të dobishme për prodhimtari, maqineri apo teknologjike, ku bartësit i jepet e drejta ekskluzive mbi shitjen, bartjen importin, për një periudh të caktuar prej 20 viteve. Përafërsisht 90% e aplikacioneve për patentim u referohet si patenta për zbulim, patentat e dobishme dhe për çdo vitë paguhet taksë mirmbajtje për patentat e dobishme.

2. Patenta e dizenjove (design patents) referohet një artikulli një dizenzo në prodhimtari, që i lejon bartësit të drejtën ekskluzive. Patenta e dizenjës jepet për periudh mbrojtje për 15 vite nga data e aplikimit, për aplikimet para 13, Maj, 2005 mbrojtja është 14 vite. Patentat e dizenjës nuk janë subjekt pagese për taksën e mirmbajtjes.

3. Patentat bimore (plant patents) janë patente që jepen për bimët që janë zbuluar, riporodhuar, si hibride që nuk janë në kundërshtim me biodiversitetin dhe janë të dobishme për botën bimore the shtazore në tokë dhe njëkohësisht të

zbatueshme në industri. Bartësit të patentës i jepet e drejt ekskluzive mbi patentën në fjalë si dhe mbrojtje për një periudh prej 20viteve, poashtu siç tek patenta e dizenjove edhe patenta bimore nuk paguhet taksa e mirmbajtjes.

2.4.1 Revokimi i Patentës

Refuzimi i patentës apo thënë ndryshe revokimi i patentës që parashtruesi i kërkesës për patentim, ku sipas të drejtës pozitive të vendit dhe atë rajonale bëhet nga Enti për Pronësi industriale, që gjat kontrollit, të kërkesës për patentim konstaton mangësi, apo nuk është e qartë e përshkruar pjesa e funksionit, apo nuk është risi në fushën e caktuar për tu zbatuar, ose nuk është funksionimi post regjistrimit në industri dhe kontriboj në ekonominë e vendit. Për procesin e revokimit paraprakisht Enti duhet të informoj parashtruesin e kërkesës për patentim, për mangësit gjat aplikimit që çojnë deri tek revokimi i patentës, ku parashtruesi i kërkesës ka një periudh kohore të arsyetueshme për të arsyetuar kërkesat nga komisioni për patentim, ku në afat maksimal prej 6 muaj.

Poashtu revokimi i patentës pranë organizatës evropjane të Patentës (EPO) ku konstatohen mangësit e lartpërmendura. Poashtu çdo person i tretë që ka interes mbi patentën e lartpërmendur në periudh sa vlen mbrojtja dhe e drejta ekskluzive ka të drejtë të parashtroj kërkes për revokim të patentës nëse ka arsyetime se patenta në fjalë nuk është risi gjë që arsyetohen në bazë të kushteve që një shpikje të njihet si patentë, të njejtën kërkes mund të parashtroj çdo institucion i specializuar në fushën e patentës apo institucion shtetrorë, ku ngrihet proces gjyqësor ndaj bartësit të patentës që nuk përmbushen kushtet e nenit 56 pika 1 të Ligjit për pronësi industriale te Republikës së Maqedonisë edhe atë pranë gjykatës administrative.

2.5 Enti shtetrorë për pronësi industriale të Maqedonis (ESHPI)⁶¹

Një nga institucionet më të rëndësishme në fushën e pronësis industriale padyshim që është zyra për pronësi industriale, që në disa vende quhet zyrë, enti, byroja, të specializuara në fushën e patentave, markave tregtare, dizajnit industrial, treguesve gjeografik e gjithçka që ka të bëj me pronësin industriale.

⁶¹ Enti Shtetërorë për Pronësi Industriale i Republikës së Maqedonisë
(<http://www.ippo.gov.mk/SQ/Perne.aspx>)

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës njihet si Zyra për Patenta dhe Marka Tregtare(USPTO)⁶² njihet me emrin si zyra e patentave dhe markave tregtare që ekziston gati 200vite e krijuar më 1790 ku presidenti George Uashington nënshkroi Aktin mbi Patentat , ku nga 1790 deri në ditët e sodit dhënë më shumë se 8 milion patenta.

Zyra Gjermane mbi Patentat dhe Markat Tregtare ⁶³ e themeluar në Berlin më 1877 si zyra supreme mbi patentat, deri në vitin 1945, ku nga viti 1949 u transferua në Minhen(Munih). Sot Zyra Federative Gjermani mbi Patentat dhe markat tregtare ka një administratë diku 2500 të punësuar dhe operon në Minhen, Jena dhe Berlin e cila funksionon nën portofin e Ministrisë Federatë të drejtësisë dhe mbrojtjes së konsumatorëve (Bundesministerium der Justiz und für Verbraucherschutz).

Në Kosovë ekziston Agjencioni për Pronësi Industriale që vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe industrisë si institucion i vetëm në Kosovë për regjistrim të Pronësisë industriale.Punë e API (Agjencinë për Pronësi Industriale) ⁶⁴ është shqyrtimi i kërkesave për mbrojtje të patentave, markave tregtare,dizajnit industrial, treguesve gjeografik, ky institucion promovon mbrojtjen e pronësisë industriale, propozon ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, rajonale, bilaterale nga fusha e pronësisë industriale, si dhe përmbushjen e obligimeve që dalin nga to, po ashtu mundëson edhe kërkimin në databaze të pronësisë industriale .

Në Shqipëri që nga Marsi i 1993 funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave tregtare e themeluar me vendim të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë në varësi të Këshillit të Ministrave ku me ndryshim të ligjit ⁶⁵ në vitin 2006 shendrohet në Institucion publik për Patenta dhe Marka tregtare por funksioni ngelet i njëjtë regjistrim, mbrojtje dhe harmonizim të legjislacionit me konventat ndërkombëtare. Nga viti 2009 përdor sistemin e të dhënave automatike nga pronësia industriale (IPAS-Industrial Property Autmat System⁶⁶), ku me IPAS nënkuptojmë një sistem i integruar të administratës së pronësisë industriale që bën të mundur përpunimin automatik të markave

⁶² Unitete States Patent and Trademark Office (<https://www.uspto.gov>).

⁶³ Zyra Gjermane mbi Patentat dhe Markat Tregtare (<https://www.dpma.de/amt/geschichte>).

⁶⁴ Agjencia për Pronësi Industriale e Kosovës (<http://kipa.rks-gov.net/>).

⁶⁵ Ligji 9525 nga 25Prill 2006

⁶⁶ IPAS-Industrial Property Autmat System

(http://www.wipo.int/global_ip/en/activities/technicalassistance/faq.html).

tregtare, patentave dhe dizajnëve industriale që është një sistem nën kompetenca të WIPO-së(Organizata Botërore për Pronësi Industriale).

Nga Marsi i vitit 2017 me sjelljen e ligjit të ri mbi pronësinë industriale i miratuar nga kuvendi i Republikës së Shqipërisë ku Drejtoria e përgjithshme për Patenta dhe Marka tregtare zëvendësohen me emrin Drejtoria e përgjithshme e Pronësisë industriale (DPPI) ku si objektiva kyçe të DPPI janë lehtësimet gjatë aplikimit si patenta, marka, dizajno, dhe futja e sistemit elektronik konform dispozitave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO)dhe Organizatës Europjanetë Patentave(EPO). Si dhe përcaktimi ligjor i kriterëve për markat e mirënjohura. edhe ndryshime organizative brenda DPPI-së nga ekspert të specializuar në fushën e pronësisë industriale për nevoja të proceseve gjyqësore.

Enti Shtetërorë për pronësi industriale në Maqedoni

Me pavarësimin e Republikës së Maqedonisë nga Federata Jugosllave filloj një kapitull i ri si në çdo aspekt politik ekonomik, e reforma në drejtësi kapitulli i ri erdhi edhe në fushën e pronësisë industriale në vend, ku më 24 Prill 1992 kompetencat në fushën e pronësisë industriale i mori Ministria e Zhvillimit ku në këtë ministri mund të dorëzohen kërkesa për mbrojtje të pronësisë industriale (mbrojtje të pronësisë industriale nënkuptojmë kërkesa për patentim,kërkesa për regjistrim të markës tregtare,apo dizajnon industriale apo treguesve gjeografik.) Në vitin 1993 Maqedonia u bë anëtare e WIPO-së . Më vonë Zyra për Pronësi industriale u transferua në organ në cilësinë e personit juridik pranë Ministrisë së Ekonomisë.

Ndryshimi më i madh ndodhi në vitin 2002 me sjelljen e ligjit për pronësi industriale, që hapi një kapitull të ri edhe për Zyrën ku ndryshoj statusin në Enti për Pronësi Industriale në rolin e organit të pavarur në administratën shtetërore me kompetenca të veta. Si punë kryesore e ESHPI-së është zbatimi i ligjit, rregulloreve, ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare , krijimin e kushteve për mbrojtje efikase të pronësisë industriale në përputhshmëri me standardet e caktuara nga marrëveshjet, organet ndërkombëtare të pronësisë industriale, dhe paraqitjen si mekanizëm për rritjen e mirëqenies ekonomike, sociale e kulturore në vend.

Enti si vizion ka mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale, rritjen e inspirimit të shpikësve për zhvillimin e pronësisë industriale e në përgjithësi ekonomisë së vendit. Enti në vazhdimi është në kontakt të përhershëm me

WIPO-në, EPO-në, zyrat Entit për pronësi industriale rajonale, e vendeve të Unionit(Unioni nënkupton vendet anëtare të Unionit të Parisit mbi Pronësinë industriale) duke realizuar takime, seminare për përsosshmërin dhe rritjen e efikasitetit në punën e Entit.

Prioritetet kyçe të Entit janë :

1. Rritja e efikasitetit në zbatimin e procedurave administrative për njohje, mbrojtje të drejtave nga fusha e pronësisë industriale.
2. Krijimin e sistemit adekuat të mbrojtjes të pronësisë industriale si shembull vendet evropiane, e vendet e zhvilluara ndërkombëtare(SHBA, Japoni,Kanda).
3. Rritja në fushën e bashkëpunimit me Entet apo zyrat e PI (Pronësia Industriale) në rajon.
4. Rritja e bashkëpunimit të Entit me shoqërinë civile për ngritjen e vetëdijes dhe kulturës që ka të bëjë me PI.
5. Përmisimi i organizimit kadrovike brenda Entit me organizim të seminareve, trajnime për të punësuarit me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë.

Punët kryesore që kryen Enti për Pronësi Industriale janë:

1. Bën pranimin e aplikacioneve për njohje të drejtës nga pronësia industriale
2. Zbaton procedurat administrative në lidhje me fitimin, e të drejtave nga pronësia industriale në pajtueshmëri me Ligjin mbi Pronësinë industriale dhe rregulloret.
3. Zbaton procedurën ndërkombëtare mbi mbrojtjen e PI-së në përputhshmëri me konventat, marrëveshjet e ratifikuara nga vendi jonë.
4. Mban regjistrin mbi fletëparaqitjet dhe të drejtat e fituara nga PI.
5. Shpall në gazetën dymujoreshe Gazetën e Entit në lidhje me publikimet e Patentave, Markave,Dizajnove, Treguesve gjeografik.
6. Mundëson qasje në bazën e të dhënave të Pronësisë industriale (forma elektronike)
7. Përfaqëson vendin tonë në organizimet mbi Pronësinë industriale ndërkombtarishte e në rajon.
8. Ndjek zhvillimet ndërkombëtare konkretisht Evropiane në fushën e PI-së.

9. Jep informacione në lidhje me kërkimet në bazën e të dhënave kombëtare si dhe ndërkombëtare.

10.Promovon Pronësinë Industriale.

Enti Shtetëror për Pronësinë Industriale është organ i administratës shtetërore ku kryesisht financohet me burime vetanake, në rast nevojë nga buxheti i Republikës së Maqedonisë po ashtu edhe nga programe të Unionit Evropian për zhvillim dhe trajnime të administratës, si dhe ndihmë teknike e teknologjike si donacione për përmasimin e kushteve të punës. Enti udhëhiqet nga drejtori, zëvendësdrejtori, kemi po ashtu sektorë të ndara për punë të caktuara, si sektori për patenta, sektori për marka tregtare, sektori për informim, sektori burimeve njerëzore.

KAPITULLI I TRETË

Markat tregtare procesi i rregjistrimit, falcifikimi si një dukuri negative

3.1. Markat tregtare historiku dhe kuptimi i tyre

Marka tregtare është një lloj simboli të shkurtë që përdoret për të identifikuar origjinën e produktit. Benificionet e shfrytëzimit të një simboli të till kundrejt një përshkrimi të gjatë për prodhuesin janë shpesh të gjata, aqë prituese për tu lexar po ashtu nuk janë të lehta për tu mbajtur mend . Marka është më e lehtë për tu identifikuar dhe dalluar poashtu edhe më e shkurt për tu shënuar në produktet e prodhuesit apo ofruesit të shërbimeve. Një nga markat e herëshme në mallra asocion me identifikimin e produktit. Si marka më të vjetra datojnë në kohrat shumë të lashta diku rreth vitit 5000 p.e.s që janë gjetur në copëza të vazove shenja identifikuese në Transilvani (Transilvania është një rajon historik e pjesës qendrore të Rumunisë).Marka të tilla poashtu datojnë edhe në civilizimin Egjiptian,Grek dhe atë Romak, ku filluan të shfaqen edhe marka të ndryshme duke përfshirë dhe shenja të markave botërore.

Pas periudhës Romake pati një periudhë të heshtjes në fushën e markave tregtare me një përjashtim në prodhimin e shpatave ku prodhuesit(farkëtarët) shënonin shenja dalluese posaqërisht në vendet Evropjane.

Përdorimi i Markave tregtare filloj nga shekulli XII-të, ku si printim në produkte nga shekulli XV-të e këndej. Periudha e shekullit XVI-XVII –të ishte periudha kurë filloj sistematizimi (kodifikimi) i rregullimit të markave tregtare në Evropë më së shumti në Gjermani, Francë, e Angli ku nga kjo periudhë daton edhe arti primitive i vulosjes së arit dhe metaleve të çmuara si një shenjë tregtare që simbolizonte cilsin e produktit dhe njëkohësisht origjinën e tij.

Periudha e shekullit XIX-të njihet edhe revolucioni industrial ku bum të madh bënte industria buqësore dhe prodhimet artizanale.Ku filloj edhe ndryshimi në strukturat ekonomike dhe lindë nevoja e rregullimit të konkurrencës . U krijuan edhe standard cilsore dhe sasore të produkteve që çoi në përdorimin e shenjave dalluese për të ndihmuar blerësit në zgjedhjen e drejt të produktit të dëshiruar. Markatregtare reputacionin e duhur e fitoj me zhvillimin e prodhimitaris së llojllojshme, shpërndarjen dhe konsumin në një far forme detyroj përdorimin e markave tregtare, për të mbrojtur produktet si në

aspektin e cilsisë poashtu edhe atë të sasisë dhe njëkohësisht edhe identifikimin. Marka tregtare sjell mbrojtje bartësit të markës duke i siguruar të drejta ekskluzive të përdor atë, të autorizon ndonjë subjekt(individ, juridik) për të përdorur me qëllim materializimi.

Periodha e mbrojtjes varionte varësisht nga vendi në vend, tek ne në Maqedoni kjo periudha e mbrojtjes është 10 vite me mundesi për vazhduar atë. Në kuptim të gjërë markat tregtare nënkupton promovimin e iniciativës dhe sipërmarje në aspektin global duke shpërblyer bartësin e markë me një vlerë të pranuar, mbrojtja e markës tregtare është edhe një faktor kyç në ekonominë e vendit për luftimin e konkurrencës jolojale.

Me krijimin e Organizatës Botërore të Tregtis (WTO) u sollën edhe shumë ndryshime saipërket fushës së mbrojtjes dhe njëkohësisht modernizim të sistemit të mbrojtjes, ku rol të rëndësishëm ka edhe Akti i markave tregtare(1999) , Konventa e Parisit mbi pronësinë industriale si dhe marrëveshja e TRIPS-it.

Sipas Aktit të markave tregtare marka tregtare definohet si **një simbol, një fjalë, dizeno, kombinim fjalësh, frazave apo kombinim i të gjithave** që identifikon një shenjë dalluese për produktet apo shërbimet e një ndërmarrje nga të tjerat duke mos qenë në kundërshtim me rendin publik, moralin.

Po ashtu disa legjilacione njoftin edhe format të tjera të markave tregëtare ku format e markave tregtare të lartpërmendura njifin i **marka tradicionale** ndërsa kemi edhe **markat jo tradicionale** ku sipas marrëveshjes së Singaporit⁶⁷ (2006) në grupimin e markave tregtare njifin edhe hologramet ,markat 3D, ngjyrat, markat e pozicionuara të lëvizëshme, poashtu edhe markat e padukshme si zëri, era, shija, prekja. Një shembull nga jeta e përditëshme fëmimore, ishte periudha si fëmij i moshën 7-10 vjeçe ishte periudha ku i vetmi produkt elektronik në shtëpi ishte TV dhe ishin ato momente të paharuara posaqërisht në mëngjes dhe pasdite ku në TV fillonin filmat vizatimor, shumica nga MGM studio dhe si shenjë dalluese ishte hungurima e Luanit, dhe të gjithë dinimi se fillojnë filmat vizatimor të shumë prituri. Si marka jo tradicionale që nuk preken janë dhënë në literaturë⁶⁸ hungurima e luanit në filmat e Metro-Goldwyn Mayer (MGM),Inc, apo tingëllima bazë e ziles së telefonave celular NOKIA, apo shembulli tjetër era e birrës së hidhur, të gjitha këta llogariten si

⁶⁷ Publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 19/10.

⁶⁸ Faqe 76 libri Pronësia intelektuale Botimi IV-të nga Fatos Dega 2014.

marka tregtare jo tradicionale dhe mund të rregjistrohet në vendet të cilat kanë ratifikuar Marveshjen e Singaporit ku Maqedonia ka të ratifikuar këtë marveshje. Si kusht është mjafton që të jet e kapëshme nga njëra shqys e njeriut.



69

Si denfinicon mund të nxjerrim që me **mark tregtare** nënkuptojm çdo shenjë dalluese e ofruesit të produktit apo shërbimit, i shprehur në shkronja, fjalë, fjali, shenja, grafike, forma, 3dimenzionale, tinguj të ndryshëm, shije , erëra të ndryshme që identifikon një subjekti (indiviti apo juridik) ndaj të tjerëve që nuk janë në kundërshtim me të drejtën pozitive, rendin publik, moralin.

Markat tregtare sot janë një element kyç në ekonominë e vendeve të ndryshme posaqërisht vendet e zhvilluara. Marka tregtare pas rregjistrimit në Entet, byrot kombëtare gëzon të drejta ekskluzive që dallon produktin apo shërbimin e ofruar nga prodhuesi apo ofruesi i shërbimit, marka ndikon edhe në fushën e marketingut ku ndikon edhe në stilin e jetës të individëve, ku kemi marka të cilat kanë kaluar në brend ku jo çdo markë është brend, me aritjen e reputacionit në treg ajo më kalon në brend, siç kemi markat e veturave, pajisjeve elektronike, veshjeve, aksesoreve (orrë, varëse, vath etj) dhe ndikon edhe në aspektin psikologjik të njeriut, ku shpesh të rrinjët mburen me brendi e veturave, apo parfumeve që përdorin, poashtu kemi edhe brendim të produkteve ushqimore .

Poashtu kemi edhe markat e brenduara si motorët e kërkimit në internet si Yahoo, Google , ku Google është një ofrues shërbimesh, motor kërkimi online dhe një ndër markat tregtare më me vlerë në botë⁷⁰

⁶⁹ http://www.bananaip.com/wp-content/uploads/2017/02/640px-Mgm_channel_nl-640x450.png.

⁷⁰ Sipas Forbs vlera është 44.3billion dollarë
(<https://www.forbes.com/pictures/eidl45jl/google/#6f22f4ac15f3>).



71

The Bass Brewery një ndër logot më të vjetra të Mbretëris së Bashkuar (UK) e rregjistruar si fotografia e parë në regjistrin e markave tregtare angleze e pijeve alkolike që daton nga vitit 1876. Kemi edhe shumë marka tjera të cilat datojnë që nga periudha e njejtë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si marka e parë daton Economica Brilliant nga kompania Averill Chemical në vitin 1870.

Një fakt i rëndësishëm sa i përket njohjes dhe informimit markat tregtare të cilat i shofim gati se në çdo produkt është edhe shenja ® dhe ™ po në fakt çka simbolizojn këta shenja dhe ku qëndron dallimi në mes tyre ?

- ® simbolizon se marka që pasqyrohet me këtë shenjë do të thot se marka në fjalë është e rregjistruar dhe si e tillë shonohet me shkronjën R (registered) e futur në reth në fillim është përdorur në SHBA nga zyra për patentat dhe marka tregtare, ku më pas aplikohet edhe në vende të ndryshme të botës po për të njejtin qëllim, përdorimi i shenjës në fjalë pa rregjistrim është shkelje dhe dënohet sipas legjislacionit të vendit ku konstatohet shkelja.
- ™ është një simbol i përdorur për markën tregtare në sistemin **comon law**, zakonisht përdoret në lidhje me markat tregtare të paregjistruara, dhe si e tillë përdoret kundrejt të tjerëve që simbolizon që logoja në fjalë është markë e tyre.

⁷¹ [Case details for trade mark UK000000000001](#), United Kingdom Intellectual Property Office.

Sipas Ligjit për Pronësi Industriale të Maqedonisë është e preferueshme përdorimi i simbolit në fjalë që simoblizon markën tregtare të regjistruar, porë nëse nuk përdoret nuk do të thotë që marka në fjalë nuk është e regjistruar pranë Entit Shtetrorë për Pronësi Industriale të Maqedonisë.⁷²

Poashtu sipas Ligjit për Pronësi Industriale të Maqedonisë me markë tregtare mbrohet shenja e cila mund të paraqitet grafikisht, dhe që është e përshtatçme dhe shërben si dallues ndaj produkteve(mallra ose shërbime) të tjera në qarkullim. Mbrojtja e markës në maqedoni është 10 vite nga data e aplikimit për regjistrim pranë Entit, ku mund të vazhdohet për periudha të pacaktuara nga 10 vite me kushtë që bartësi apo personi i autorizuar nga bartësi i së drejtës mbi markën në vitin e fundit të parashtrij kërkesë për vazhdim të mbrojtjes konkretisht 9 muaj para skadimit të afatit të mbrojtjes(neni 211 ,pika 1,2 LPIM).

3.2 Procesi i regjistrimit dhe llojet e markave tregtare

Një person (fizik apo Juridik) nëse për shenjën që disponon dëshiron që të gëzojë të drejta për shfrytëzim, shënim të produkteve të tij (mallra apo shërbime) të shenjës si fjalë, grup fjalësh, shkronja, numra, dizajn, ngjyrë, kombinim të gjithave duhet që të regjistrojë të njëjtën pranë Entit (Enti për Pronësi Industriale, ku në disa vende si SHBA, Byroja për Patenta dhe markat tregtare) ,që marka tregtare të jetë e mbrojtur nga persona të tretë, të mbrojë produktet e tij në treg, të gëzojë të drejta absolute, thënë ndryshe monopol mbi markën në fjalë. Në Republikën e Maqedonisë, procesi i regjistrimit të markave tregtare bëhet pranë Entit Shtetrorë për Pronësi Industriale dhe në pajtueshmëri me Kushtetutën, ligjet e në veçanti me Ligjin për pronësi industriale(LPIM)⁷³, si dhe marrëveshjet, protokollat, direktivat e Unionit Evropian, ku më e theksuar është Marrëveshja dhe Protokollin e Madridit që ndryshe njihet edhe si Sistemi i Madridit⁷⁴.

Personi i cili dëshiron apo konstaton se për nevoja dhe për të arritur reputacionin e vet për të mbrojtur produktet e veta të regjistron markën tregtare

⁷² Neni 206 pika1,2(Ligji për Pronësi Industriale Maqedoni).

⁷³Gazeta zyrtare e RM-së nr21/2009, 24/2011, 12/2014, 41/2014, 152/2015 dhe 53/2016.

⁷⁴ Marrëveshja e Madridit e publikuar në Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.2/74 e publikuar në vitin 1974. dhe Protokollin e Madridit e shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr .12/02 më 16,Shkurt 2002.

së pari duhet të njoftohet me arsyetimet që përcakton LPIM dhe e drejta pozitive e vendit, ku kemi të bëjmë me dy lloje arsyetimesh edhe atë

1. Arsyetimet absolute për refuzim të regjistrimit të Markës tregtare dhe

2. Arsyetimet relative.

Arsyetimet absolute që një markë tregtare sipas LPIM konkretisht neni 177 i parasheh shumë qartë edhe ata janë:

- 1.1.Një shenjë e lartpërmendur në fillim nuk mund të regjistrohet si markë tregtare ku regjistrimi i së cilës dhe gëzimi të drejtës si markë e regjistruar bie në kundërshtim dhe ndesh me rendin publik të vendit dhe moralin.
- 1.2.Një shenjë e cila nuk mund të paraqitet grafikisht nuk e gëzon statusin e markës tregtare të regjistruar.
- 1.3.Marka që shënon llojin e mallrave apo shërbimeve dedikimin e tyre, kohën , mënyrën e prodhimit,prejardhjen, dedikimin e tyre, mënyrën e prodhimit, kualitetin, çmimin sasinë dhe peshën.
- 1.4.Shenja e cila është bërë e rëndomt në të folmen e përditshme apo në praktikën e vendosur tregtare për shënimin e llojit të caktuar të produkteve.
- 1.5.Shenja e cila shënon vetëm llojin e produkteve(mallra,shërbime).
- 1.6.Shenja e cila përbëhet ekskluzivisht nga forma dhe lloji e nevojshme për arritjen e rezultateve të caktuara teknike, forma që u jep vlerë thelbsore mallrave.
- 1.7.Marka që me pamjen e saj mund të shkaktoj huti në qarkullimi e produkteve të shënuar konsumatorin mesatar në aspektin e prejardhjes gjeografike, llojin e kualitetit ose llojet të tjera të produktit(kurë shënojmë produkti nënkupton mallra dhe shërbime).
- 1.8.Shenja e cila përmban apo përbëhet nga shenja gjeografike që shënohen verërat, apo pijet e forta.
- 1.9.Shenja e cila përbën vulën (qoftë ajo edhe vula katrore) e subjektit, shenjën oficiale dhe vula metalike që shënon kontrollin dhe garancionin e kualitetit të produktit.
- 1.10.Shenja që përmban Stemën shtetërore, apo publike, flamurin, emblemën apo shkurtesën që ndërkombetarisht njihet një vend, apo shkurtesa, stema, emblema të ndonjë organizate ndërkombëtare.
- 1.11.Shenja që përmban stemën,flamurin, shkurtesën që njihet ndërkombtarisht Republika e Maqedonisë në vazhdim(R.M) si dhe

imitimin e tyre (përveç me leje të posaçme të organit kompetent të Republikës së Maqedonisë).

1.12. Shenja që përmban apo imitim personalitete të vdekur të R.M. , persona historik të famshëm (përveç lejes të posaçme nga organet kompetente).

1.12. Emër apo imitim të trashëgimisë kulturore të R.M.

1.13. Shenja religjioze dhe imitim të tyre.

2. Arsyetimet relative për refuzim të markës tregtare

2.1. Me markë tregtare nuk mund të mbrohen asnjë shenjë e cila është identike me ndonjë markë tregtare të regjistruar më herët në regjistruar nga personi tjetër për llojin e njëjtë të mallrave apo shërbimeve dhe që është identike me markën identike të paraqitur më herët apo me markën e bartësit për llojin e njëjtë ose të ngjashëm me mallrat dhe shërbimet.

2.2. Marka tregtare e regjistruar më herët dhe për llojin e njëjtë aplikohet për markë të re atëherë automatikisht bie kërkesa e re për regjistrim.

2.3. Nuk mundet një shenjë të regjistrohet nëse është identike me ndonjë markë tregtare për produkte të ngjashme apo jo të ngjashme për produkte që shënon marka e mëhershme që ka arritur reputacion në vend, ku nëse kemi regjistrim atëherë kemi të bëjmë me konkurrencë jo lojale dhe njëkohësisht dëmtohet reputacioni i markës së mëparshme.

2.4. Po ashtu shenja nuk mund të regjistrohet si markë tregtare me të cilën cenohen të drejtat e fituara më herët në një nga vendet e *Unionit të Parisit, Sistemit të Madridit dhe Organizatës Botërore të Tregëtis (OBT)* ku Maqedonia është anëtare dhe ka të ratifikuar marrëveshjen.

Nga gjitha arsyetimet e lartpërmendura që janë pjesë e LPI –së konkretisht neni 177,178. në konkludojm se për të regjistruar një markë tregtare së pari shenja duhet të jetë origjinale, dhe të mos cenoj të drejtat primare të shoqërisë, vendit apo vendeve anëtare të Unionit të Parisit, OBT-së, Sistemit të Madridit dhe e dyta që është po ashtu tepër e rëndësishme shenja që pretendon të regjistrohet që të shënoj produktet e bartësit të markës tregtare të mos jetë faktor i shkaktimit të huti tek konsumatorët mesatarë gjatë procesit të blerjes, shitjes, importimit dhe shfrytëzimit të produkteve në fjalë të shënuara me shenjën. Ku si parim bazë dhe qëllimi i thjeshtë i markës tregtare është diferencimi ,i produkteve që të jetë më e lehtë e dallueshme, dhe konsumatori të marrë atë produkt që më veç është i njoftuar me të si në cilësi, apo në vlerat e tij.

Por edhe pse legjislacioni e rregullon në mënyrë koncize këtë çështje në vendet e pazhvilluara dhe vendet në zhvillim kemi një numër të madh të produkteve të cilat më të vërtetë cenon së pari të drejtat e bartësve të markës tregtare pastaj shkaktojnë edhe huti tek konsumatori mesatar i produkteve të tilla posaçërisht tek produktet ushqimore, të veshjeve aksesoreve të ndryshëm që më vonë në pikat në vazhdim të shtjellojmë faktet dhe arsyetimet që çonë deri tek kjo fenomen.

Duke pasur parasysh arsyetimit si ata absolute dhe relative të cilat janë një seleksionues fillestar që determinon qartë se shenja a është e regjistrueshme apo jo atëherë mënjanimi i mangësive nëse ekzistojnë, apo ndonjë konflikt i shenjës me marka tregtare të regjistruara më herët si pranë Entit kombëtar si dhe regjistrimit ndërkombëtar nën suaza të sistemit të Madridit kërkesën fletëaplikacionin apo siç njihet në vendin tonë fletëparaqitjen për regjistrim të shenjës si markë tregtare mund të dorëzon personi fizik apo juridik i cili është bartës i shenjës në fjalë apo ndonjë person i autorizuar nga bartësi i shenjës.

Fletëparaqitja e cila është e disponueshme pranë ESHPI (Enti Shtetërorë për Pronësi Industriale të Maqedonisë në vazhdim vetëm Enti) si dhe në webfaqen zyrtare të Entit www.ippo.gov.mk mund të merret fletëparaqitja ku kemi dy lloje të fletëparaqitjeve e para fletëparaqitje për regjistrim të markës tregtare pranë entit që marka e regjistruar njihet nën kufijtë e R.M-së dhe e dyta regjistrim koneforme Sitetit të Madridit që Marka tregtare e regjistruar njihet në vendet që kanë të ratifikuar Marrëveshjen dhe protokollin e Madridit, ku parashtruesi i fletëparaqitjes mund të shënon edhe vendet ku dëshiron të mbrohet marka tregtare. Duhet të theksojmë se këta janë procedurat bazike për regjistrim të markës tregtare, procesi i regjistrimit është struktë dhe detajisht parashihet në bazë të LPI-së së Maqedonisë ku kemi evoluim nga paraqitja e parë e ligjit dhe që nuk do të thotë se mënyra do të jetë e njëjtë edhe në të ardhmen siç dimë e Drejta e pronësisë industriale e në veçanti fusha e markave tregtare është në evoluim të sipër me ndryshimet teknologjike, ku vlen të theksohet se shumica e vendeve të zhvilluara si ata të Unionit Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës Japonia kemi edhe parashtrimin e fletëparaqitjes në formë Elektronike dhe në dispozicion 24/7 dhe po ashtu kemi edhe formën tjetër të aplikimit të njohjes së të drejtës së markës tregtare nën suaza të tregut të brendshëm të Unionit Evropian ku vendet anëtare të UE-së aplikoj për

njohjen e markës tregtare me një regjistrim të vetëm në gjithë vendet e UE-së nën suazat të CTM nën suazat të Zyrës Evropiane mbi Pronësinë Intelektuale (**EUPIO**⁷⁵) ku po ashtu aplikimi bëhet edhe online, ndoshta në të ardhmen edhe vendet tona si Shqipëria, Maqedonia dhe vendet e Ballkanit Perëndimorë me anëtarësimin në UE-në do të shtohet dhe procesi i aplikimi pran EUIPO dhe njohje të markës tregtare nën suaza të Tregut të Brendshëm të familje së madhe Evropiane.

Fletëparaqitja duhet të përmban elementet në vazhdim edhe atë

- a. Kërkesën për njohje të Markës tregtare
- b. Të dhënat e parashtruesit të kërkesës, nëse kërkesa parashtrohet nga persona të autorizuar shënohet personi i autorizuar dhe ceket dhe shënohet edhe bartës i së drejtës .
- c. Pamja e shenjës për të cilën kërkohet mbrojtje.
- d. Lista e mallrave dhe shërbimeve që do të shënohen me shenjën që kërkohet mbrojtje.
- e. Pjesa përbërëse si dhe shtojcat e mundshme që parashtrohen nga bartësi apo personi i autorizuar.

Poashtu një element tepër i rëndësishëm është edhe data e dorzimit të fletëparaqitjes pasi që në bazë të datës konstatohet se kur është bërë kërkesa dhe nëse ndonjë kërkesë e cila parashtrohet pas datës së pranuar kërkesa e parë duke pasur parasysh arsyetimet e lartpërmendur dhe principin i pari dorëzon kërkesën i pari shërbehet rrëzohet kërkesa e dytë. Nëse data është e lexueshme dhe e shënuar në mënyrën e duhur atëherë vazhdohet me procesin e regjistrimit, ndërsa nëse në fletëparaqitje Enti konstaton se data është e palexueshme atëherë organet kompetente për pranim të kërkesës pranë Entit njoftojnë parashtruesin e fletëparaqitjes që në afat të caktuar prej 30 ditëve të mënjanojnë mangësinë, nëse nuk kemi mënjanim të mangësisë në afatin e caktuar atëher Enti rrëzon kërkesën për regjistrim të markës tregtare.

E drejta e përparësisë siç kemi cekur edhe tek parashtrimi i fletëparaqitjes për patentim e njëjta vlen edhe tek marka tregtare, ku nëse parashtruesi i kërkesës kërkon që të njihet e drejta e përparësisë atë duhet të shënon në fletëparaqitje dhe cilën të drejt të përparësisë kërkon që të njihet ku kishim

- **E drejta e përparësisë së panairit** me të cilën nënkuptojmë të drejtën ku një personi kërkon përparësi në bazë të panairit që nënkupton ekspozimi e

⁷⁵<https://euipo.europa.eu/ohimportal/en>

produkteve të shënuara me shenjë që ka parashtruar pranë Entit për regjistrim në panairë të caktuar në vend, apo vendet anëtare të unionit të Parisit, apo OBT në këtë të drejt mund të kërkoj në afat prej 90 ditëve nga ekspozimi të shenjës në produktet.

- **E drejta e përparësisë së unionit** nënkupton, nëse një person ka të dorëzuar formularë për regjistrim të shenjës së caktuar në ndonjë vend anëtarë të unionit të Parisit, apo OBT që Maqedonia ka atëherë atëherë atë shpikësi do ti njihet e drejta e përparësisë së unionit. këtë të drejt mund të kërkoj 90 ditë nga data e parashtrimit të fletëparaqitjes në njërin nga vendet e unionit.

Bartësi i shenjës së caktuar apo personi i autorizuar që parashtron fletëparaqitjen duhet të dorëzoj dokumentacionin përkatës si dhe fletë dëshmi për panairin e mbajtur i pranuar nga Enti apo fletëparaqitjen e parë të verifikuar nga organi kompetent ku dokumentacioni në fjalë duhet të përkthehen në gjuhën Maqedoni shkrimi kirilik duke bashkëngjitur edhe dokumentacionin origjinal (dëshmia ku shënohet vendi data e mbajtjes së panairit apo fletëparaqitja e vendit të regjistrimit të parë varësisht nga lloji i së drejtës së përparësisë)

Pasi që organi konstaton se e drejta e përparësisë njihet për shenjë në fjalë atëherë Enti kontrollon fletëparaqitjen dhe vendos me aktvendim se parashtruesit të kërkesës i njihet e drejta e përparësisë dhe si datë e parashtrimit të fletëparaqitjes i njihet data e përparësisë së cekur në fletëparaqitje, ku njëkohësisht lëshohet edhe vërtetim për njohjen e të drejtës së përparësisë. Nëse njihet e drejta e përparësisë vijon procesi i regjistrimit të fletëparaqitjes në regjistrin e fletëparaqitjeve të Markës tregtare, ku një faktë është i rëndësishëm sa i përket procesit të shqyrtimit të fletëparaqitjeve nga parashtruesit ku kemi dy lloje **marrja e menjëhershme në shqyrtim të fletëparaqitjeve dhe mënyra e rregullt e shqyrtimit të fletëparaqitjeve.**

Procesi i marrjes së menjëhershme në shqyrtim të fletëparaqitjeve ndodh atëherë kur kemi të bëjmë me kundërshtime apo thënë ndryshe përplasje të shenjës që është në proces njohje me ndonjë markë tregtare që nuk është e paraparë nga arsyetimet e përmendura në fillim, procesi i marrjes në shqyrtim të fletëparaqitjes normal ka një taksë të veçantë që paguhet pranë Entit, nëse nuk kemi realizim të taksës në fjalë atëherë Enti merë në shqyrtim fletëparaqitjen në formën e rregullt. Ku gjatë procesit të shqyrtimit të fletëparaqitjes kontrollohet të gjitha elementet që përmban fletëparaqitja duke përfshirë edhe shtojcat të cilat deponohet pranë Entit bashkë me fletëparaqitjen, dhe nëse

konstatohet që ndonjë mangësi në fletparaqitje atëherë njofton parashtruesi i kërkesës që në afat të caktuar më së voni 60 ditë për mënjanim të mangësive, ku me arsyetime të pranuar pranë Entit atëherë afati i mënjanimi të mangësive zgjatet, nëse mangësitë nuk mënjanohet atëherë me aktvendim hidhet poshtë fletëparaqitja dhe për regjistrim nëse gjithçka është në rregull vazhdon procesi i pranimit të fletëparaqitjes pas kontrollimit edhe të kushteve për pranim dhe konstaton se markatregtare është e regjistrueshme dhe fletëparaqitja shpallet në Fletoren zyrtare të Entit.

Me shpalljen në fletoren zyrtare të Entit ku çdo person i vendit apo Unionit të Parisit apo OBT-së që mendon se me shpalljen e markës cenohen të drejtat kanë një afat prej 90 ditëve për të parashtruar kundërshtime dhe vërejtje në lidhje me markën në fjalë. Enti pastaj merë në shqyrtim kundërshtimin dhe Enti vendos që kundërshtimi në fjalë të pranohet atëherë hedh poshtë me aktvendim fletëparaqitjen për regjistrim të markës dhe po ashtu me aktvendim vendos për rrëzim të kërkesës për kundërshtim dhe për të njëjtën njofton edhe parashtruesin e kërkesës dhe njëkohësisht parashtruesin e kërkesës për regjistrim të markës tregtare.

Me kalimin e të gjitha pengesave dhe mangësive nëse paraqiten për regjistrim të markës atëherë Enti njofton parashtruesin në afat prej 30 ditëve nga aktvendimi se Marka tregtare regjistrohet dhe duhet të paguhet taksat për regjistrim dhe shpenzimet dhe të shpallet në Gazetën dymujorëshe të Entit në lidhje me regjistrimin e markës dhe gëzon të drejtat mbi markëntregtare ndaj të tjerëve.

Me përfundimin e regjistrimit të markës tregtare Enti lëshon vërtetim në lidhje me regjistrimin markës në afat prej 6 muajve me një vlefshmëri të markës në afat prej 10 vite me të drejtë vazhdimi të pa limituar. Por nëse marka e regjistruar në një afat prej 5 viteve rishtazi nuk përdoret atëherë kemi të bëjmë me pushimin e vlefshmërisë së markës tregtare apo për shkak të mosaktivitetit të bartësit të markës tregtare.

Sipas LPI-së bartësi i të drejtës së markës tregtare të regjistruar pranë Entit ka të drejta *ekskluzive* mbi markën si shfrytëzimi në qarkullim, vendosja e shenjave tek produktet e veta, të përdor simbolin ®.

Maqedonia ka arritur prospekt të konsiderueshëm sa i përket procesit të regjistrimit të pronësisë industriale e në veçanti mbi markat tregtare duke ditur se vendi jonë ka të ateruar në shumicën e organizatave ndërkombëtare mbi

pronësin intelektuale dhe ka të harmonizuar dispozitat kyçe që dalin nga këta marrëveshje duke adoptuar atë në legjislacionin e vendit duke ngecur në fushën e mbrojtjes të markave tregtare(brendeve) botërore në praktikë.

3.2.2 Llojet e markave tregtare

Duke ditur faktin se me bumin teknologjik kemi një laramani të markavetregtare varësisht se çka merret për bazë. Nëse shikojmë klasifikim e markave që bëhet në bazat e të dhënave mbi markat tregtare qoftë baza e të dhënave mbi markat tregtare të vendit⁷⁶ dhe bazat e të dhënave mbi markën tregtare ndërkombtare si TMclass, TMView, DSView, Espacenet, Romarin, Hague Express, Lisbon search kemi të bëjmë me klasifikim e markave në bazë të Marveshjes së Nicës (sjellur në Nicë, Francë më 1957) që njihet me shkurtesën NCL⁷⁷(ku Maqedonia ka të ratifikuar këtë marrëveshje në vitin 1993) ku sipas kësaj marveshje kemi të bëjmë me klasifikim e markave tregtare të mallrave dhe shërbimeve në fushën ndërkombtare, pra nga vendet të cilat kanë të ratifikuar këtë marveshje.

Klasifikimi i markave tregtare sipas marveshjes përbëhet nga lista edhe atë

34 lista mallra

11 lista shërbime

Ku nga 1, Janar 2017 kemi edicionin e 11të të Klasifikimit të Markave tregtare sipas NCL. Në aspektin ekonomik pjesa më e madhe e biznese që shfaqen në treg kanë një formë identifikimi për produktet e tyre, ku dallohen për punën që bëjnë dhe njëkohësisht bëjnë brendi të produkteve të tyre për të ofruar cilësi, sasi dhe kënaqja e konsumatorëve me një qëllim arritja e një profiti të konsiderueshëm si shpërblim për punën e tyre qoftë prodhimtari apo ofrim të shërbimeve, ku një nga asetet e pa prekshme poashtu mjaft të rëndësishme padyshim janë edhe markat tregtare .

Gjatë përcaktimit të llojit të markave tregtare nëse për bazë larim subjektet në treg konstatojmë se kemi të bëjmë me :

- a. **Marka tregtare që shënohen mallrat** ku kemi të bëjmë me identifikimin e mallrave me markën e tyre ku si e tillë mund të jetë shenjë, fjalë, emër, simbol apo çdo kombinim i mundshëm që është reregjistruar pranë Entit, dhe dallon mallrat e ofruesit nga mallrat e të tjerëve, kështu që ndihmohen edhe konsumatorët gjatë zgjedhje së mallrave të caktuar, markat që shënohen produktet shpesh herë janë brende të krijuara dhe si të tilla njihen konsumatorët dhe më lehtë orientohen gjatë procesit të blerjes së produktit, dhe rreziku është më i vogël sa i përket gabimit gjatë procesit të blerjes .

⁷⁶<http://www.ippo.gov.mk/Search/TrademarkSearch.aspx>.

⁷⁷ Marveshja e Nicës mbi klasifikim e

Markavetregtare(<http://www.wipo.int/classifications/nice/en/preface.html>).

- b. **Markat tregtare që shënohen shërbimet** është markë tregtare që bartësi i së drejtës shënon shërbimet e tyre me markë për të dalluar nga të tjerët në treg për shërbimet që ofron. Si shembull kemi biznes që shënojnë shërbimet e tyre të integruara telefonike, celular, internet, TV ku konsumatori i shërbimeve të caktuara e din se shërbimet e njërës apo tjetrës kompani dhe në bazë të fushatës së publiciteti, informim në dyqanet apo statet e tyre zgjedhin më të mirën për nevojat e tyre pa krijuar huti gjatë procesit të zgjedhjes.

Aspekti tjetër i rëndësishëm i ndarjes së markave tregtare është edhe regjistrimi i markave ku kemi:

- a. **Markat tregtare nacionale** marka e tilla regjistroen pranë Entit nacional për pronësi industriale apo byrove për patenta dhe markat tregtare dhe marka që regjistrohet pranë Entit është një markë e cila gëzon të drejtën e markës tregtare e cila mbrohet nën kufijtë territorial të vendit .
- b. **Markat tregtare rajonale** ku fushëveprimi i njohjes së markave të caktuara është një rajon i caktuar i cili përbëhet nga disa vende dhe marka në fjalë gëzon të drejtat e njëjta në të gjitha vendet e rajonit, ku si shembull kemi markat e komitetit (CTM-Community TradeMarks) ku regjistrimi i tillë mundësohet nga zyra për harmonizim të brendshëm pranë Unionit Evropian (OHIM) me lokacion në Alicante të Spanjës.
- c. **Markat ndërkombtare** edhe pse mund të quhen si të tilla pasi që regjistrimi bëhet pranë Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale (WIPO) nën sistemin e Madridit me seli në Gjenevë të Zvicrës, ku dimë se ende nuk kemi një legjislacion ndërkombtarë që bëhet njohja e markave tregtare në të gjitha vendet e botës. Një markë tregtare që të njihet pranë WIPO-së pari duhet që marka tregtare të jetë e reregjistruar dhe e njohur si (Registered Trade Mark) në Entin nacional ose në atë Rajonal të Unionit Evropian që pastaj të pasoj regjistrimi pranë WIPO, ku parashtruesi i fletëparaqitjes për regjistrim të markës tregtare për njohje ndërkombëtare atë e parashtron pranë Entit nacional me shënim për njohje ndërkombëtare (në bazë të sistemit të Madridit) duke shënuar vendet ku kërkon njohje.

Në bazë të subjekteve të shfrytëzimit të së drejtës së Markës Tregtare kemi të bëjmë me

- a. **Marka Tregtare për shfrytëzim individual** është një formë më e shpeshtë sa i përket shfrytëzimit të markës tregtare bartësi i markës në fjalë shënon produktet e veta me markën e caktuar duke përdorur atë në treg (kombëtar, rajonal, ndërkombëtar)
- b. **Marka Tregtare për shfrytëzim nga subjekte të kontraktuara** ku dallon nga forma e parë ku bartësi i së drejtës autorizon apo i jep të

drejt shfrytëzimit të markës nga subjekti me një marrëveshje apo kontratë paraprake.

Në bazë të pjesmarësve të bartësve të markës tregtare kemi të bëjmë me

- a. **Markat tregtare individuale** si forma më e thjeshtë e markave tregtare ku bartësi i markës shfrytëzon atë për shënim të produkteve të veta.
- b. **Marka tregtare kolektive** kemi të bëjmë me një formë tjetër të markës tregtare ku një grup bartësish të markave të caktuara, apo asosacione vendore, një mikse mes atyre vendore dhe ndërkombëtare zakonisht si shembulli në figurën në vazhdim, që kemi të bëjmë me Kafën Keniane.



Po ashtu një ndër markat kolektive e cila është edhe markë e mirënjohur është marka kolektive Melinda ku fermerët më se 2000 vjet, kanë kultivuar mollën e Luginës Val di Non provincën Trento pjesën veriore të Italisë. Një karakteristikë është se molla e kultivuar në këtë pjesë të Italisë kultivohet në lartësi mbidetare prej 500-1000 m dhe mollët e luginës në fjalë janë karakteristik për ngjyrën e tyre dhe një shije unike. Kultivuesit frutave të luginës e përdorin teknika të integruar të prodhimit bujqësor që synojnë reduktimin e përpunimit kimik duke përdorur metoda natyrore biologjike . Ku nën këtë markë janë diku 16 kooperativa bujqësore që në përgjithësi kanë 5000 anëtarë dhe prodhojnë diku mbi 300,000 tonelata mollë nën brendin e njohur **Melinda®** dhe me një sukses të pakrahasueshëm në fushën e kultivimit të mollëve dhe përbëjnë 5% të prodhimit të mollëve në Unionin Evropian me eksport gati se në të gjitha vendet e botës



fig. 3

78

c. **Markat e certifikuara** po ashtu një formë e markave tregtare ku si bazë ka mbrojtjen e cilësisë, prejardhja, mënyra e përdorimit, ku si trend i gjigantëve dhe brendeve të ndryshme botërore si figura në vazhdim që gati se kemi rastisur të gjithë në të shohim



79

Ku marka certifikuese CE nënkupto që produkti i cili ka në ambalazhin e tij apo vet produkti ka të shënuar këtë shenjë do të thotë se ai produkti ka të kaluar kontrollet dhe është i sigurt për tu futur në tregun e Unionit Evropjan. Poashtu kemi edhe markën e njohur për ushqimet Halal që do të thotë produkti për tu certifikuar me këtë shenjë duhet të përmbahet rregullave të caktuara që më herët dhe është i lejuar për besimtarët mysliman fig4



80

⁷⁸ Fig3. Marur nga webfaqja zyrtare e Conzorcio Melinda (<http://www.melinda.it>)

⁷⁹ CE Konformiteti Evropjan që do të thotë Produkti i caktuar ka kaluar test e kontrollës dhe është i sigurt për tregun e Unionit Evropjan (Conformité Européene Directive 93/68/EEC in 1993.)

3.3 Markat e gjeneratës së re, sekreti tregtarë dhe know-how të

Llojet e markave tregtare dekadën e fundit me zhvillimin e teknologjisë vizuale dhe komunikative kanë evoluar dhe si një trend i viteve të fundit, për këtë arsye edhe ikam quajtur si marka të gjeneratës së re pasi që nuk do të ishte e mundur që një 3D markë të rregjistrohej në periudhën e rregjistrimit të Coca-Coles. Ku sipas përkrahësve të këtij lloji të markave tregtare mjafton që marka të jetë e kapëshme nga njëra nga shqisat e njeriut, nuhatje, dëgjim, shikim, prekje.

Laramania e shenjave dhe ndryshimet e vazhdueshme në fushën e teknologjisë, shfrytëzimi i marketingut *online* detyron që edhe sistemi juridik që rregullon të drejtat dhe obligimet që dalin nga pronësia industriale e në veçanti markat tregtare është dhe do të jetë çdoher në evolucion të sipër që për të siguruar një mbrojtje maksimale, për inovacionet në fushën e markave. Sipas nenit 15 pika 1 nga marrëveshja e TRIPS-it ku ceket se çdo shenjë ose kombinim shenjash të cilat dallojnë mallrat dhe shërbimet e bartësve të shenjës së caktuar nga të tjerët duhet të jenë të afta të përbëjnë një markë tregtare. Pra është shumë e qartë se subjekti bartës i markës duhet që të diferencoj produktet e tyre nga të tjerët në treg (të mbrendshëm, rajonal apo ndërkombëtar) me shenjën e cila është e qartë e kuptueshme, të mos jetë në kundërshtim me rendin publik dhe moralin, ku shenja nuk kufizohet se duhet të jetë shkrim, apo grafikisht e paraqitur. Vendet antare të OBT-së janë të lirë të vëndojnë kushte se marka duhet të jetë e paraqitur në formë vizuale, duke patur parasysh faktin se markat jo tradicionale si do priten nga konsumatorët, dhe a do të plotësojnë qëllimin për të cilin është destinuar që në fillim marka, pra diferencimin e produkteve duke lehtësuar blerësit, shfrytëzuesit gjat procesit të zgjedhje së produktit që kërkojnë. Nga forma e paraqitjes së markave jo tradicionale dallojmë:

1. **Markat tregtare me shenja vizuale.**
2. **Markat tregtare me shenja të padukshme.**

Markat tregtare me shenja vizuale ndahen si vijon :

1. Markat 3 dimensionale (3D) ku me markë 3D nënkuptojmë paraqitja e markës tregtare në formën të dukshme dhe shifet në gjitha anët si marka 3D kemi formën e produktit, paketimi, mbështjellja (ambalazhi) janë shenja të cilat mund të jenë markë tregtare e bartësit të së drejtës, nuk duhet të anashkaluar

⁸⁰ Fig4. Marur nga (<http://www.whfc-halal.com>).

fakti se rregjistrimi i markave të tilla në disa vende shkakton pengesa për rregjistrim me arsyetimin se forma, paketimi i produktit nuk mund të mbrohen pasi që bie në grupimin teknik të produktit, dhe si e tillë shkelet parimi i funksionalitetit ,mirpo gjat gjurmimit në internet dhe shfletim të literatures ndërkombtare shofim se egzistojn forma të tilla të markave të rregjistruara e poashtu edhe në Komunitetin Europjan mbi markat tregtare njifen sit ë tilla duke patur parasysh parimin e distingivitetit.Në vazhdim kemi disa shembuj mbi markat 3D :

Shembulli i pare kemi të bëjm çokoladën Tobleron ku forma e ambalazhimit është e rregjistruar si markëtregtare pran Zyrës Europjane të Markave Tregtare (CTM) dhe më20.04.1998 **Toblerone** rregjistrohet I markë 3D si në fig5.⁸¹




Ku kemi edhe refuzime të shumta të rregjistrimit të markave 3D, si shembull me çokolladat KIT KAT të Nestles nga Zyra Britanike për Pronësi intelektuale, apo shembullin tjetër të refuzimit nga Byroja Amerikane e patentave dhe markve (USPTO) ku kemi refuzim të rregjistrimit të lojës kubike si 3D Markë, ku shumica e refuzimeve ndodh pasi që Byrot për të vendosur se një markë e tillë ado të rregjistrohet apo jo duke patur parasysh parimet e funksionalitetit, distinktivitetit, duke patur parasysh edhe aplikim e tyre.

2.Ngjyra si markë tregtare përdoret gati se çdo shenjë për të dalluar mallrat, apo shërbimet e tyre nga kompanit e ndryshme në botë ndoshta edhe fusha e marketingut e luan rolin e vetë gjat zgjedhjes së markës për subjektin, ku edhe ngjyrat përfshihen në grupin e shenjave të rregjistrueshme dhe kombinimi

⁸¹ EUTM nr 000031203 (<https://euipo.europa.eu/eSearch/#details/trademarks/000031203>)

i ngjyrave të ndryshme. Duke patur parasysh trendin e kohës së fundit aplikimi për markë tregtare duke përdorur ngjyrat është në rritje. Porë personalisht mendoj se aplikimi i ngjyrave si shenjë dalluese dhe e regjistruar si markë tregtare është diçka e tepruar, mendoj se aplikimi i ngjyrave në markë fillon të humbë qëllimin kryesor të markave tregtare pasi që nuk e luan rolin për të cilin është krijuar marka dhe mund të shkaktohet huti tek konsumatori sa i përket zgjedhjes së produkteve sepse perceptimi i ngjyrave është diçka më komplekse dhe njëkohësisht më e rëndësishme për tu perceptuar dhe mbajtur mend. Ku në shumicën e vende kërkohej që parashtruesi i kërkesës për regjistrim të ngjyrave si markë tregtare të ofroj dëshmi se publiku është i familjarizuar me ngjyrën për subjektin e tij dhe mund të meret si shenjë dalluese. Në vazhdim kemi disa shembuj të regjistrimit të ngjyrave si marka tregtare

Fig6⁸² ku kompania Kraft regjistroi ngjyrën pink si markë tregtare në vitin 1999 dhe shërben për të shënuar produktet e tyre të çokolatave



3.Hologramet si marka tregtare është një nga markat tregtare jo konvencionale dhe njëkohësisht e regjistruara në disa vende, problemi kryesor Byroje nacionale për pronësi industriale qëndron në faktin se si Hologrami në fletparaqitje do të mund të paraqitet në letër, dhe kjo është një nga pengesat kryesore të regjistrimit të Hologrameve në formën 2D(dy dimensionale) dhe 3D(tre dimensionale). Ku shtypja në letër e imazhit të tillë nuk do të prodhojë efektet e lëvizjes së imazheve. Shembull kemi regjistrimin e hologramit të MasterCard pranë Byros për Pronësi Intelektuale të Kanadasë ku në vitin 1996 u regjistrua Hologrami nga Mastercard International me nr Aplikimi 815400⁸³ fig7

⁸² Kraft Foods Schweiz Holding GmbH EUTM 000031336(<https://euipo.europa.eu/eSearch/#details/trademarks/000031336>).

⁸³ http://www.ficpi.org/_uploads/files/2010-Munich-6-3-Polson-Ashton.pdf



4. **Sloganet** në shumicën e legjislacioneve të vendeve të ndryshe poashtu edhe sloganet mund të rregjistrohen si marka tregtare nëse kanë aftësi për të diferencuar mallrat, shërbimet e një subjekti i cili është bartës i markës në fjalë. Sloganet në shumicën e rasteve përdoren nga markat e mirnjohura për tërheqje të konsumatorve për produktet e tyre dhe zakonisht sloganet janë mjaft të njohura për publikun zakonisht përdoren të inkorporuar në markë tjetër .

Shembull kemi Sloganin **JUST DO IT**⁸⁴ ku bartësi i markës tregtare është edhe i markës NIKE.

5. **Titujt e librave dhe filmave** poashtu edhe titujt e librave apo filmave mund të rregjistrohen si marka tregtare, si tituj të serialeve, revistave periodike, të cilat luajnë edhe rolin e markave tregtare, mirpo titujt që janë të një përdorshëm si një titull libri nuk mund të rregjistrohet si markë tregtare. Si shembull kemi edhe rregjistrimin e titullin e filmit **Harry Potter**⁸⁵ i cili është rregjistruar si markë tregtare në Zvicër.

6. **Shenjat lëvizëse** ku me shenjë lëvizëse nënkuptojmë lëvizjen e ndonjë objekti apo kombinim, apo ndonjë shenjë multimediale fotografi lëvizëse, e cila me zhvillimin e teknologjisë dhe shfaqen në ekrane televizive, apo kompjuterike. Si shembull kemi rregjistrimin e markës lëvizëse pranë Komunitetit Evropian mbi Markat Tregtare (CTM) rregjistrimin në fig⁸⁶

⁸⁴ JUST DO IT e rregjistruar pran USPTO me nr4902036 data 16.02.2016 (<https://trademarks.justia.com/867/62/just-do-86762618.html>).

⁸⁵ Switzerland (Reg. No. 486 730), classes 9 and 41: "HARRY POTTER"

⁸⁶ European Community (Reg. No. 3429909), Classes 9, 28, 38, 41.



7.Markat e Pozicionuara poashtu janë shenja specifike që mund të rregjistrohen si marka tregtare ku nënkuptojmë si shenjë dalluese kemi të bëjmë me pozicionimin të markës në produktet e subjektit


Si shembull kemi vendosjen e markës Levis në xhepin e pasëm të xhinseve, apo shembullin tjetër ku kemi të rregjistruar markën tregtare tek pelenat e fëmijëve fig9⁸⁷



8.Markat e lëvizëshme kemi të bëjmë me lëvizjen e imazheve gjat shfaqjes së markës dhe gjat procesit të aplikimit të markës në fjalë parashtruesi I rregjistrimit të markës duhet që në letër të paraqes në formë imazheve të gjitha pozicionet lëvizëse të markës në fjalë si në fig10⁸⁸

⁸⁷ Switzerland (Reg. No. 465 214), class 25.

⁸⁸ Finland (Reg. No. 229446), classes 9, 25, 28, 38 and 41.



Markat tregtare me shenja të padukshme

1.Markat e zërit (tingullit) edhe tingujt mund të jenë shenjë dalluese e subjekteve të caktuara,ku zërat mund të jenë zëra muzikorë apo sekuenca të shkëputura nga ndonjë tone muzikorë,poashtu tingujt mund të krijohen apo të meren nga natyra siç janë.Kemi cekur rastin me kompanin Amerikane studion e filmave MGM(Metro-Goldvyn-Mayer).Ku tingulli i Luanit është shenjë dalluese e kompanis MGM.

2.Markat e nuhatjes Si një ndër shenjat e regjistrueshme jo tradicionale edhe aroma ,ku siç kemi cekur më herët një shenjë duhet të jetë dalluese nga të tjerët që të mund të regjistrohet si markë tregtare,të ofroj ekskluzivitet , ku shenja e aromës është marur nga natyra apo e fituar nga ndonjë kombinacion kimik.

3.Marka e shijes ku në disa vende ofrohet edhe shija si shenjë dalluese, edhe pse shijimi është pjesë e konsumimit të produktit, dhe bie parimi i dallueshmëris dhe shija është gjithashtu pjesë e pandashme e produktit.

Si konkluzion mund të konstatojm se viteve të fundit gati se çfardo lloj shenje të cilat ndoshta edhe nuk humbin parimin e dallueshmëris , funksionalitetit, ndoshta dalin edhe nga koncepti i Markave tregtare, poashtu sa i përket cështjes së titujve të filmave,librave, markat me sekuenca filmike apo markat e tingujve revistave të ndryshme si mundësi të regjistrimit si markë tregtare, mendoj se kemi një gërshetim të pronësis industrial me të drejtat të autorit. Ku në shumicën e rasteve të regjistrimit të shenjave të tilla si marka tregtare kemi refuzim, sepse del nga kornizat e çka është markë tregtare.

Markat tregtare është një shenjë e regjistruar pranë organeve kompetente shtetore apo ndërkombëtare e dallueshme, dizeno apo shprehje e cila identifikon produktin e një subjekti krahas të tjerëve dhe dallonë atë.


3.3.1 Know how-të

Po ashtu edhe know-how-të si modelet e shfrytëzimit janë nën mbrojtje të së drejtës të pronësis industriale ku në realitet me knowhow të ballafaqohemi gati se çdoher pasi që me blerjen e ndonjë produkti që në vete përmban edhe skemën e përdorimit që nëse përkthejm fjalën know-how (know= të dijs, how= si) që në faktë kemi të bëjm me njohuri të caktuar të personave në lidhje me mënyrën e përdorimit, më së shumti knowhow-të janë sekret dhe janë të ndërlidhura me patentat. Know how-të edhe pse nuk rregjistrohen mirpo si të tilla kanë rëndësi të madhe posaqërisht mbi shfrytëzimin e patentave, dhe modeleve të shfrytëzimit edhe pse nuk rregjistrohen poseduesi i një know how ka monopol mbi përmbajtjen e know how-së.

3.3.2 Sekreti Tregtar

Nëse shikojm në aspektin global, si çelës i suksesit të bizneseve të mdhaja, korporatave gjigante padyshim për të aritur suksesin e tyre në fushën e tyre të veprimit kanë një sekret në punën e tyre, në mënyrën e organizimit, meaxhimit, financimit, marketingut, mënyra se si furnizojn konsumatorin final, dhe njëkohsisht mënyra e shitjes si çelës i suksesit që të tjerët nuk e kanë dhe mundohen që me çdo kusht të sigurojnë atë është një **sekret tregtar**.

Si definicion mund të nxjerrim se sekreti tregtar është një dukuri apo një princip një formulë, një dokument, një skicë pune, një model prodhimi apo çdo document që është çelsi I suksesit paraqet sekretin tregtar. Sekreti tregtar është i mbrojtur ligjërisht, pavarësisht ndryshimeve të legjislacioneve kombëtare që janë të ndryshëme, lartë poshtë siguroj një mbrojtje pore në fakt konkretisht shikuar skemi të bëjm me mbrojtje objketive pasi që nuk dime çka mbrohet pasi në publik shfaqet si sekret tregtare dhe informacionet e tilla janë të mbrojtura për publikun, në momentin kur informacioni i tillë bëhet publikë në atë rast pushon sekreti tregtar dhe më nuk quhet sekret tregtar. Për të egzistuar sekreti tregtar duhet që të jenë dy elemente kyçe **ndërmarrja (korporata, kompani,biznesi)** dhe **sekreti**. Në përgjithsi kemi të bëjm me dy lloje kyçe apo thënë ndryshe dy forma të sekretit tregtar.



- ✚ **Sekreti industrial** në këtë rast kemi të bëjmë me sekretin në mënyrën e prodhimit, në mënyrën organizative të kompanisë në lidhje me procesin e prodhimit, me mënyrën e sigurimit të lëndës së parë.
- ✚ **Sekreti komercial** në këtë rast kemi të bëjmë me egzistimin e mënyrave të ofrimit të produktit në treg, mënyra se si plasohet, mënyra se si organizohet procesi i shitjes, procesi i marketingut si kompania do të bëjë që të thith konsumatorët për produktin e tij, poashtu edhe mënyra e organizimit financiar, që është element kyç i funksionimit të kompanisë.

Korporatat e mëdha harxhojnë shuma të larta të mjeteve për të rrujatur sekretin tregtar (unë do të thoja çelsin e suksesit të tyre). Posaqërisht në ditëve të sodit që globalizimi sa ka të mirat dhe benificionet poashtu edhe mangësit e veta. Mënyra e plasimit të informacioneve dhe teknologjia padyshim që është një sfidë e madhe në fushën e mbrojtjes së sekretit tregtarë. Për sekretin tregtar kemi të bëjmë posaqërisht me mënyrën e mbrojtjes edhe në Marveshjen Trips (TRIPS agreement article 39) ku sipas artikullit 39 përcaktohen standardet në vijim:

- ✚ Informacioni duhet të jetë sekret (të mos jetë i njohur për publikun)
- ✚ Pasi që është sekret duhet të ketë vlerën e vet tregtare.
- ✚ Sekreti tregtarë është subjektive (sekreti i tillë padyshim që është çelësi i suksesit)

Ku konkretisht obligon vendet antare të Organizatës Botërore të Tregtis (WTO) që të mbrojnë informacionin sekret të kompanive të cilat me të vërtet kanë vlera të larta për kompaninë e cila është edhe një nga pikat kyçe të suksesit të tyre. Sekreti tregtarë kategorizohet si pjesë e pronësisë intelektuale dhe si e tillë duhet të gëzon mbrojtje nga institucionet kombëtare të vendeve antare të WTO-së. Në vendin tonë sipas Ligjit për pronësi industriale nuk përfshihet sekreti tregtarë, por mbrojtja e informacioneve konfidenciale, shpallja e informacioneve të tilla në publik që për kompaninë llogjaret si sekret tregtarë, është e dënuar me legjislacionin e vendit, si në fushën e të drejtës civile, poashtu edhe me Kodin Penal të vendit tonë. Porë nëse marrim si bazë krahasimin me të drejtat e pronësisë industriale (patentat, markat tregtare, dizajni industrial, treguesi gjeografik) të cilët gëzojnë mbrojtje dhe për dallim nga sekreti tregtarë rregjistrohen pranë enteve, byrove kombëtare për pronësi industriale, përveç brendëve të ngjohura apo siç quhen ndryshe markat e njohura (marka tregtare të cilat kanë një reputacion të lartë në treg edhe pse mund mos rregjistrohen) gëzonjë një mbrojtje maksimale prej 3 viteve si marka të tilla që ende nuk janë

të rregjistruara sipas Zyrës Evropjane të pronësis industriale. Ndërsa Sekreti tregtarë nuk rregjistrohet dhe vlefshëmëria e sekretit të tillë është i palimituar, gjersa egziston së funksionuari subjekti që është bartës i sekretit të tillë, dhe si i tillë sa i përket mbrojtjes e gjithë bara bie mbi bartësin e sekretit tregtarë.

Një shembull mjaft i suksesëshëm është sekreti tregtarë i korporatës gjigante të prodhimit të pijeve jo alkolike *COCA COLA* të cilët janë mjetat të suksesshëm në fushën e rruajtjes së sekretit tregtar (formula e prodhimit të pijes e cila tashmë është e pranishme në gjithë tregjet botërore) kjo kompani është tepër e suksesëshme në rruajtjen e formulës shekullore të përbërjes së pijes së tillë.

Sekreti tregtarë vs Patentat

Për të bërë një krahasim të tillë së pari duhet të dimë se egzistojnë dy lloje të sekreteve tregtare sa i përket fushës së shpikjes që mund të jetë edhe një shpikje sekret tregtarë.

1. Sekreti tregtarë që fokusohet në procesin e prodhimit dhe inovacionit që në fakt nuk plotsohen kriteriumet për patentim dhe si e tillë mund paraqet vetëm sekretin tregtarë.

2. Zbulimi i zbatueshëm në industri plotëson kushtet për tu rregjistruar si patent, porë në fakt subjekti bartës i zbulimit dëshiron që të mos patentoj atë ide dhe të ngelet sekret tregtarë.

Sekreti Tregtarë	
Anët Pozitive Jetgjatësia(sekreti tregtar vlenë përgjithmon gjersa egziston bartësi i sekretit të tillë. Nuk rregjistrohet në Entë kombëtare dhe si e tillë nuk ka harxhime. Sekreti tregtarë ka efekt të menjëhershëm, Nuk kemi të bëjmë me formalitete për procedura rregjistrimi, mirmbajtje.	Anët negative Nëse zbulohet ,humbet vlera për subjektin bartës. Nëse sekreti tregtarë është publik është i disponueshëm për të gjithë. Fuqia e mbrojtjes nga instrumentet e së drejtës është e dobët. Nëse bëhet publik, si i tillë mund të patentohet nga çdokushi.

Ndërsa patena poashtu ka anët positive dhe negative, ku kemi cekur se jetëgjatsia e patentës është maximum 20 vite nga data e parashtrimit të fletparaqitjes për rregjistrim dhe njëkohësisht kemi të bëjmë me harxhime për procesin e rregjistrimit, dhe taksatim vjetorë për patentën e rregjistruar. Efekti i patentës gëzon të drejtë ekskluzive pas shpalljes nga Enti për pronësi industriale. Nga kjo mund të konstatojmë se sekreti tregtarë është më i dobët në fushën ligjore të mbrojtjes kundrejt të drejtave të tjera nga pronësia industriale dhe si e tillë bara rrëndësia e mbrojtjes mbi kompetencën e subjektet të cilët gëzojnë këtë sekret, dhe si e tillë ata si prioritet gjatë punës të tyre kanë mbrojtjen e sekretit tregtarë si çelës të suksesit të tyre. Gjersa pesha më e madhe në fushën e mbrojtjes i takon bartësit të sekretit tregtar, dhe pikërisht janë ata të cilët krijojnë sisteme, dhe mënyra të mbrojtjes të sekretit të tyre nga sulmet e vazhdueshme të personave të interesuar që të marrin informacione në lidhje me sekretin në fjalë. Mund të konstatojmë se egzistojnë dy forma të mbrojtjes sa i përket të interesuarve për zbulimin e sekretit të tillë dhe kemi të bëjmë me dy forma të mbrojtjes:

✚ **Mbrojtja e brendshme** nënkupton mbrojtja nga sulmet e brendëshme në lidhje me zbulimin e sekretit të tillë, nga të punsuarit të cilët në një apo formë dëshirojnë të përfitojnë nga të interesuarit për zbulim të sekretit, dhe në këtë fushë subjektet bartëse të sekretit, harxhojnë mjete, për sigurim të sekreteve të tilla si gjatë procesit të prodhimit, nëse kemi të bëjmë me sekret në procesin e prodhimit, apo zinxhirit të shitjes, duke organizuar dhe mbajtur trjanimë të vazhdueshme, njëkohësisht duke përcaktuar edhe masa ndëshkimore për zbulimin eventuale, dhe më e rrëndësishmja është besueshmëria tek të punsuarit, ku zakonisht sekretet e tilla u besohen disa personave të punësuar ku si bazë përzgjedhje meren shumë kriteriume.

✚ **Mbrojtja e jashtëme** poashtu një nga fushat që duhet patur parasysh aq shumë është forma e mbrojtjes nga sulmet e vazhdueshme të jashtëme të cilët përdorin forma të ndryshme për infiltrim që me qëllim të aritjes së zbulimit të sekretit tregtar të subjektit që është bartës, një nga sulmet e pranishme të ditëve të sodit është edhe sulmet kibernetike të cilat janë shumë të shpeshta kundrejt subjekteve, që me teknologjinë e fundit informatike, dhe njëkohësisht rjetet sociale luajnë një rol të rrëndësishëm sa i përket ofrimit të informatave për subjekte, këta sulme kryesisht bazohen në dërgimin e emailve, në postën elektronike të subjekteve, ku emaillet që dërgohen përmbajnë softverë të cilët me hapjen e emailit të

dërguar automatikisht instalohen në kompjuter, dhe veprojnë fshehurazi për periudha të gjata pa e vrejtur nga përdoruesi duke instaluar softwer të tillë ata mledhin të dhëna nga database të kompjuterve, dhe nëse arinë të nxjerin ndonjë sekret tregtarë, personat të cilët janë të specializuar në fushën kibernetike këtë gjë e bëjnë vetëm për përfitime, duke marur sekretin tregtarë ata ua shesin konkurentëve të cilët janë të interesuar për sekretet e tilla. Si konkluzion mund të nxjerrim se sekreti tregtarë është një formë e pronësis që bartësi gëzon të drejta ekskluzive mbi sekretin e tillë, dhe që në publik nuk figurojnë informacione mbi të, vetëm se dihet që egziston një sekret i tillë, dhe është tepër i rëndësishëm për subjektin që disponon me të ,sa i përket fushës së mbrojtjes ligjore, mendoj se duhet të sigurohet mbrojtje ligjore më të lartë sa i përket sekretit tregtarë në legjislacionet kombëtare, dhe lirisht mund të konstatojmë se sekreti tregtarë është çelsi i suksesit dhe një formë konkurrese në treg ndaj të tjerëve. Poashtu sekreti tregtarë është i bartshëm tek personat tjerë, të cilët në formë marveshje, liçencimi mund të bartet tek personat e tretë.

89



⁸⁹ Një nga kompanit më të rëndësishme dhe me vlera të larta si Brend(marke njohur) COCA COLA, ruan sekretin tregtarë , duke investuar shuma maramendëse në sigurinë e teknologjisë së fundit për rrujtjen e sekretit të tyre.



3.4 Markatregtare domejnat e internetit (adresat e internetit).

Ndoshta një ndër çështjet të cilat ende nuk është rregulluar siç duhet sa i përket markave tregtare posaqërisht nga Organizata botërore e Pronësis Industriale (WIPO) edhe pse përpjekjet janë të mëdha për tejkalimin menjanimin e konflikteve që krijohen në mes markavetregtare dhe domejnave të internetit(në vazhdim vetëm domejn) ku së fundi nga WIPO ka ekip të specializuar dhe njëkohësisht bazë të dhënave në bashkpunim me rregjistruesit e domejnve në formë të arbitrazhit pa kaluar në procese gjyqësore të cilat janë të gjata dhe shumë më të kushtueshme për tejkalim të konfliktve të tilla. Edhe pse rregjistrimi i domainve si marka tregtare nuk është pengesë nëse nuk thehet parimi i diskrecionit(dallueshmeris) dhe parimi i funksionalitetit.

Kuptimi i domejnve ku kemi të bëjm me një adresë shkronjash e cila në faktë është një adresë interneti me numra (192.122.134.1)porë nga fakti se sikur adresat e internetit të shënoheshin me numra kohën e sodit do të ishte shumë e vështir për tu mbajtur mend nga publiku posaqërisht ku kemi diku mbi 1miliard webfaqe dhe mbi 300milion domeinve të rregjistruar(ku me domain nënkuptojm adresën e internetit, ndërsa webfaqeja hapsira brenda internet domain) dhe që të jet e lehtë për tu mbajtur mend për tu mbajtur mend ajo shënohet me shkronja latine, ku domaini paraqitet në një adresë tekstuale e cila përdoret nga personat(fizik apo juridik). Ku domaini fitohet nga principi

i pari vjen ,i pari shërbehet (first come,first served). Domaini çdoher përdor prefiksin **http:// www** ku **http://** simbolizon protokollin e internetit apo softwerin(programin)që përdoret ndërsa **www** nënkupton serverin **World Wide Web**.

Ku domaini përbëhet nga dy pjesë kyçe edhe atë niveli i lartë(**top level**) dhe niveli i dytë(**second level**) ,edhe pse kemi raste të shumta ku shtohet edhe niveli i tretë,ku zakonisht në nivel të tret shtohen shkurtesat e shteteve(shembull **www.ippo.gov.mk**) ku **ippo** (niveli i dytë, **gov** (niveli i lartë) dhe **mk**(niveli i tretë që njëkohësisht shkurtesa për vendin)Ku në Shtetet e Bashkuara të Amerikë nuk egziston shkurtesa e shtetit. Egziston një numër i limituar i domeinve të nivelit të lartë ku nuk mund të egziston dy domejne të nivelit të dytë, ku kemi nën një domain të nivelit të lartë.Një dallim krahas domeinve dhe markave tregtare është se domain mund të jetë shumë i përafërt me tjetrin me një ndryshim minimal, gjë që nuk egziston me markat tregtare.

Domainet e nivelit të lartë ndahën ndahen në grupe joformale:

Kategoria e parë

.gov domain të rezervuara për institucione shtetrove (www.whitehouse.gov).

.mil domain të rezervuara për institucione dhe organizata ushtarake (www.AF.mil).

.edu domain të rezervuara për institucione edukativo arsimore(www.bu.edu).

Kategoria e dytë

.com domain të rezervuar për kompani ,ndërmarrje, biznese etj.(www.apple.com).

.net domain të rezervuar për shërbime të telekomunikacionit (www.getpaint.net).

.org domain për orgnaizata joqeveritare dhe joprofitabile (www.care.org).

Kategoria e tretë

.int domain të rezervuar për organizata ndërkombtare (www.who.int).

Kategoria e katërt

Ku në këtë grup kemi **ISO 3166** ku ndahet në /1 shënon emrin e shtetit me shkurtësë ,e autonome teritoriale ,teritoreve speciale me ndikim gjeografik , me /2 shënojm nën ndarjet e teritoreve pjesë e shteteve teritoreve autonome shembull provincat, dhe me /3 shënojm kodet e ish shteteve të cilat janë të fshira nga /1 në fakt ish shtetet.

Në fakt me përdorimin aq të madh të internetit në botë dhe duke patur parasysh konfliktet e mundëshme dhe rritjen e numrit të përdorueseve është propozuar dhe miratuar që në nivelin e lartë të domejnëve të shtohen edhe domejnët si në vazhdim :

.fir domejn i rezervuar për bizneset

.store domejn të rezervuar për dyqane shitëse.

.web domejn të rezervuar për subjekte që aktiviteti i tyre ka të bëjë **online** (www).

.arts domejn për subjekte kulturore artistike.

.rec domejn për subjekte të rekracionit.

.info domejn për subjekte të informimit.

.nom domejnë për nomenklaturë personle.

Kalojmë në pyetjen se me të vërtetë a egziston një konflikt në mes domejnve dhe markave tregtare? Pasi që kemi shumë raste që bartësit e markëve tregtare paraqesin padi ndaj bartësve të domejnve pranë gjykatave kompetente të vendeve ku konstatohet shkelja nga bartësit e markave tregtare dhe kërkojnë që kompanit që meren me rregjistrimin e domejnëve që të largojnë nga qarkullimi dhe njëkohësisht çregjistrimi nga rregjistrat e domejnve të rregjistruar. Duke ditur se kohën e fundit domejnët janë një trend në rritje dhe një kohësisht realizojnë profit të lartë si për kompanitë, porë edhe për ekonomin e vendeve . Mirpo bartësit e markave tregtare arsyetojnë faktin se domejni i ngjajshëm apo i përafërt bie ndesh me parimin kyç të krijimit të markave tregtare distinktivitetit(dallueshmëris) dhe e bën çorjentim të

konsumatorve dhe njëkohësisht duke krijuar procese gjyqsore të gjata dhe të shumta posaqërisht në ShBA.

Problemet më të shumta paraqiten në lidhje me domeinët dhe markat tregtare në fushën e përdorimit të domejnve si forma të pamvarura, ku shfrytëzimi i gjatë i domejnve sjell deri tek komercializimi i tyre dhe krijohet një njohje e tyre në publik, dhe kjo njëkohësisht nga bartësit e domejnve të rregjistruar shërben si një nga argumentet më të forta në proceset gjyqsore ndaj markavetregtare tradicional të rregjistruara. Duke shikuar aspektin e politikave ndërkombtare të pranueshme nuk lejohet një rregjistrim të emrave gjenerues në qëllime tregtare, si emrat e domejnve nga fakti që e drejta e shfrytëzimit të domejnve është e drejtë e përjashtuar dhe nëse lejohet rregjistrimi i tillë që do të sjellte komercializimin e tyre dhe përparsi në shfrytëzimet e tilla. Mirpo nëse shikojm dhe bëjm një komparacion të jurisdikcioneve nacionale si dhe disa marveshjeve ndërkombtare, porë pengesa kyçe qëndron pikrisht në **neni 6bis** të konventës së Parisit mbi pronësin industriale si një nga shtyllat kyçe të harmonizimit dhe implementimit të rregullave sa i përket pronësis industriale në rafshin ndërkombtar ku neni në fjalë qartë parashef respektimin e parimit të distinktivitetit ku marka tregtare që të jetë e rregjistruar dhe e pranuar nuk duhet të përmbaj simbole, stema, flamuj, shkurtesa të shteteve apo organizatave ndërkombtare, kode të vendeve të gjitha këta kushtet janë një ndër pikat themelore që një mark të rregjistrohet.

Poashtu një parim tjetër tejet i rëndësishëm është parimi i teritorialitetit, ku një marktregtare mund të rregjistrohet pranë Enteve nacionale, dhe si e tillë ajo vlen mbren kufijve të vendit ku është dërguar aplikacioni për rregjistrim të markëstregtare, ndërsa e kundërta është me domejnet e internetit ku nga momenti i rregjistrimit domejnit nuk ka kufij në fushveprimin etij, dhe dipazonii veprimit është global. Nga e gjitha mund të konstatojmë që problematika në mes domeinit dhe markës tregtare është me të vërtetë është një problematik që duhet të zgjidhet posaqërisht nga Organizata Botrore e pronësin intelektuale edhe pse kemi njëkohsisht një bashkpunim me **ICCAN** (Korporata e internetit për rregjistrim të domejnve dhe numrave) ku WIPO ka krijuar një komision të arbitrazhit që ofron zgjedhje dhe njëkohsisht një bazë të dhënave të domeinve dhe markave, duke kursyer kohë dhe harxhimet. Momentalisht WIPO ka procesuar mbi 37,000 raste të konflikteve të markave dhe domeinve.

3.5 Falcifikimi si dukuri e kriminalitetit Ekonomik.

3.5.1. Historiku i falsifikimit.

Falcifikimi i produkteve është një fenomen që ka ekzistuar qysh në kohërat e lashta të njerëzimit si falsifikimi i markave të produkteve po ashtu edhe falsifikimi i monedhave të asaj kohe, dhe me një trend në rritje viteve të fundit në periudhën e globalizimit, e futjen e teknologjisë në gjitha sferat e jetës, me afrimin si në aspektin ekonomik, komunikimit, poashtu edhe e-commerce ka efektet e saj në pamundësinë e kontrollimit të produkteve kryesisht nga vendet e lindjes së largët si Kinë, Indi. Falsifikimi si një s'mundje e cila përhapet posaçërisht në vendet në zhvillim është gati i pamundur kontrollimi zanafillën ka qysh në periudhën Romake me paraqitjen e para të monedhave të imituara në atë kohë. Po ashtu periudha e renesancës franceze karakterizohet me falsifikim të monedhave ku si shembull kemi mos njohjen e monedhave nga përkrahësish e Papës të cilët për gati një dekadë emetonin monedhat e veta duke mos njohur ata të mbretit protestant, gjersa arriti ndëshkimi për shkeljet e tilla. Po ashtu falsifikimi i shenjave që shënoheshin produktet është tepër e lashtë e paraqitur qysh në periudhën e Egjiptit të lashtë Greqisë së Vjetër me imitimimin e enëve të vjetra. Periudha Asteke karakterizohet me shitjen e kokrrave të kakaos, ku shitësit e ndershëm grumbullonin kokrrat e kakaos dhe diferenconin ata në bazë të cilësisë, që kryesisht si faktor diferencimi ishte ngjyra e kokrrave, mirëpo ekzistonin shitës të pandershëm, manipulator të cilët merrnin kokrrat me cilësi shumë të ulët dhe si të tilla bënin ngjyrosjen e tyre me ngjyrë artificiale dhe shitnit ata si produkte të cilësisë së lartë. Periudha e shekullit XV ishte edhe si fillimi i Kinezëve që edhe ditëve të sodit janë një nga imituesit të origjinale, ku ata imitonin gati se të gjitha produktet nga Evropa. Ndoshta rastësi por edhe kërcënimi më i lartë i falsifikimit gati se të gjithë checkajë janë Kinezët që dominojnë në falsifikimin e produkteve elektronike, tekstile, ushqimore, lojërave për fëmijë, farmaceutike (në fushën e farmaceutike dominon me medikamente falco nga India, këta produkte paraqiten në treg si origjinale, me një kosto dhe cilësi shumë të ulët prodhimi që shkaktojnë humbje të mëdha të korporatave të mirënjohura si markat e mirënjohura në veshje, teknologji. Një fenomen gati se çdo vit në rritje si në ekonominë nacionale (posaçërisht vendet në zhvillim) por edhe në atë ndërkombëtare.

Ku problemi më i madhe qëndron në falsifikimin e produkteve ushqimore, lojërave të fëmijëve, dhe farmaceutike, ku tejkalohet aspekti ekonomik, pasi që është në pyetje jeta e njerëzve duke shkelur në vlerat morale, dhe njerëzore për të vetmin qëllim përfitimi financiar që nuk është edhe i ulët. Këta produkte janë shumë të rrezikshëm për konsumatorët, por mos harojm faktin se nëse ata produkte futen dhe oferta për produkte të tilla është vazhdimisht në rritje do të thotë se kërkesa është e madhe dhe çdoherë rritet. Në këtë rast vlen parimi kyç i ekonomisë mbi ekonominë e tregut të lirë ***kërkesa është faktor kyç që determinon ofertën*** pra nëse kërkesa është e lartë atëherë kemi më shumë punë për zinxhirin kontrabandës që përfshin nga prodhuesit ilegal, transportuesit, institucionet e kontrollit (dogana, inspektoratet që merren me kontrollim, forcat e rendit) shitësi dhe në fund kemi blerësin.

Po ashtu ndikim negativ kemi edhe tek bartësit e markave të mirënjohura, pasi që kemi shkelje të së drejtës së ekskluzivitetit, ku në qoftë se një prodhues shënon markën e bartësit pa ndonjë marrëveshje paraprake, apo kontratë të caktuar mbi shfrytëzim të markës atëherë ky veprim është ilegal dhe i dënueshëm nga e drejta pozitive e vendit, apo vendeve.

3.5.2. Kuptimi dhe definimi i falsifikimit.

Me falsifikim nënkuptojmë dukurinë e imitimit, të çfarëdo produkti që ka të shënuar markën tregtare të ndonjë bartësi pa leje (marrëveshje, kontratë, autorizim) të bartësit të markës në fjalë, duke prodhuar, dhe ofruar në treg sikur të jetë marka e caktuar, duke krijuar huti gjatë procesit të zgjedhjes nga konsumatorimesatar.

Falsifikimi i parave, letrave me vlerë, çeqeve është poashtu kategori e falsifikimit mirëpo kryesisht një tjetër temë e cila është e karakterit financiar ku është shumë më shumë e kontrolluar dhe nuk është aq e rrezikuar ekonomia e vendeve të Unionit Evropian, e ajo botërore, teknologjia ka efektet e saja pozitive por edhe ata negative janë të shumta. Sipas zyrës Europjane të pronësisë intelektuale (EUIPO-European Union Intellectual Property Organization) në një studim të kryer dhe të publikuar si në vazhdim

*Tregtia me mallra të falsifikuar dhe pirateria*⁹⁰ ku në raportin e tyre thuhet se mallrat e falsifikuar dhe kontrabanda e tyre përbën 2.5% të brutoprodhimit të SHBA-ve, gjendja është më alarmante sa i përket Unionit Evropian me 5% , ku theksohet se produktet e falsifikuara dhe piraterike kryesisht dominohen nga Kina, ku gati se për çdo lloj produkti që ofrohet në treg ekziston imitim, ashtu India dominon me falsifikimin në fushën farmaceutike, Egjipti në atë ushqimore dhe Turqia në fushën e aksesoreve dhe parfumerisë, ku kemi të bëjmë me një trend në rritje posaçërisht me tregjet online. Si rezultat i pamundësisë të kontrollimit nga Unioni Evropian edhe pse me çdokush insistohet të ndalohen këta mallra mirëpo me një bashkëpunim me vendet e origjinës të këtyre produkteve është e gati se një mision i pamundur për të zvogëluar përqindjen e këtyre produkteve në treg e lëre që të zhdukjes si fenomen, në tregjet e Unionit Evropian e atë Amerikan që janë nga më të prekurit. Posaçërisht edhe vendet në zhvillim të kontinentin Evropian dominohen nga produkte të tilla të cilat skan as kontroll cilësie, as prejardhja nuk dihet se nga vijnë, kush i prodhon, far kualiteti kanë.

Maqedonia është një ndër vendet të cilat lirisht mund të themi s'ka prioritet luftimin e fenomenit të tillë, kjo gjendje konstatohet nga një vërtetim i thjeshtë i tregut të vendit, edhe pse institucionet në bashkëpunim me Unionin Evropian tregohen se po bëjnë diçka mirëpo në fakt janë vetëm trillime vetëm e vetëm për të thithur ndonjë grand, donacion, projekt për luftim të fenomenit në fjalë. Këtë konstatim e bëjnë nga praktika si qytetarë i Republikës së Maqedonisë.

3.5.3. Ndikimi i falsifikimit të markave të produkteve në Ekonomin e vendit

Si një dukuri negative e shoqërisë, e ekonomisë e krijuar nga disa faktorë duke qenë pjesëmarrës edhe bartësit e markave tregtare falsifikimi ndikon në:

1. **Tatimet** si një burim kyç i financimit , funksionit të shtetit padyshim që janë tatimet, ku me pjesëmarrjen e produkteve me shenja të imituara padyshim që ka ndikim të madh në rrënjën e të ardhurave nga forma e tatimit të produkteve. Pasi që produktet e imituara në të shumtën e rasteve futen në tregjet e vendit në formë ilegale dhe nuk janë të

⁹⁰ OECD/EUIPO (2016), Trade in counterfeit and pirated goods: Mapping the economic impact, OECD Publishing, Paris (<http://dx.doi.org/10.1787/9789264252653-en>).

nënshtuar gjatë procesit të doganimit, tatimit të vlerës së shtuar dhe të gjitha format e tatimit që nënshtrohet një produkt i cili në mënyrë të rregullt futet në treg . Ku poashtu ndikon edhe në punësime, investime të huaja direkte. Porë duke mos harruar edhe prodhuesit ilegal të cilët padyshim kanë ndikim në rritjen e biznesit të produkteve të imituar , pasi që ofrojnë kushte dhe mënyra të prodhimit të tyre me kosto shumë më të ulët, me cilësi më të ulët. Kontrabanduesit janë të implikuarit direkt në fushën e furnizimit të tregut, dhe janë tepër të sofistikuar në vendet në zhvillim me normativ të së drejtës të brishtë, dhe me institucione të korruptuara që ndihmojnë, dhe janë pjesëmarrës në këtë dukuri negative. Por duke mos harruar edhe prodhuesit vendor të cilët prodhojnë produkte të tilla të imituar me një çmim tepër të ulët dhe cilësi siç thamë e pa krahasueshme me atë origjinalen.

2. **Korporatat bartësit e brendeve⁹¹ të mirënjohura** janë poashtu një nga faktorët që ndikojnë në rritjen e falsifikimit po të njëjtave produkte që ofrohen në treg. Siç dimë çdo biznes është krijuar për të maksimalizimin e fitimit në treg, nga ofrimi i produkteve dhe shërbimeve të caktuar, porë më mirë do të them është kthyer në bumerang për bartësit e të drejtave nga markat e mirënjohur, ku bartësit e tyre janë pikërisht këta kompani të mirënjohura ku vlera e tyre arinj miliona dollarë (kemi edhe me miliarda) vlera e tyre në treg. Ku me të vërtet çmimi shitës nuk formulohet nga parimet bazike ekonomike (lënda e parë + puna e njeriut + fitimi = çmimi shitës) pasi që kemi një rritje të fitimit të pa kontrolluar për produktet e tyre në treg, dhe kjo dukuri mundëson dhe ofron hapësirë në treg për futje dhe arritje të suksesit të produkteve të imituara. Pasi që këta kompani gjigantë global të prodhimtarisë në fusha të ndryshme nuk kanë kontrollime nga organizata për mbrojtje të klientëve, konsumatorëve. Si shembull kemi produktet e teknologjisë komunikative ku në treg vlera e markës është më e shtrenjtë dyfishi i harxhimeve për prodhim të produktit , ku si shembull kemi telefonin e mençur të Apple (iphone) i gjeneratës së fundit ku sipas ekspertëve që merren me çështjen e mbrojtjes së konsumatorëve, dhe çmimit të prodhimit, shpërndarjes me një fjalë e gjithë kostoja e ofrimit të produktit tek konsumatori nuk kalon vlerën 200\$, mirëpo në treg ofrohet me një çmim minimum 700\$ nga fakti në fjalë konstatojmë e pagesa vetëm pse është markë e mirënjohur brendi në fushën e caktuar paguhet një shumë marramendëse prej 500\$ e pa përballueshme nga shumica e klientëve të vendeve në zhvillim dhe që ofron mundësi hapësirë në

⁹¹ Brendi (*brand*)- nënkuptojm një markë tregtare e cila ka aritur të jetë e mirënjohur dhe gëzon reputacionin më të lartë në tregjet e vendeve, rajonale, global.

treg për mjeshtëritë të imitimit Kinezët që të ofrojnë produkt të tillë kuptohet me cilësi shumë të dobët por me pamje dhe formë gati 99% të produktit origjinal me një çmim shitës prej maximum prej 100\$.

3. **Globalizimi** poashtu ndikon aq tepër në krijimin e hapësirës në treg për produktet e tilla, kuptohet që vlerat e globalizimit, komunikimit janë të pakrahasueshme për të mirat që ofrojnë njerëzimit në botë,por ndikon edhe në krijimin e kushteve dhe mundësive për plasim të produkteve të tilla.

Në fund mund të konstatojmë se pa një bashkëpunim të mirfillt i të gjithë pjesëmarrësve në procesin në fjalë është e pamundur kontrollimi i dukurisë në fjalë duke analizuar poashtu edhe arsyet që çojnë në një dukuri negative të ekonomisë dhe shoqërisë. Të kthehemi tek problematika në vendin tonë gjë që është gati e njëjtë si në Shqipëri, Kosovë, pasi që çdoditë përballemi me problematikën e tillë në jetën tonë. Situata është alarmante në Maqedoni sa i përket çështjes së falsifikimit, pasi që siç thamë tregu është i stërmbytur me produkte të imituara, posaçërisht në industrinë e tekstilit, parfumerisë, lojërave për fëmijë dhe industrisë ushqimore, një faktë është për tu habitur se institucionet e vendit nuk ndërmarrin asnjë hap të vetëm për mbrojtjen e markave të njohura .

Po ashtu ndikim kanë edhe faktorët social ku gjatë punimit do të shqyrtojmë në tërësi çështjen e faktorëve social në mbrojtje të Pronësisë industriale në tërësi. Një ndër arsyet kyçe dhe motivon kontrabanduesit e produkteve të imituar është kërkesa në treg për produkte të tilla, mosangazhimi serioz i institucioneve shtetërore, korrupsioni po ashtu ka ndikim të lartë pasi që në një vend si Maqedonia, kemi korrupsion në çdo institucion duke filluar nga gjykatat e deri tek organet e rendit dhe sigurisë, fakt që në një shoqëri të tillë është shumë lehtë të iket nga detyrimi dhe ndëshkimi për veprat e caktuara konkretisht ofrimi i produkteve të tilla në treg . Koncepti i markës tregtare është diferencimi i produkteve gjatë procesit të shitjes ku me markë shënohet produkti i bartësit të së drejtës dhe lehtëson procesin e blerjes duke mos shkaktuar huti gjatë procesit të blerjes së produktit të shënuar me markën tregtare. Nëse shtrohet pyetja sa produkte kemi që krijojnë huti gjatë procesit të blerjes, sa konsumator mashtrohen gjatë procesit të blerjes duke blerë produkte të imituar e paguar si me qenë ai origjinali? Përgjigja Shumë, në plotkuptimin e fjalës shumë, çdo produkt që ofrohet në tregun tonë ka edhe zavendsuesin e tij me atë të imituar.

Kemi 2 lloje të zgjedhjeve të produkteve të imituar në sa i përket vendit tonë edhe atë:

1 .**Zgjedhja e produkteve të imituar**(falco të markave tregtare) **me vetëdijen e konsumatorëve (blerësve)** në këtë rast kemi të bëjmë me zgjedhjen e produkteve falco me vetëdije të konsumatorëve ,ku është i vetëdijshëm se produkti në fjalë nuk është i markës së shënuar në produkt por kemi të bëjmë me produkt falco, ku në këtë rast çmimi i tyre është shumë më i ulët si ai origjinali, dhe blerësi paraprakisht njofton blerësin e mundshëm se produkti në fjalë është falco mirëpo duke treguar karakteristikat e tij dhe shpesh herë duke informuar se kemi të bëjmë me produktin gati se të njëjt ,cilësi të njëjt, vetëm se e çmimi është i volitshëm vetëm e vetëm se është imitim i origjinalit, dhe nuk dallon aspak nga ai origjinali. Ky fenomen është i pranishëm kryesisht në ofrimin e produkteve të veshjeve, aksesoreve të ndryshëm, dhe njëkohësisht një nga fushat ku kemi të bëjmë me numrin më të lartë të produkteve të tilla. Si një nga bizneset më fitimprurëse në industrinë tekstile të vendit, fenomeni i tillë është prezent dhe produktet e tilla shiten kryesisht në ndërmarrjet e tregtare individual (subjekte të vogla) por të regjistruar si të tilla por puna e tyre as që vërehet nga organet kompetente ,në fakt vërehet por nuk ndërmerret asnjë hap për parandalimin e veprimit të tillë. Fig1⁹²



⁹² Marur sa për ilustrim nga webfaqja

(https://www.google.com/search?q=nike+air+max+original+and+fake&rlz=1C1CHBD_enMK746MK746&source=Inms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjJhPzW3L7UAhVI1hQKHUPjDS8Q_AUICigB&biw=1356&bih=600#imgrc=5hS8vKQAXqahDM:)

2.Zgjedhja e produkteve të imituara pa vetdijen e konsumatorëve (mashtrimi i blerësve).

Poashtu një nga format e ofrimit të produkteve të imituar por në këtë rast kemi të bëjmë me ofrimin e produkteve të imituar por pa informuar blerësin potencial se bëhet fjalë për produkte të tilla, ky fenomen është i pranishëm në vendin tonë posaçërisht në procesin e shitjes së pjesëve të këmbimit për automobilistike, makineri të ndryshme, produkte teknologjike dhe një nga problematikat kyçe ku organet shtetërore që merren me mbrojtjen e pronësisë industriale, mbrojtjen e konsumatorëve duhet të veprojnë, por prapë si blerës potencial jemi në vesh të shurdhur nga organet në fjalë. Në këtë rast kemi të bëjmë me mashtrim të blerësve potencial pasi që produkti shitet si me qenë origjinali, a në fakt është i imituar dhe përbën rrezik të dyfishtë pasi që është në pyetje edhe funksioni që ushtron produkti në fjalë,sa i përket sigurisë së qytetarëve. Poashtu edhe ofrimi i produkteve të tilla është i lartë në tregun e vendit tonë, këtu bëjnë pjesë edhe produktet ushqimore që ofrohen, në treg dhe produktet higjienike ,ku kemi mungesë të deklaracionit sa i përket origjinës së produktit, kushtet e prodhimit etj. Në këtë kategori tangon edhe produktet ushqimore ku bie ndesh me parimin e markës tregtare se produkti duhet të mos jetë i ngjashëm dhe të mos krijoj huti gjatë procesit të blerjes të konsumatorit mesatar , kryesisht në këtë rast problemi qëndron tek mos informimi i bartësve të së drejtës për praninë e produkteve të tilla në treg, duke dëmtuar bartësin e të drejtës dhe njëkohësisht konsumatorin e këtyre produkteve fig2⁹³

⁹³ Raste personal në një nga supermarketet e vendit tonë,që sipas mendimit tim krijon huti gjatë procesit të zgjedhjes së produktit të kërkuar në treg.Një nga shembujt të cilët nuk janë të paktë në vendin tonë.



3. Falsifikimi i deklaracionit për produktin nuk është kategori sa i përket imitimit të markës tregtare të regjistruar por në fakte tepër problematike sa i përket çështjes së sigurisë, shëndetit të qytetarëve, ndryshe do të kisha quajtur një mashtrim ndaj blerësve potencial. Kryesisht paraqitet tek produktet higjienike, kozmetike, e në formë shumë të shpeshtë produktet ushqimore. Ku kemi të bëjmë me falsifikimin e datës së prodhimit, dhe vendit të origjinës së produktit, afatin e përdorimit. Tregu i ekonomisë së lirë mundëson që thyerjen e parimit të lartpërmendur se kërkesa e determinon ofertën, nëse kemi ofertë të lartë në treg, ndërsa kërkesa për produkte të tilla ngelet e njëjtë atëherë kemi paraqitjen e rezervave të tepruara për produkte të tilla, paraqitja e rezervave të tilla rrezikon shitjen e produkteve në fjalë kryesisht në industrinë ushqimore, dhe higjienike, ky fenomen detyron manipulatorët që bëjnë çmos për të arritur që të shesin produktet e tilla ndërmarrin hapa nga më të ndryshmit vetëm e vetëm që të arrijnë përfitimet duke shkelur edhe parimet njerëzore. Në këtë rast kemi të bëjmë me ofrimin e produkteve të tilla me ndryshim të afatit të përdorimit, duke fshirë atë, apo duke modifikuar atë dhe në fakt duke dyfishuar veprën kriminale, e gjitha kjo në vetëdije, dhe mirë e informuar institucionet kompetente, duke mos vepruar si mos me ndodhur asgjë.

Si konkluzion mund të nxjerrim se procesi i falsifikimit të markave tregtare është një dukuri që ndryshe do të quaja një kriminalitet ekonomik, i cili ditëve të sodit është një dukuri e përditshme në vendet në zhvillim që nuk kanë prioritet luftim e saj, dhe si e tillë ku humbës dalën të gjithë përveç kontrabanduesve që ofrojnë këta produkte në treg, duke shfrytëzuar mangësitë në sistemin e së drejtës së vendeve të tilla, poashtu korupcioni luan një rol tepër të rëndësishëm mbrojtës për këta persona. Ku institucionet nuk veprojnë në bazë të sistemit të së drejtës kurë është fjala përfitime të pa baza (korruptive), ndërsa në anën tjetër pretendojnë se janë duke bërë maksimumin për luftimin e kriminalitetit të tillë në sy të Unionit Evropian, në fakt duke menduar se mashtrojnë ata, e në fakt humbës dalin na në pik të parë si qytetarë, duke rrezikuar shëndetin në pikë të parë, pasurinë, sigurinë.

Çështja e falsifikimit të markave tregtare është një dukuri që mendoj se do të vazhdoj të rritet gjersa nuk ndërmarrim masa për parandalimi duke u nisur nga qytetari i thjeshtë, institucionet shtetërore me shtim të kontrolleve, dhe ndoshta me ndryshime në legjislacion sa i përket masave të dënimeve që mendoj se duhet të jenë më të rrepta, dhe me eliminim të korrupsionit. *Korrupsioni është dukuria më negative në një shoqëri ku nuk përfiton shoqëria, qytetarët, por në fakt pasurimi i pa bazë i personave (juridik, fizik) manipulatorët* fenomen që është shumë prezent në vendet në zhvillim duke mos anashkaluar edhe vendin tonë.

KAPITULLI I KATËRT

Dizajni industrial, emri gjeografik si dhe mbrojtja ligjore e të drejtave nga pronësia industriale në vendin tonë


4.1 Kuptimi dhe historiku i Dizajnit industrial

Dizajni industrial ka një rol tepër të rëndësishëm në fushën e tregtisë të mallrave dhe në konsumin e gjërë të produktve pasi që është në vijë të parë në ballafaqim me konsumatorin potencial. Dizajni industrial është pikrisht forma, shenja, vija e cila e bën produktin atraktiv, dhe tërheqës njëkohësisht duke shtuar vlerën e tij në treg dhe rritjen e kërkesës për produktin e tillë. Periudha që jemi dëshmitar të bumit të madh të rëndësisë së dizajnit gati se në çdo lloj produkti që ofrohet në treg dhe dizajni është pjesë e integruar e produktit dhe tepër e rëndësishme, gjatë zgjedhjes së produkteve, ku rivaliteti në mes ofruesve të produktve të tilla është tepër i lartë, duke joshur dhe tërhequr konsumatorët, me forma të lloj llojshme të dizajnit. Rregjistrimi i dizajnit si e drejtë ekskluzive e bartësit apo shfrytëzuesit të dizajnit me autorizim leje kontratë, marrëveshje nga persona të tjerë, mundëson një dallueshmëri të produktve me dizajn të rregjistruar, një reputacion në treg, dhe njëkohësisht promovohet konkurrenca e ndershme, nuk krijohet huti tek konsumatori mesatar. Poasht edhe si qëllim kyç është shërbimi si model, për prodhimin e produkteve të industrisë dhe zejtarisë. Dizajni siç thamë ka ndikim të madh në zgjedhjen e konsumatorve për produktet të shënuara me dizajn të dallueshëm, dizajn me domethënje për produktin që shënohet, kemi lloj lloj kombinimesh që dizajni është një fushë e veçantë e kreatorëve, dizajnatorëve të cilët janë vazhdimisht të angazhuar në këtë fushë. Poashtërisht korporatat e mëdha e markave të mirnjohura kanë ekipe, time të caktuar që meren vetëm me çështjen e dizajnit.

Si krijim estetik e artistik përcakton pamjen e produktit, si forma, modele, dekorime, shënime në to, që nuk ndikohen nga konsiderata funksionale e produkteve. Një dizajni për tu quajtur industrial, duhet që të jetë e përdorueshme për një seri produktesh dhe i riprodhueshëm industrialisht. Si objekt mbrojtje të dizajnit nuk janë produktet porë krijimi estetik, si dizajnoja e zbatuar apo e shënuar në produkte. Për dallim nga format tjera të pronësisë industriale si (patenta, marka tregtare) dizajnoja gëzon mbrojtje në afat maksimal prej 5 viteve me mundësi vazhdimi nga 5 deri në 25 vite maksimum. Me dizajno

mund të shënohet çdo tipar që ka të bëjë me pamjen e një produkti që nuk ka të bëjë me funksionimin apo përshtatet me produktin tjetër me një produkt më të madh.

Dizajni industrial është më se i përshtatshëm në raste se kurë kemi të bëjmë me formën që është një pikë e fortë e identifikimit të tij, ku aspekti vizuel luan një rol tepër të rëndësishëm, posaqërisht tek produktet si orët, bizhuterit e ndryshme, pajisje kuzhinjerie, lodra, ndriçues, telefona, instrumente muzikore, industria automobilistike. Dizajni industrial është punë kreative e individëve (dizenjatorëve) apo grup individësh që vepra e tyre është një art pamvarsisht se gjenë përdorim në industri, dhe duke nisur nga ky fakt mund të themi se dizajni industrial është objekt i së drejtës së pronësisë industriale dhe të drejtave të autorit. Një miks i vërtet që do të thotë mbrohet nga pronësia industriale, pasi që gjen zbatim në fusha të ndryshme të industrisë, dhe është pjesë e së drejtës së autorit, sepse autori i dizajnit industrial është ai person që ka krijuar këtë vepër artistike dhe një përparsi tjetër është se të drejtat e autorit kanë një mbrojtje shumë më të gjatë se tek pronësia industriale.



Një faktë i rëndësishëm është se në legjislacionin Amerikan dizajni industrial është pjesë e inkuorporuar e patentave dhe mbrohet si Patentë, domethënë nuk ka grupim të veçantë si dizajn industrial dhe gëzon të drejtat si Patentë.

Në legjislacionet kombëtare egzistojnë 3 forma të mbrojtjes të dizajnit industrial edhe atë :

Sistemi i mbrojtjes së dyfishtë ku mundësohet mbrojtja e dizajnit industrial nga e drejta e pronësisë industriale dhe nga e drejta e autorit. Sistemi i tillë i mbrojtjes

funksionon në mënyrë që parashtruesit të aplikacionit që të zgjedh mënyrën e mbrojtjes nëse dizajnin do të mbroj me të drejtën e pronësis industriale po me atë të drejtave të autorit, egziston edhe mundësia që parashtruesi i aplikacionit të zgjedh të mbroj dizajnin në mënyrë të dyfisht edhe me të drejtën e pronësis industriale dhe atë të drejtave të autorit porë duhet të dimë faktin se nëse aplikohet sistemi i dyfisht atëher kemi të bëjmë me kritere më rrigoroze.

Sistemi i till funksionon kryesisht në vendet e Beneluxit (Belgjikë, Holandë, Luksemburg) poashtu dhe në Gjermani.

Sistemi italian i mbrojtjes së dizajnit industrial ku sipas sistemit në fjalë mbrojtja mundësohet nga e drejta e pronësis industriale, apo ajo e të drejtave të autorit dhe nuk mundësohet mbrojtja e dyfisht, parashtruesi i kërkesës për njohje të dizajnit industrial duhet paraprakisht të zgjedh se cilin sistem të mbrojtjen do të aplikoj. Kryesisht sistemi i till funksionon në Itali.

Sistemi Frances i mbrojtjes së dizajnit industrial, mundëson mbrojtje të till që parashtruesi i së kërkesës për mbrojtje paraprakisht zgjedh formën e sistemit të mbrojtjes dhe nëse zgjedh atë të mbrojtjes nën suaza të së drejtës të pronësis industriale, dhe njëkohësisht ka të inkorporuar atë të drejtave të autorit, dhe anasjelltas nëse zgjedh atë të drejtave të autorit ka të inkorporuar edhe të drejtat nga pronësia industriale.

Dizajni është ai që është në kontakt të parë me blerësin dhe dizajni është një nga faktorët kyçë për shitje të produktit. Parimi që është i vlefshëm ditëve të sodit dhe tepër i suksesëshëm sa i përket përfitimeve padyshim duke rritur interesin e kompanive në treg me dizenjot e tyre duke patur komplet ekipe profesioniste për të dizejnuar forma të reja vizatimesh, të zbatueshëm tek produktet industriale që do të ndikoj në shitjen e produkteve të tyre. Një nga kushtet që ndikon gjat procesit të blerjes të produkteve padyshim është pamja vizuale , kontakti i parë i blerësit me produktin, bëhet pikrisht me dizenjon e tij që nënkupton tërheqja e blerësve me format, shkrimet, vijat kë është si prioritet i plasimit të produktit në treg. Duke nisur nga rëndësia dhe fakti se dizajni industrial, është kyç për shitjen tërheqjen e konsumatorve me format e dizajnit duke përfshirë formën 2D, dhe 3D, dekorimet, shënimet që u bëhen produkteve për të knaqur nevojat e blerësve, dhe njëkohësisht maximilizimin e fitimit të kompanive , ata janë çdoher në kërkim të dizejnerve kreativ me ide gjeniale, të sjellin risit të mundëshme për të bërë produktin e tyre atraktiv dhe tërheqës për blerësit.

4.2. Procesi i rregjistrimit të dizajnit industrial

Dizajni industrial duhet të jetë i ri dhe njëkohësisht të ketë karakter individual si në pamjen e jashtme të tij që nënkupton pamjen e jashtme të produktit në tërësi apo vetëm të një pjese të tij, ku janë të veçuara linjat, tiparet, ngjyrat, forma 2D dhe 3D(formady dimensionale dhe tre dimensionale), që përbëhet dhe rendohet produkti që dizajni nuk ka të bëjmë funksionit të produktit. Dizajni i tillë që të gëzoj përparmit dhe i mbrojtur ndaj të tjerët si çdo element i pronësisë industriale duhet që të regjistrohet, ku procesi i regjistrimit parasheh kushtet, dhe dokumentacionet e nevojshme që duhet të disponoj autori i dizajnit⁹⁴ dhe informacionet paraprake.

Procesi i njohjes të së drejtës nga regjistrimi i dizajnit industrial(në vazhdim dizajn i regjistruar) duhet të nënshtrohet një sërë kontrollesh varësisht nga vendi ku aplikohet njohja e së drejtës së dizajnit të regjistruar. Ku kemi dy lloje sistemesh gjatë procesit të nënshtimit të kontrolleve për të njohur të drejtën në fjalë.

- Sistemi i së drejtës ku kemi kontroll të plotë duke analizuar të gjitha pengesat e mundshme si ata absolute dhe ata relative për njohjen e së drejtës së dizajnit të regjistruar si dhe procesi i kërkimit në bazat e të dhënave ndërkombëtare nga Enti ku aplikohet për regjistrim të dizajnit .
- Sistemi i së drejtës ku kontrollohet vetëm për dizajnin që paraqitet në fletëparaqitjen për regjistrim duke analizuar vetëm kushtet relative për refuzim të dizajnit industrial, ku kërkohet vetëm për pengesat në hapësirën territoriale si dhe bazën e të dhënave të vendit ku aplikohet (sistemi i tillë funksion në Gjermani).

Maqedonia gjatë procesit të regjistrimit të dizajnit industrial zbaton sistemin e parë e së drejtës në fushën e regjistrimit të dizajnit industrial në përputhshmëri me Ligjin për pronësi industriale⁹⁵ dhe rregulloren⁹⁶ për regjistrim të dizajnit industrial nga Enti shtetërorë për pronësi industriale në Maqedonisë. Ku procesi i regjistrimit të dizajnit industrial në Maqedoni realizohet me procedurë të veçantë administrative. Po ashtu ligji i lartpërmendur parasheh mundësin e

⁹⁴ Me Autor të dizajnit nënkuptojmë personin fizik i cili ka krijuar dizajnin, me punën e tij krijuese (Ligji për pronësi industriale Neni 135 paragrafi 1.)

⁹⁵ Gazeta zyrtare e RM-së nr21/2009, 24/2011, 12/2014, 41/2014, 152/2015 dhe 53/2016.

⁹⁶ <http://www.ippo.gov.mk/MK/LegislativaView.aspx?lang=MK&id=131&cat=NAT>

dizajnit industrial sipas Marrëveshjes së Hagës mbi dizajnin industrial ⁹⁷ edhe atë drejtpërdrejtë pranë Organizatës Botërore për Pronësi Industriale (WIPO).

Mundësia e njohjes të drejtës në fushën e dizajnit industrial realizoi në 3 fusha edhe atë

1.Kemi njohjen e dizajnit industrial pranë Enteve shtetërore të vendeve individual.

2.Kemi njohjen e dizajnit industrial në aspektin ndërkombëtar ku mundësohet njohja e të drejtës së dizajnit të regjistruar pranë WIPO-së, dhe njohja e tillë vlen për vendet që janë nënshkrues të Marrëveshjes së Hagës për dizajnin industrial.

3.Kemi njohjen e dizajnit industrial rajonal (si shembull njohja e dizajnit industrial pranë Zyrës Evropiane për Pronësi industriale dhe njihet ndryshe si dizajni i komunitetit.

4.3. Procesi i regjistrimit të dizajnit industrial pranë Entit shtetërorë për pronësi industriale të Maqedonisë (ESHPI).

Dizajni industrial që të jetë i regjistrueshëm dhe të gëzon statusin e dizajnit të regjistruar duhet të plotësoj disa kriteret themelore si dizajni duhet të jetë **i ri**, që nënkupton se formë e tillë e dizajnit nuk ka qenë në qarkullim publik më herët, dhe duhet të jetë i karakterit individual që do të thotë se nuk ngjason me dizajn të regjistruar paraprakisht më herët. Poashtu edhe ndikimi i dizajnit nga funksionaliteti teknik i produktit, është një parakusht që të mund të regjistrohet. Duke pasur parasysh parakushtet e lartshënuara autori apo pasardhësi juridik⁹⁸, porositi (nëse dizajni është bërë në bazë të kontratës), punëdhënësi (nëse autori është në kryerje të obligimeve të punës në bazë të kontratës të punës në mes punëdhënësit dhe autorit të dizajnit si autor i dizajnit).

Po ashtu në Ligjin për Pronësi industriale të Maqedonisë (në vazhdim LPIM) parashihen edhe shkaqet për refuzim të kërkesës për regjistrim të dizajnit industrial edhe atë kemi **Shkaqet absolute për refuzim** (neni 132,LPIM) ku me dizajn industrial nuk mund të mbrohen:

⁹⁷ Gazeta zyrtare e RM-së nr.33/05.

⁹⁸ **Pasardhësi juridik** i autorit është personi juridik apo fizik arrtija e së drejtës së dizajnit industrial të të cilit bazohet në ligj, punë juridike, trashëgimi apo aktvendim gjyqësor(Ligji për pronësi industriale Maqedoni neni 136.)

- nuk është në pajtim me nenin 127pika 2 ⁹⁹.
- është në kundërshtim me rendin publik dhe moralin
- paraqet plan dhe skicë teknike
- paraqet vepër ekskluzive hartografike ose fotografike,
- përmban stema shtetërore,ose stema të tjera publike, flamuj, emblema, shkurtesa të emrave të shteteve, ose organizatave përkatëse. Me leje të veçantë nga organet kompetente (Ministria e drejtësisë.)
- përmban ose imiton personalitete ose emër personave të njohur, të vdekur, historik të Maqedonisë, përveç lejes së veçantë nga organet kompetente (Ministria e drejtësisë).
- përmban dhe imiton emër, formë, ose pjesë njohëse të trashigimis kulturore të mbrojtur të Maqedonisë, përveç me leje të veçantë (Drejtoria për mbrojtje të trashigimis kulturore).

Shkaqet relative për refuzim (neni 133, LPIM) ku me dizajn industrial nuk mund të mbrohen :

- dizajni i cili nuk është i ri sipas nenit 128LPIM¹⁰⁰
- nuk ka karakter individual
- i cili mund të mbrohet në pajtim me nenin 131 të LPIM¹⁰¹ , ku nga shkaqet relative për përjashtim i fletëparaqitjes së parashtruar mund të thirret vetëm parashtruesi i fletëparaqitjes së parashtruar më parë e regjistruar do të jetë arsyetim i vetëm për refuzim.

Parashtruesi i fletëparaqitjes për regjistrim të dizajnit industrial pas analizimit të arsyeve dhe shkaqeve që mund të çojnë për refuzim të regjistrimit të dizajnit poashtu nëse gëzon të drejtë të përparësisë për dizajnin që inicion procedurë për regjistrim atëherë mund të përdor njërin nga të drejtat e përparësis ndaj çdo personi tjetër edhe si e drejta e përparësis së panairit ku nëse ka të ekspozuar dizajnin në panairë në Maqedoni, apo në ndonjë vend anëtar të OBT-së(Organizata Botërore e Tregtisë), apo Unionit ka mundësi të shfrytëzoj

⁹⁹ Dizajni që është i ri dhe ka karakter individual ku pamja e jashtme e produktit në tërësi se e pjesës së tij, e cila është përcaktuar nga veçoritë e tij, veçanërisht linjat, tiparet, konturat, ngjyrat, format, teksturat, dhe materialet nga të cilat përbëhet ose zbukurohet produkti si dhe ornamentet neni 127 paragrafi 1, 2.

¹⁰⁰ Dizajni llogaritet si ri , nëse dizajni identik nuk ka qenë i kapshëm në opinionin publik para datës së parashtrimit të fletëparaqitjes për njohje të atij dizajni , ose nëse është kërkuar e drejta e përparësis para datës së përparësis së kërkuar, ose nëse ekziston fletëparaqitje e parashtruar më herët për njohje të dizajnit identik duke dalluar edhe pjesët e parëndësishme (neni 128 paragrafi 1, 2.).

¹⁰¹ Me dizajn industrial nuk mbrohet dizajni i cili përcaktohet nga funksionet teknike të prodhimit, i cili duhet të jetë i riprodhuar në formën dhe dimensionet e sakta të tij, që të mundet prodhimi në të cilin përmbahet ose në të cilin zbatohet dizajni, të jetë i lidhur mekanikisht me prodhimin tjetër, që të mundën të dy prodhimet të kryejnë funksionin e tyre(neni 131, p.1).

këtë të drejtë në afat prej 3muaj, ku njëkohësisht të vërtetoj me dokumentacion se eka ekspozuar dizajnin në fjalë .Poashtu njihet edhe e drejta e Unionit që është e njëjtë si tek Patentat , pra nëse ka të regjistruar paraprakisht dizajnin në ndonjë vend të Unionit të Parisit apo OBT-së, dhe forma tjetër e të drejtës së përparsis është e shumëfishtë , ku vërteton se dizajni që kërkon njohje në Maqedoni paraprakisht është regjistruar në disa vende.

Nëse Enti konstaton se autorit të dizajnit i njihet e drejta e përparsis atë e shënon dhe njëkohësisht i jep certifikatë për njohje të drejtës së përparsis dhe si datë e aplikimit për regjistrim të dizajnit meret data nga vërtetimi që deponon pranë Entit parashtruesi .

Fletëparaqitja për regjistrim të dizajnit industrial përmban kërkesën për njohje e të drejtës për dizajnin industrial, të dhëna për parashtruesin, si dhe shtojca të cilat shoqërojnë kërkesën për njohje të drejtës. Në figuren në vazhdim forma dhe përmbajtja e fletëparaqitjes nga Enti për pronësi industriale Maqedoni

ПРИЈАВА НА ИНДУСТРИСКИ ДИЗАЈН
БАРАЊЕ ЗА ПРИЗНАВАЊЕ НА ПРАВОТО НА ИНДУСТРИСКИ ДИЗАЈН
 Државен завод за индустриски сопственост
 (да се пополни со машина за пишување или електронски)

Прилог 1

1. Адреса за кореспонденција адреса на подносителот на пријавата, законскиот претставник или застапник		Телефон
		Факс
		e-mail
2. Пријавата се поднесuva за		
☐ Еден дизајн		
☐ Повеќе дизајни		
3. Подносител на пријавата Презиме, име и адреса за физичко лице, односно фирма и седиште за правно лице		
☐ Постојат повеќе подносиители		
☐ Изјава за законски претставник		
4. Застапник: Презиме, име или назив, адреса: Регистарски број:		
5. Автор (презиме и адреса)		
☐ подносител е автор ☐ авторот не сака да биде познат во пријавата ☐ постојат повеќе автори		
6. Назив на индустрискиот дизајн:		
7. Општување на видот на дизајнот: ☐ дводимензионален ☐ тродимензионален		
8. Пријавата се поднесuva за:		
☐ изумет број на индустриски дизајн ☐ припокан мостра ☐ разделена пријава		
☐ одложување на објавувањето ☐ објавување во боја		
9. Побарано право на првенство и основот:		
☐ савесно првенство (име на изложбата или сесмоте и датум на првото изложување на дизајнот)		
☐ уметничко првенство (датум, држава и број на првата пријава)		

Об.ДЗИС ИД-1

10. Прилози	
☐ З пример. фотофраф (графички прикази), кои имаат _____ стр.	податоци за други автори податоци за други подносител на пријавата
☐ З пример на приложен опис, кој има _____ страни	пријавата претходно е поднесена во електронска форма
☐ доказ за платена такса	поднесено _____ дополнителни страници за точка _____ (по потреба)
☐ полномошно на застапникот	
☐ изјава за заеднички претставник	
☐ доказ за правото на првенство	

Потпис или печат на подносителот
Односно потпис или печат на застапникот

Потпис и печат на Државниот завод за индустриска сопственост

ПРИКАЗИ НА ИНДУСТРИСКИОТ ДИЗАЈН

Pas deponimit të fletëparaqitjes pranë entit kemi të bëjmë me shqyrtimin formal të fletëparaqitjes, ku kontrollohen se përmban të gjitha pjesët, shtojcat, dhe nëse është parashtruar në gjuhën Maqedone, nëse kemi parashtrim të dokumentacionit në gjuhë të huaj kontrollohet a është e përkthyer, dhe njëkohësisht kontrollim i pagesës së taksës, gjatë shqyrtimit formal nëse vërehen mangësi gjatë kontrollit, Enti informon parashtruesin që në afat prej maximum 60ditë të mënjanoj atë. Më pas Enti shqyrton kushtet për njohjen e së drejtës njëkohësisht bie aktvendim :

1.Aktvendim për njohjen e së drejtës është pranuar dhe obligohet që në afat më së voni prej 30 ditëve të kryej obligimin, që të shpall fletëparaqitjen në afat më së voni 90 ditë.

2.Aktvendim për refuzim të së drejtës ku poashtu Enti njofton me shkrim parashtruesin e fletëparaqitjes në lidhje me refuzimin si dhe arsyetimet që çoj deri tek refuzimi dhe mundësi që parashtruesi të arsyetoj atë në afat maksimal prej 6muajve. Po ashtu parashtruesi i fletëparaqitjes ka të drejtë që të kërkoj pranë organeve të Entit prolongim të shpalljes së fletëparaqitjes të dizajnit industrial, duke arsyetuar një hap të tillë. Nëse konstatohet nga organet kompetente të Entit se procedura rrjedh si duhet ata shpallin fletëparaqitjen ku mundësohet paraqitje të kundërshtimeve në lidhje me shpalljen në afat prej 90 ditëve, ku kundërshtim mund të parashtroj cili do person që mendon se me shpalljen e dizajnit të regjistruar cenohet e drejta si nga fusha e pronësisë industriale, dhe cili do person që konstaton se dizajni në fjalë nuk përmban kriteret sipas ligjit për pronësi industriale të Maqedonis. Nëse eventualisht në afat prej 90ditëve paraqitet kundërshtim Enti merë në shqyrtim kundërshtimin në lidhje me shpalljen e fletëparaqitjes dhe njëkohësisht shqyrton, kontakton parashtruesin e kundërshtimit që të arsyetoj kundërshtimet e tija dhe bie aktvendim për refuzim të kundërshtim ose pranim të kundërshtim dhe rrëzim të fletëparaqitjes për regjistrim, duke njoftuar me shkrim si parashtruesin e kundërshtim poashtu edhe parashtruesin e fletëparaqitjes për regjistrim të dizajni. Me sjelljen e vendimit për pranim të regjistrimit të dizajnit njoftohet parashtruesi që në afat prej 1 muaj të nga data e pranimi të vendimit, të shlyej të gjitha detyrimet pagesore si dhe pagesën e taksës për 5 vitet e ardhshme sa vlen edhe dizajni i regjistruar. Ku më pas të dhënat e dizajnit industrial të regjistruar shpallen nga Enti më së voni 90 ditë nga data e regjistrimit në Gazetën dy mujorëshe të Entit, më pas Enti në afat prej 6

muajve duhet që bartësit të së drejtës së dizajnit të regjistruar ti dorëzoj vërtetim se dizajni është i regjistruar.


Të drejtat morale të autorit të dizajnit (neni 164 i LPIM) ku parasheh se autori pamarpasqysh se a është parashtrues i fletëparaqitjes ose bartës i së drejtës, çdoherë ka të drejtë të shënohet si autor i apo të gjithë autorët të cilët kanë marë pjesë në krijimin e dizajnit industrial në gjitha dokumentet dhe shpalljet publike, ku e drejta e autorit është e pambarueshme. Bartësi i dizajnit të regjistruar ka të drejtë ekskluzive që të shfrytëzoj dizajnin industrial, dhe të ndaloj personat e tretë që të shfrytëzojnë dizajnin pa pajtimin e tij, ku të drejtat ekskluzive nuk vlejnë nëse dizajni i regjistruar shfrytëzohet për qëllime private, ekonomike, informim të opinionit për qëllime arsimore, qëllime eksperimentale shkencore. Vlefshmëria e dizajnit industrial në Republikën e Maqedonisë është 5 vite nga data e parashtrimit të fletëparaqitjes për regjistrim, me një mundësi vazhdimi të afatit nga 5 vite maksimum 25 vite.

Në Gazetën 2 mujorëshe ja si duket një shpallje për dizajnin industrial të regjistruar si në figurën në vazhdim .

(11) **781** (45) 30/04/2017
(21) ID 2016/1 (22) 25/01/2016
(18) 25/01/2021
(72) Stipe Brcic (Jadranska 15, 10000 Zagreb) and Ana Baletic (Stipanciceva 11, 1000 Zagreb)
(73) **INA - industrija nafte d.d.,**
Avenija Veceslava Holjevcia 10, 10000 Zagreb, HR
(74) БЕРИН Д.О.О Скопје ул.
(51) 09-03
(54) Контејнери (Садови за течност)



Слика 1.1



4.3.1. Procesi i regjistrimit të dizajnit industrial sipas marrëveshjes së Hagës mbi dizajnin industrial

Është i mundur regjistrimi i dizajnit industrial pranë WIPO-së ku bartësi i të drejtës paraprahe të dizajnit industrial në vend aplikon për njohje të së drejtës edhe pranë WIPO-së. Sipas marrëveshjes së Hagës sistemi i regjistrimit ndërkombëtar të dizajnit industrial pothuajse është i njëjtë si tek regjistrimi ndërkombëtar i patentës apo markës tregtare, ku parashtruesi i kërkesës për njohje të dizajnit industrial plotëson formularin i cili është i unifikuar sipas marrëveshjes dhe aplikohet për njohje ndërkombëtare, nëse dizajni industrial është i pranueshëm për rregjistrim nga organet e WIPO së si i tillë dhe nga subjekti i cili aplikon kërkohet që mbrojtja të shtrihet edhe në vendet tjera të unionit. Këtë të drejtë mund që të shfrytëzon subjekti, mirëpo vendi që ka pretendime për një dizajnë i cili regjistrohet pranë unionit apo mos pajtim ka të drejtë që të refuzoj regjistrimin apo mbrojtje e një dizajni industrial të tillë në një afat kohorë të caktuar prej 6 mujor nga pranimi i aplikacionit.

Për regjistrim pranë unionit, duke arsyetuar dhe dëshmuar sipas legjislacionit të vendit. Poashtu është e mundur edhe mënyre elektronike e regjistrimit të dizajnit industrial pranë Organizatës Botërore për Pronësi Industriale (WIPO): Pranë WIPOs vepron edhe baza e të dhënave nga të gjitha Zyrat për pronësi industriale.¹⁰²

Global Design Database A world-wide collection of industrial designs data; including WIPO Hague registrations and information from participating national offices.

SEARCH BY Design Names Numbers Dates Country

Indication of Products ▾ =

Design class ▾ =

Description ▾ =

search

FILTER BY Source Designation Locarno Class Reg. Year *

CA Designs	157,875	ES Designs	97,240	JP Designs	528,900
NZ Designs	46,490	US Designs	788,032	ID Designs	56,693
WO Designs	49,658				

Display: List ▾ Sort: Value - asc ▾


filter

¹⁰² Global Design Database (<http://www.wipo.int/designdb/en/index.jsp>).

4.3.2 Procesi i regjistrimit të dizajnit industrial pranë Zyrës Evropiane për Pronësi Industriale(EUIPO)

Po ashtu sipas zyrës Evropiane të Pronësisë Intelektuale mundësohet edhe aplikimi për njohje të dizajnit industrial që ndryshe quhet edhe *dizajni i komunitetit* dhe ofron mbrojtje në gjithë vendet anëtare të Unionit Evropian, procesi është tepër i thjeshtësuar se poashtu edhe aplikimi i dizajnit të komunitetit mund të bëhet edhe nga webfaqja zyrtare. Personat të cilët aplikojnë për dizajn të komunitetit(community design) automatikisht gëzojnë mbrojtje në gjithë vendet unionit, procesi i aplikimit poashtu është gati se i njëjt si për dizajn nacional, Dizajni mund të regjistrohet dizajn i ri, apo paraprakisht i regjistruar, një karakteristik e veçantë është se EUIPO¹⁰³ njeh edhe dizajni e pa regjistruar ku një dizajn që ka arritur njohëshmëri në publik dhe nuk është i regjistruar gëzon nj mbrojtje maximale prej 3 viteve, ndërsa dizajni i regjistruar i komunitetit ka vlefshmëri 5vite me vazhdim nga 5 vite deri në 25 vite.

4.4 Emri gjeografik



Nga paraqitja grafike mund të kuptojmë më qartë se Emrin gjeografik, duke patur parasysh faktin se emri gjeografik është shenjë dalluese me anë të cilëve shënohen produktet dhe njëkohësisht kemi shënim të produkteve me markë tregtare, së pari të dallojmë markën tregtare nga emri gjeografik, ku ***me markë tregtare identifikohen produktin e ofruar nga bartësi i të drejtës (apo personi i autorizuar në bazë të marveshje, apo kontrate), së fituar me rregjistrim, marka tregtare ndihmon blerësin që të zgjedh kualitetin e produktit, dhe reputacionin e ofruar nga personi që ka të drejtën ekskluzive për shënimin e produkteve të tij me markën e rregjistruar.*** Me markë tregtare ofrohet shenja e cila përdoret nga bartësi i së drejtës për shënim dhe dallueshmëri të produkteve që ofron në treg, dhe ka të drejtë që të shënoj vetëm produktet e veta me shenjën e caktuar që paraprakisht ka rregjistruar pranë Entit nacional, apo në zyrat rajonale dhe ndërkombëtare.

¹⁰³ EUIPO- European Union Intellectual Property Office(<https://euipo.europa.eu/ohimportal/en/designs>)

Ndërsa me emrin gjeografik, identifikohen produktet në bazë të origjinës që karakterizojnë produktin me kualitet të veçantë në bazë teritoriale, ku ndikojnë kushtet natyrore dhe puna e njeriut. Poshtu veçanti e treguesit gjeografik është se indikon vendin e origjinës së produktit ku me emrin e tillë njifen produktet të ofruar në atë vend, poashtu mund të përdoret nga të gjithë personat që janë të regjistruar në listen gjatë procesit të regjistrimit të emrit gjeografik, nëse shikojmë anën subjektive të së drejtës.

Emri gjeografik formën e ka si marka kolektive, poashtu emri gjeografik nuk mund të bartet ndonjë personi tjetër jashtë sipërfaqes që është përcaktuar në elaborate apo specifikacion. Edhe pse dekadave të fundit dominojnë tregun markat tregtare dhe dizajni industrial, përsëri emri gjeografik ka rëndësinë e vet për produkte të caktuara dhe njëkohsisht ndikon edhe në zhvillimin ekonomik të vendeve rurale të cilët ofrojnë produkte të tilla nën ndikim, të vlerave të tokës, kushtet klimatike, mënyra e përdorimit, dhe puna e palodhëshme e faktorit njeri.

Siç paraqita në fillim emri gjeografik përbëhet nga dy pjesë kyçe të cilat poashtu janë të ndryshëm edhe nga procesi i regjistrimit poashtu edhe nga funksioni i tyre, në bazë të vlerave, dhe rëndësisë së produkteve në treg. Një shembull konkret kemi djathin e prodhuar nga Consorzio Parmigiano-Reggiano nga tre provinca të shtetit Italian, dhe vetëm lloji i qumshtit të asaj pjese mundë të jetë lëndë për prodhimin e djathit unik Parmigiano –Reggiano. Menjëherë kërkesë të lartë si në tregun e vendit poashtu në atë ndërkombëtar, me një shije unike,



Emri Gjeografik siç cekëm në fillim përbëhet nga dy fusha të cilat janë pakashumë të ngjajshëm porë dallojnë në bazë të kriteriumeve të regjistrimit.

Sipas WIPO ku për bazë meret pikrisht Konventa e Parisit mbi pronësinë industriale, ku qartë definojnë **treguesin e burimeve** dhe **treguesin e origjinës**, ku me tregues të burimeve nënkuptojmë çdo shenjë apo veprim që përdoret që ka të bëjë me shënimin e çdo produkti sa i përket një shteti, rajoni të caktuar, apo një hapsire gjeografike specifike, ndërsa me **treguesin e origjinës**, shënohet çdo produkt që vjen nga vendi i caktuar si shteti, rajoni, apo vendi specifik që ka karakteristika të veçanta për fitimin e tij, ku ndikojnë kushtet natyrore. Poashtu

egziston edhe një dallueshmeri sa i përket procesit të rregjistrimit të treguesit gjeografik dhe ati të origjinës, ku sipas kriteriumeve të përcaktuar (në vendin tonë Ligji për pronësi Industriale) për procesin e rregjistrimit treguesit e burimeve duhet të dëshmohet se produkti vjen nga vendi i caktuar, ndërsa me treguesit e origjinës kërkohen karakteristika, që e karakterizojnë atë pjesë të caktuar teritoriale, lidhjet me kualitetin me vendin e origjinës. Poashtu në bazë të WIPO-së konkretisht në bazë të Marveshjes së Lisabonës mbi rregjistrimin ndërkombëtar (ku janë 27 vende që kanë të ratifikuar këtë marveshje bashk me Maqedoninë) egziston edhe një formë më e zgjeruar në fushën e rregjistrimit ndërkombëtare me treguesin gjeografik mbrohen edhe emrat të cilat shënohen shtetet, qytetet, rajone, zona teritoriale, që nuk ka të bëjë me bartësin individual të së drejtës, porë këtë të drejtë e gëzojnë të gjithë personat vendbanim (personat fizik) dhe selinë (persona juridik) që veprojnë dhe punojnë në atë vend.

Duke nisur nga definimi i treguesit gjeografik sipas Marveshjes së Lisabonës WIPO po përdor termin tregues gjeografik në fushvperim më të gjërë. Porë origjina dhe baza e emrit gjeografik kryesisht është përodrur dhe përdoret për shënimin e produkteve agrikulturore, ushqimore, verëra, dhe pije të forta, produktet artizanale, dhe produkte industriale.

Sipas Ligjit për pronësi industriale të Maqedonisë (neni 26-264) sqaronë qartë se konkretisht çka quhet Emër gjeografik, si dhe procesi i rregjistrimit pranë ESHPI-së, si dhe obligimet gjat procesit të rregjistrimit dhe mbrojtja. Në vendin tone egzistojnë dy forma të rregjistrimit të Emrit gjeografik edhe atë :

Shenja e prejardhjes, ku kemi të bëjm me Emër gjeografik ku kemi të bëjm me emra të shteteve, rajoneve, apo hapsira e caktuar teritoriale, ku shënohen produktet të cilët vine nga zona ku kualiteti dhe kushtet klimatike, vlerat ushqyese të tokës, puna e njeriut mundësojnë prodhimin e produktit kualitativë në atë zone të caktuar si vendi i origjines.

Shenja gjeografike, ku me shenjë gjeografike shënohen produktet të cilët prodhohen nga persona (fizik, juridik) një vendi të caktuar. (shtet, rajon, zone).

Emri gjeografik rregjistrohet pranë Entit Shtetrorë për Pronësi industrial (ESHPI), në rast se kemi të bëjm mbrojtje të emrit gjeografik për produktet

buqësore sipas Ligjit për Kualitet të produkteve buqësore¹⁰⁴ fletaplikacioni dërgohet pranë Ministris së Buqësis dhe Pylltarisë dhe ekonomis së ujrave.

Për të inicuar procedurën e rregjistrimit të **emrit gjeografik** mund të nis çdo person fizik apo juridik, apo bashkim i dy e më tepër personave, institucion shtetrorë, zyrë e pushtetit lokal të cilët janë të aftë për të ndërmarin detyrim për mbrojtje dhe shfrytëzim të emrit gjeografik .

Për të inicuar procedurën e rregjistrimit të emrit gjeografik (nëse kemi të bëjm procedure për rregjistrim të emrit gjeografik fletparaqitja dërgohet pranë Ministris së Buqësis) plotësohet formulari për rregjistrim dhe kërkesë që duhet paraprakisht të shënohet se kemi të bëjm me rregjistrim të shenjës së prejardhjes apo të shenjës gjeografike.

Sipas rregullativës për rregjistrim të **emrit gjeografik –shenja e prejardhjes** përmban edhe elaborate nga institucioni fushës së caktuar për vlersim dhe kontrollim që njëkohsisht njifet si i tillë nga Enti për shtetrorë për pronësi industriale të Maqedonisë ku elaboratati përmban

- Emrin gjeografik të produktit që kërkohet të rregjistrim me shenjën e prejardhjes,
- Historikun e shkurt të produktit
- Të dhëna të kufijve territorial të hapsirës për të cilën kërkohet rregjistrim i emrit gjeografik,
- Prejardhja e produktit,
- Të dhëna në lidhjen me organet administrative në atë zone,
- Kushtet klimatike
- Hidrografia(informacion në lidhje me ujrat)
- Të dhëna për token,
- Të dhëna mbi procesin e prodhimit, kualiteti i prodhimit, prodhimi vjetor.

Të pregaditura nga ekspertë të fushën së caktuar pamvarësisht se për far lloj të produktit kërkohet rregjistrimi i emrit gjeografik konkretish shenja e prejardhjes, dhe duhet të theksojm faktin se kriteriumet për rregjistrim të shenjës së prejardhjes janë të shumta që duhet të plotsohen dhe vërtetohet që të gëzohet e drejta e mbrojtjes së emrit gjeografik-shenja e prejardhjes.

¹⁰⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr 100/2012

Ndërsa fletaparaqitja për rregjistrim të **emrit gjeografik- shenja gjeografike** për kundër kërkesës për rregjistrim të emrit gjeografik parashtruesi duhet të parashtroj pranë Entit edhe specifikacion për produktet që shënon emrin gjeografik, vlen të theksohet fakti se nëse kemi të bëjmë me produktet e verës dhe pijeve alkolike në vend të specifikacionit dërgohet elaborat.

Gjat procesit të aplikimit për rregjistrim të emrit gjeografik- shenjës gjeografike specifikacioni pregaditen nga parashtruesi i kërkesës për rregjistrim.

Emri gjeografik qoft shenjë e prejardhjes apo shenjë gjeografike është e drejtë kolektive ku mund të shfrytëzojnë persona të cilët ofrojnë produkte, nga të cilët është krijuar emri tregtarë, porë në fletparaqitje për rregjistrim paraprakisht duhet të theksohen shfrytëzuesit e emrit gjeografik.

- Shenjën e prejardhjes të emrit gjeografik mund të përdor personi (fizik apo juridik) që:
 - Prodhojnë produkte të cilat janë të mbrojtur me shenjën e prejardhjes konkrete.
 - Procesi i prodhimit realizohet në hapsirat gjeografike të shënuara në elaboratin.
 - Janë rregjistruar në rregjistrin si shfrytëzues të shenjës të prejardhjes.
- Shenjën gjeografike të emrit gjeografik mund të përdor personi (fizik apo juridik) që:
 - Prodhon produkte të cilat janë të mbrojtur me emrin gjeografik konkret.
 - Procesi i prodhimit realizohet në hapsirat gjeografike të shënuara në specifikacion.
 - Janë rregjistruar në rregjistrin si shfrytëzues të shenjës gjeografike.

Afati i shfrytëzimit të emrit gjeografik (shenjë e prejardhjes apo shenjë gjeografike) është 5 vite nga data e parashtrimit të fletparaqitjes për rregjistrim me të drejtë vazhdimi nga 5 vite pa limit. Poashtu emri gjeografik mund të rregjistrohet pranë WIPO për rregjistrim ndërkombëtar pasi që paraprakisht të jetë i rregjistruar në vendin e origjinës.

Në bazë të marveshjes së Lisabonës mbi rregjistrimin ndërkombëtar të emrit gjeografik egziston edhe rregjistrimi pranë zyrës të Unionit Evropian për pronësi Intelektuale edhe atë për produkte agrikulturore dhe ushqimore, për verëra dhe pije alkolike. Vendi jonë ka disa nga emrat gjeografik të mbrojtur, si Orizë Koçani, Grosha Tetovës, tash kohën e fundit në process të rregjistrimiti është edhe Qershia e Ohërit.

4.5. Mbrojtja e të drejtave nga pronësia industriale në Maqedoni

Një nga të drejtat që cenohen më së shumti si në aspektin ndërkombëtar por edhe në atë nacional padyshim që janë të drejtat e pronësis industriale dhe një trend që gjithmonë është në rritje, mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale e konkretisht të pronësisë industriale është një sfidë e të gjithëve duke përfshirë Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale me një përpjekje më të madhe të institucioneve shtetërore të vendeve në veçanti, mbrojtja e të drejtave nga pronësisë industriale gati është i pamundur të luftohet në vendet në zhvillim pasi që ndikim të madh kanë kushtet sociale, ekonomia e vendit, dhe njëkohësisht edhe korupcioni një fenomen që është tepër i pranishëm në vendet në zhvillim. Maqedonia edhe pse ka të ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare si Konventa e Parisit, Trips Marrëveshjen e shumë konventa e marveshje të ndryshme në fushën e pronësisë industriale dhe ligjet për mbrojtje të drejtave nga pronësia industriale janë të harmonizuar sipas marrëveshjeve ndërkombëtare poashtu edhe direktivave të Unionit Evropian. *Mund të konstatoj se Mbrojtja e të drejtave të pronësisë industriale në vendin tonë nuk është prioritet i institucioneve tona, ndoshta jo serioziteti në qasje të problemit.*

Mbi procesin e mbrojtjes të drejtave nga pronësia industriale, qartë parashihet në Marrëveshjen TRIPS konkretisht pjesa e tretë (neni 50 deri në 61) nga mbrojtja civile, puna e doganave, masat e përkohshme)¹⁰⁵poashtu edhe direktivat e unionit evropian¹⁰⁶ për luftimin e falsifikimit dhe mbrojtjes të drejtave nga pronësisë industriale nga vendet anëtare dhe pretendete për të qenë pjesë e Unionit Evropian. Llojet e mbrojtjes juridike të drejtave nga pronësia industriale në Republikën e Maqedonisë janë.

¹⁰⁵ Section 3 Provisional Measures of Trips Agreement (https://www.wto.org/english/docs_e/legal_e/27-trips.pdf).

¹⁰⁶ Combating counterfeiting Directive 2004/48/EC (http://www.europarl.europa.eu/atyourservice/en/displayFtu.html?ftuid=FTU_3.2.4.html).

4.5.1 Mbrojta Civile

Ku në bazë të legjislacionit të vendit për mbrojtje të drejtave të pronësisë industriale personi që shkel të drejtën e rregulluar me ligj, përgjigjet për dëmin e shkaktuar, në bazë të parimeve bazë në lidhje me dëmshpërblimin e dëmit të shkaktuar, sipas Ligjit për mardhënje obligative¹⁰⁷ ku si parim bazë është faji i supozuar, si element bazë për përgjegjësin e kontraktuese dhe jo kontraktuese ku pak është e rëndësishme e shkelësi i të drejtës ka pasur njohuri për veprën e kryer si shkelje të drejtës.

Kërkesa për kompensim të dëmin e shkaktuar mundë të parashtrohet bashkë me kërkesën për vërtetim të shkeljes të së drejtës. Mirpo procesi për shpagim të dëmit të shkaktuar nuk mund të jetë para procesit për vërtetim të dëmit të shkaktuar. Që do të thotë se nëse një person pretendon se i është shkelur e drejta nga persona të tretë, nuk mund të ngrenë procedurë para procedurës për vërtetim të dëmit të shkaktuar.

Bartësi i të ndonjë të drejte nga pronësia industriale ka të drejtë që para organeve të drejtësisë konkretisht pranë Gjykatës (shkalla e parë) kompetente mund të kërkoj që të mos vazhdohet më tej shkelja e të drejtës në fjalë, poashtu mund të kërkoj që të merret produkti apo produktet të cilët janë objekt me të cilët konstatohet shkelja. Nëse konstatohet shkelja e të drejtës nga pronësia industriale bartësi i të drejtës ka të drejtë të kërkoj shkatrim të produkteve në fjalë, si dhe ngarkim për harxhimet gjatë procesit gjyqësor ti ngarkohen shkelësit të së drejtës.

Si subjekte të parashtrimit të padis për shkelje të drejtave nga pronësiat industriale mund të paraqiten së pari kuptohet bartësi i së drejtës që pretendon se i është cenuar e drejta, parashtruesi i kërkesës për regjistrim të së drejtës pranë ESHPI-së (Enti Shtetërorë për Pronësi Industriale), personi i autorizuar nga bartësi me ndonjë formë kontrate, marëveshje, licencim dhe shfrytëzuesi, apo poseduesi i së drejtës.

Mendimi personal në lidhje me mbrojtjen civile të pronësisë industriale, që mendoj se në këtë rast duhet të vijmë në shprehje edhe të drejtat e konsumatorëve që edhe ata janë të kërcënuar nga shkeljet e të drejtave nga pronësia industriale, pasi që ata janë konsumatorët, apo shfrytëzuesit e fundit

¹⁰⁷ Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë nr 18/2001, 04/2002, 05/2003, 84/2008, 81/2009, 161/2009. (<http://pravda.gov.mk/documents/05%20ZAKON%20ZA%20OBLIGACIONITE%20ODNOSI.pdf>).

dhe të vetmit që është dedikuar e drejta, edhe pse humbjet janë të mëdha për bartësin e të drejtës, shfrytëzuesi është ai që del humbës më i madh, dhe mendoj se në vendin tonë duhet të kemi ndryshime sa i përket mbrojtjes të së drejtave të konsumatorit. Në vendin tonë në lidhje me shkeljet në fushën e markave tregtare, dizajnit industrial janë pothuajse dominuese, dhe bartësit e të drejtës janë në dijeni për këtë gjendje të shkaktuar nga manipulatorët dhe shitësit e produkteve të falsifikuar, dhe prezence e fenomenit **tregu i përhimt**¹⁰⁸. Në këtë rast mendoj se duhet edhe shfrytëzuesi i (konsumatori) duhet të ketë të drejtë ligjërish të padis, shitësit, ofruesit, shkelësit e të drejtës.

4.5.2. Dënimi Civil¹⁰⁹ dhe Penal

Dënimi Civil për shkeljet e të drejtave nga pronësia industriale parasheh që nëse konstatohet shkelje të drejtave të tilla me paramendim shkelësi i të drejtës obligohet që paguaj dënimin prej 200% deri 300%, një normë e cila funksionon më së shumti në vendet me sistemin e së drejtë **comon-law** si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada ku është një nga dënimet të cilat aplikohet më së shumti, posaçërisht në mbrojtje të markave tregtare, mirëpo nën ndikimin e këtyre vendeve si partecipues më të mëdhej në fushën e pronësisë industriale imponojnë edhe vendosjen në marrëveshjen e TRIPS-it. Në Maqedoni rastet e ralla janë të dënimit të tillë.

Dënimi Penal¹¹⁰ Sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë parasheh dënim prej 3 vite burg apo dënim me para për shkelësin e të drejtën nga fusha e pronësisë industriale me paramendim, që cenon të drejtën e parashtruesit të kërkesës për regjistrim të zbulimit, inovacionit. Si dhe për shfrytëzim të pa autorizuar nga bartësi apo parashtruesi i regjistrimit të së drejtës. Sipas nenit në fjalë të Kodit penal për persona juridik si shkelës i të drejtës nga fusha e pronësisë industriale parashihet dënim vetëm me para.

¹⁰⁸ Original në literaturën botërore njihet si **grey market** që do të thotë në vend kemi të bëjmë me ofrim të produkteve origjinale mirëpo jo nëpërmjet të shitësve, importuesve të autorizuar për ofrim të produkteve të tilla por nga shitës të pa autorizuar dhe njëkohisht me çmime shumë më të ulta. Ky fenomen është prezent posaçërisht kurë në vendin fqinj produkti i njëjtë është me çmim shumë më të ulët sesa produkti që ofrohet në vendin amë nga shitësit e autorizuar.

¹⁰⁹ Ligji për pronësi industriale neni 216.

¹¹⁰ Kodi Penal I Republikës së Maqedonisë Pjesa mbi zbulimin e paraqitur apo rregjistruar Neni 286 pka 1 deri 6.

4.6 Analizë e Punës së doganës dhe Inspektoratit Shtetrorë të tregut në mbrojtje të drejtave nga Pronësia Industriale.

Një nga organet kyçe të administratës në mbrojtje të drejtave nga pronësia Industriale (e në përgjithësi nga pronësia intelektuale) padyshim është Dogana duke funksionuar në bazë të rregullores për punën e doganave si element kyç Ligjit mbi masat e doganës për mbrojtje të pronësisë intelektuale¹¹¹, Marrëveshjen e Tripsit, Marrëveshjes për luftim të falsifikimit në treg (ACTA). Mirëpo krijimi i tregjeve të lira, zonave rajonale për qarkullim të lirë të mallrave ka sadopak ndikim negativ në luftim të kriminalitetit ekonomik, mbrojtjes të drejtave nga pronësia Industriale dhe pamundëson kontrollimin e plotë të kontrabanduesve që importojnë produkte të cilat janë objekt i shkeljes të drejtave nga pronësia industriale.

Siç theksova në fillim sipas të drejtës në vend nuk mund që të parashtrohet padi për dëmshpërblim të dëmit të shkaktuar para se të ngrehet padi për vërtetim të cenimit të drejtës nga pronësia industriale, dhe njëkohësisht shkeljet e të drejtave nga pronësia janë të shumta posaçërisht tek markat tregtare, dhe dizajni industrial. Sipas LPIM (në vazhdim Ligji për Pronësi Industriale) si shkelje të drejtave konsiderohet veprimet në vazhdim:

- ✚ **Përdorimi** i të drejtës në fjalë nënkupton përdorimin e pa autorizuar me ndonjë nga elementet si marrëveshje, kontratë, vendim gjyqësor, ku personi bartës i të drejtës konstaton se kemi të bëjmë me përdorim të pa autorizuar nga persona të tretë, ka të drejtë të ngrenë padi pranë gjykatës kompetente të vendbanimit, selisë (nëse kemi të bëjmë me person juridik).
- ✚ **Posedimi (disponimi)** të posedosh njërën nga të drejtat në formë të pa autorizuar të pronësisë industriale sipas LPIM është shkelje e të drejtave të bartësit e të drejtës.
- ✚ **Ngjashmëria** është një element kyç në fushën e pronësisë industriale si element bazë për parashtrimin e padis për shkeljeve të drejtave, si shembull kemi të bëjmë me dizajnin industrial ku marka nuk është e shkruar e njëjtë në produkt, mirëpo kemi të bëjmë me forma linja, fjalë, fotografi që asocion me bartësin origjinal të së drejtës dhe shkakton huti tek konsumatori mesatar, gjatë procesit të blerjes të produktit që shënohet me dizajnin e caktuar. Në këtë rast me konsumatorë mesatar nënkuptojmë

¹¹¹Ligji për masat e doganës për mbrojtje të drejtave nga Pronësia Intelektuale I shpallur në Gazeta zyrtare e Republikës Maqedonisë nr 88/2015, 154/2015, 192/2015, 23/2016. (<http://www.customs.gov.mk/index.php/mk/za-nas-mk/carinska-regulativa/zakon-za-intelektualna-sopstvenost>)

personat të cilët drejtohet vendit të ofrimit të produktit, mirëpo nuk kanë njohuri të thelluara në lidhje me të drejtën në fjalë dhe konfrontohen me produktin e njërit ofrues dhe të tjetrit, në këtë rast në sjelljen e përditshme të procesit të blerjes negatron produktin e njërit ofrues me atë të tjetrit ,shembull i në vazhdim ku kemi të ofruar dy produkte të ndryshme , mirëpo forma, është tepër e njëjtë, dhe njëkohësisht dizajni nuk ndryshon fare, poashtu edhe forma e ambalazhimit, renditja në ambalazhe e nejtë.fig1. dhe fig2.



Apo rasti tjetër që kemi paraqitur në Kapitullin e 3.4 fig 3.



Rastet e tilla janë të panumërta të cilët i kemi në tregun e vendit tonë, si produkte ushqimore, që dominojnë, higjienike, lojëra, e shumë produkte.

Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale Drejtoria e Doganave të Republikës së Maqedonisë vepron në dy raste ku shkaktohet shkelje e të drejtave nga Pronësia Industriale edhe atë :

- ✚ **Me kërkesë të bartësit të drejtës për të vepruar.**
- ✚ **Nga puna e përditshme e organeve të doganës.**

Bartësi i të drejtës gëzon të drejtën që në formë të shkruar të parashtroj kërkesë për informim dhe veprim pranë drejtorisë të doganave të vendit, në lidhje me produktet që futen në vend dhe që pretendon se mund të jenë bazë për shkelje të drejtës së tij.

Kërkesa duhet të përmbaj informacione të qarta si për bartësin e të drejtës, poashtu edhe dëshmi se ai me të vërtet është bartësi i të drejtës, poashtu duhet të siguroj informacione në lidhje me sasinë e produktit, llojin e tij, si dhe çdo informacion shtesë që ka të bëjë me shkeljen e mundshme të së drejtës së tij, poashtu informacione në lidhje vlerën e mallit origjinal, vendndodhjen, karakteristikat dalluese të produktit që shënohet me të drejtën e tij, që supozohet se është i emituar, apo falsifikuar kuptohet nëse ka informacione të tilla, dhe gjitha informacionet e mundshme që të lehtësoj punën e doganës the argumente sa më të shumta në numër njëkohsisht ndihmojnë procesin e kapjes të produkteve të tilla.

Procedura në vazhdim varet nga organet e doganës ku pas kërkesës nga bartësi i të drejtës në formë të shkruar drejtoria e doganave merë në shqyrtim kërkesën e tillë dhe merë vendim në afat kohor prej 30 ditëve për vendim e hedhjes poshtë të kërkesës apo aprovimin dhe njëkohësisht njofton në formë të shkruar bartësin e të drejtës, po ashtu njofton edhe administratën doganore kompetente dhe hapat e mundshëm për veprim për afat kohorë maximal prej 1viti, ku

poashtu me kërkesë dhe arsyetime të pranuar ky afat mund të vazhdohet. Poashtu bartësi i të drejtës dhe njëkohësisht parashtruesi i kërkesës nëse e drejta e tij pushon gjatë periudhës para veprimit të doganë duhet të informon organet kompetente të doganës në lidhje me pushimin e të drejtës së tij..

Nëse organet doganiere gjatë futjes së mallrave konstatojnë se gjatë futjes së mallit që shkel të drejtat e bartësit dhe në bazë informacioneve dhe karakteristikave të dhëna nga parashtruesi i kërkesës konstaton se kemi të bëjmë pikërisht me shkeljen e të drejtës të parashtruesit të kërkesës e informon të njëjtin në lidhje me produktin që pretendohet se është ai i njëjti që supozon parashtruesi i kërkesës organet e doganës lejojnë që bartësi të drejtës të shikoj mallin pranë doganës dhe njëkohësisht i mundësohet marrja e mostrave nga malli i tillë që më pas dërgon në analizë të mëtejshme për të konstatuar se a bëhet fjalë konkretisht për atë mall që pretendohet si shkelësi i të drejtës së tij, ku më pas duhet të kthen sasinë e marë pas përfundimit të analizës.

Puna e doganës është nëse konstaton se malli i ndaluar pranë doganës është pikërisht ai që ka parashtruar kërkuesi dhe njëkohësisht bartës i të drejtës kërkon që në afat prej 10 ditë pune të vërtetoj dhe argumentoj se pikërisht është ai mall (në raste nëse kemi të bëjmë me mall të cilat prishen lehtë afati është prej 3 ditë pune), në raste se kemi arsyetime të pranuar nga drejtoria e doganave ki afat mund që të vazhdohet, apo me kërkesë të organit gjyqësor për procesin gjyqësor që ka të bëj pikërisht me mallin e tillë. Dogana ka të drejtë që të shkatroj mallin e tillë, njëkohësisht me pëlqim të importuesit të mallit me shkrim apo personit të autorizuar që përfaqëson importuesin, asgjësimi (shkatrimi) i mallit të tillë bëhet nën pranin dhe mbykqyrjen e organeve të doganës, ku harxhimet bien mbi bartësin e të drejtës, duke mbajtur një mostër nga malli i tillë për dëshmi në proceset e ardhshme gjyqësore në lidhje me shkeljen e të drejtës të përcaktuar.

4.6.1. Inspektorati Shtetërorë i Tregut

Një nga organet më fleksibile dhe më efektive(duhet të jetë) në mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale është Inspektorati shtetërorë i Tregut më herët si degë e Ministrisë së Ekonomisë viteve të fundit si Drejtori e pavarur, i cili funksionon në bazë të rregullores , dhe Ligjit mbi Inspektoratit shtetërorë

të Tregut¹¹² dhe një grup Ligjeve nu fushën e mbrojtjes të drejtave të konsumatorëve, por në rastin tonë Ligji për Pronësi Industriale.

Për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale është kompetent edhe Inspektorati Shtetërorë i Tregut, pasi që dimë se proceset gjyqësore janë të gjata dhe me procedura të stërngarkuara, ndërsa inspektorët e ISHT-së (Inspektorati Shtetërorë i Tregut) janë në numër më të madh dhe njëkohësisht gati se çdo ditë në teren për kontrole që kryejnë në subjekte për të kontrolluar shkeljet e mundshme duke vepruar me masa të përkohshme nëse konstatohet shkelje.

Inspektorati vepron në bazë të planeve operative ditore, mujore, apo vjetore për kontrollet që kryen, në fushën e pronësisë industriale si tek dogana kemi dy lloje të kontrollit për shkeljet e mundshme të drejtave nga pronësia industriale, edhe atë

1. Me kërkesë të bartësit të së drejtës, (kur themi bartësi mund të jetë, person i autorizuar nga bartësi, i licencuar, në bazë të marrëveshjes apo kontratës). Ku bartësi parashtron kërkesë pranë ISHT, nëse vëren shkelje të së drejtës që është bartës, ku inspektorati duhet që menjëherë të veproj duke kryer procedurat e kontrollit.
2. Nga kontrollet rutinë të inspektorëve

Puna e Inspektoratit të Tregut në lidhje me mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale, pavarësisht se bëhet fjalë për kërkesë të bartësit të së drejtës, apo nga kontrolli rutinë që kryejnë, nëse konstaton shkelje të drejtave nga pronësia industriale bie aktvendim për largim të produkteve që janë objekt i shkeljes, mjeteve, apo dokumentacioneve që lidhen me to, dhe shqipton masën për pengim të shkeljeve të mëtejshme, dhe përcakton afatet për tërheqjen e tyre nga qarkullimi, duke njoftuar bartësin e të drejtës në lidhje me shkeljen të drejtës së tij, dhe kërkim të informacioneve në lidhje me të drejtën që është bartës. Nëse personi (qoftë fizik apo juridik) nuk veprojnë në bazë të urdhrit të inspektorit atëherë bie aktvendim për ndërprerje të përkohshëm të veprimtarisë për 30 ditë, si dhe vulosje të hapësirës që kryhet veprimtaria, si dhe sekuestrim të produkteve që janë element të shkeljes të së drejtës.

Pastaj inspektori obligohet që lëndën dhe argumentet mallrat e sekuestruar të dorëzoj pranë gjykatës kompetente në bazë të adresës së subjektit, ku më pas me

¹¹² Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr 24/2007, 81/2007, 36/11, 164/13, 41/14, 33/15, 61/15, 15/15 dhe 53/16.

vendim gjyqësor dhe në bazë të ligjit për zbatim të sanksionit mallrat e tillë asgjësohen. Më pas nëse inspektori konstaton se me shkeljen e të drejtës së pronësisë industriale është realizuar përfitime kundërligjore pronësore, është i obliguar që me kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje të kërkoj që të merren përfitimet e tilla pronësore.

Në Republikën e Maqedonisë si çdo vend në zhvillim dhe si vend pretendent për antarsim në Unionin Evropian, aspekti juridik i mbrojtjes të drejtave nga pronësia industriale lartë-poshtë është i harmonizuar si me marrëveshjet në fushën e pronësisë industriale (në përgjithësi intelektuale) që ka të ratifikuar vendi poashtu edhe me direktivat e Parlamentit dhe Komisionit Evropian, por nga Raportet vjetore pikërisht të Inspektoratit Shtetërorë të Tregut mund të konstatojmë se ky institucion shtetërorë për mbrojtje të drejtave të Pronësisë industriale nuk kontribuon **aspak** në fushën e mbrojtjes të drejtave nga Pronësia industriale, edhe pse WIPO, Unioni Evropian me seminare, takime, mundohet të inkurajoj punën në fushën e mbrojtjes të drejtave të tilla, për fat të keq rezultatet janë në rrënje.

Këtë konstatim e bëj për faktin se edhe vet jam i punësuar në këtë Institucion dhe nga puna e përditshme dhe raportet që sigurohen mendoj që vendi jonë jashtë reformave ligjore që është në proces, por më e rëndësishme është se reformat rrënjësore duhet të kemi edhe në aspektin organizativ të institucioneve tona.

Në vazhdim paraqes raportet e Inspektorat Shtetërorë të Tregut në lidhje kontrollet e kryera gjatë periudhave të caktuara kohore, ku qartë shihet puna e tyre në lidhje me mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale.

Број на инспекциски надзори според закон со најголемо учество



113

Poashtu tabela në vazhdim tregon me numër që sa kontrole janë kryer në total nga Inspektorati i Tregut.

Закон за животна средина	62								1	63
Закон за градежни производи	202			89					105	396
Закон за индустриска сопственост	15			11					8	34
Закон за безбедност на производи	753			164						917
Закон за државен пазарен инспекторат	34			23					1	58
Закон за предмети од скапоцени м	168			9					4	181
Закон за возила	10			2						12
Закон за енергетика	76								22	98
Закон за шуми	3								3	6
Закон за тутун и производи од тутун	1								2	3
Закон за електронска трговија	9									9
Закон за акцизите	152			3					38	193
Закон за управување со електрична и електронска опрема	17			1						18
Закон за управување со пакување	158			17						175
Закон за постапување по преставки и предлози									18	18
Закон за бучава во животна средина	9								2	11
Закон за ваучери	4									4
Закон за инспекциски надзор	15								11	26
Закон за работни односи	109			10					13	132
Закон за забрана и спречување на вршење на нерегистрирана дејност	136			5					15	156
Закон за индустриска сопственост	20			7					28	55
Вкупно / просечно	31750			4188					4105	40043

Ku qartë shihet se në fushën e Pronësisë Industriale në bazë të ligjit për Pronësi Industriale kemi 20 kontrole të rregullta dhe 7 kontrole të jashtëzakonshme në total 27 Kontrole dhe nga e gjitha konstatojmë se ISHT në fushën e Pronësisë Industriale ka kryer **0.075% kontrole** që argumenton faktin tim se

¹¹³ Tabela e marur nga webfaqja e ISHT-së(www.dpi.gov.mk) që tregon se në bazë të cila ligjeve ka realizar kontrollet gjat vitit 2015.

institucionet e vendit tonë janë vetëm shfrytëzues të grandeve, mjeteve qofshin financiare, apo ndihmave teknike, dhe në fakt në praktikë rezultatet janë alarmante.


4.6.2 Analizë e punës së inspektoratit shtetrorë të tregut në bazë të raporteve vjetore gjatë periudhës 2010-2015.

Sipas Ligjit për pronësi industriale në Republikën e Maqedonisë padyshim një ndër institucionet kyçe në fushën e mbrojtjes të drejtave nga pronësia industrial është Inspektorati Shtetrorë I Tregut (në vazhdim ISHT), ku gjatë punës të organit në fjalë me inspektorët në teren në gjithë teritorin e Republikës së Maqedonisë duke realizuar kontrole tek individut fizikë si dhe subjektet afariste, në bazë të rregullores për punë të ISHT-së, ku kontrollet kryhen kryesisht në bazë të planit paraprak të hartuar mbi kontrollet që ndryshe quhet edhe kontrollet e rregullta që kryejn inspektorët, dhe kontrollet e jashtëzakonëshme, ku dominojnë kontrollet e rregullta. Sipas rregullores për punë të ISHT-së një Inspektor në një kontrollë ndaj subjekteve kontrollon për shkeljet e mundëshme në bazë të ligjeve të përcaktuar ku kryesisht janë mbi 30 ligje (**Ligji për Inspektoratin e tregut, Ligji për tregti, Ligji për hoteleri, Ligji për punë turistike, Ligji për shoqërit tregtare, Ligji për meteorologji, Ligji për mbrojtje të konsumatorëve, Ligji për mbrojtje nga pierja e duhanit, Ligji për pronësi industriale**) dhe që ISHT-ja është kompetente për kontrollim të shkeljeve të mundëshme që përcaktohen me dispozitat në fjalë. Gjatë analizimit të raporteve të inspektoratit të tregut që është shumë lehtë për tu gjendur në webfaqen zyrtare të këtij institucioni (www.dpi.gov.mk) kemi të gjitha raportet nga periudha 2010 e deri në 2015 ku kryesisht nga ky organë në teren në vitë në gjithë teritorin e vendit kontrollohen rreth 30,000 kontrole në vit (ku 80% janë kontrole të rregullta, 10% kontrole të përsëritura apo kontrolluese dhe 10% kontrole të jashtëzakonëshme). Një punë me të vërtetë e ngarkuar nga ky institucionë.

Por shtrohet pyetja sa kontrole kryen Inspektorati Shtetrorë i Tregut në lidhje me mbrojtjen e të drejtave nga **pronësia industriale (patentat, markat tregtare, dizajni industrial, treguesit gjeografik)** që poashtu janë mjaftë me rëndësi për fushën e studimit tone dhe njëkohësisht nga rekomandimet e Unionit Evropjan, dhe Organizatës Botërore të Pronësis Industriale (WIPO) për vendet në zhvillim dhe njëkohësisht pretendete për antarsim në Unionin Evropjan, dhe që dime dhe gati se çdo ditë shofim shkelje të drejtave të

pronësis industriale që kemi folur në tërsi në pikën mbi Falsifikimin dhe kontrabandimin e mallrave që në vendin tone është mjaft e zhvilluar.

Porë një fakt është mjaftë tepër i rëndësishëm se gjat analizimit të raporteve të punës të inspektoratit shtetrorë të tregut ku mbi 30,000 inspektime të kryera në teritorin e Republikës së Maqedonisë na habit fakti se inspektimet në bazë të ligjit për pronësi industriale **nuk kryhen (0,1% nga kontrollet totale të inspektoratit në tër teritorin dhe nga totali I kontrolleve të kryera)**., këtë fakt e vërtetoj në bazë të punës së inspektoratit të tregut ku në vazhdim do të paraqes me shifra dhe grafike . Dhe numri më i lartë i kontrolleve të kryera është pikrisht viti 2010.



Gjatë vitit 2010 Inspektorati i tregut ka kryer 44,029 kontrolle në total nga të gjitha njësit rajonale, në tër teritorin e Republikës së Maqedonisë, ku kemi konstatim të shkeljeve dhe marje të masave nga ky organ në bazë të ligjeve nga të cilët bazohet puna e inspektoratit të tregut kemi të bëjmë me total 1577 vendime ku më mirë paraqesim me grafikun në vazhdim, pasi që në raportin vjetorë të punës të inspektoratit të tregut nuk specifikohen kontrollet e kryera në bazë të ligjeve në fjalë porë në raport paraqiten vetëm vendimet e mara nga Inspektorati i tregut në lidhje me shkeljet e konstatuara. Si dhe vendimet e mara nga ky organ ku siç paraqesim në tablën në vazhdim nga totali i kontrolleve të kryera të shkeljeve 1577 kemi të bëjmë vetëm 19 konstatime për shkelje në bazë të Ligjit për pronësi Industriale, që i bie se 1,2% nga totali i shkeljeve të

konstaturo nga Inspektorët gjatë kontrolleve të kryera janë në bazë të ligjit mbi pronësi Industriale.



Sipas raportit të vitit 2011 janë realizuar 29,140 kontrolle në total ku në radhitje në bazë të kontrolleve të kryera si ata në bazë të planit operativ , kontrolluese si dhe të jashtëzakonëshme në bazë të renditjes ligjore lartë poshtë si në vitin 2010, në fushën tone konkretisht në bazë të Ligjit për pronësi industriale në vitin 2011 nga 29,140 kontrolle të kryera në total rezultojnë vetëm 321 kontrolle, që në përpjestim me totalin e kontrolleve të kryera i bie se kemi të bëjmë vetëm me **1.1%** të total të kontrolleve të kryera.

Po ashtu në vitin 2012 janë realizuar 40,355 kontrolle në total ku në bazë të ligjit për pronësi industriale në raport ceken vetëm **120** kontrolle të kryera që në raport me totalin barazohet me zero (**0.29%**) nga totali i kontrolleve të kryera për këtë vit.

Në raportin e vitit 2013 janë realizuar gjithsej 40582 kontrolle në bazë të rregullores për punë të inspektoratit të tregut në bazë të ligjit për pronësi industriale në total figurojnë vetëm një shumë simbolike prej 76 kontrolleve përsëri kemi **0.16%** të kontrolleve të kryera, një shumë simbolike. Poashtu në vitin 2014 nga totali i 45,406 kontrolleve të kryera në bazë të ligjit për Pronësi industriale kemi vetëm 70 kontrolle që kemi **0,15%** të kontrolleve të kryera i njëjti trend paraqitet edhe në vitin 2015 ku nga 40043 kontrolle në total kemi vetëm 34 kontrolle në bazë të ligjit për pronësi industrial **0,08%** të totalit të kontrolleve

Në bazë të grafikonit mund të shohim se kemi të bëjmë me një numër shumë të vogël të kontrolleve aq sa i vogël që është dhe me një trend në rrënjë. Nëse akumulojmë të dhënat për periudhën 2010-2015 mund të konstatojmë se puna e inspektoratit të tregut në lldhje me mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale është një trend në rrënjë me një përqindje të kontrolleve e barazuar me **zero**, që nuk e kalon shifrën prej mbi 1% dhe, në raport me kontrollet e kryera del se Inspektorati i Tregut vetëm formalisht kryen kontrolle në fushën e pronësis industriale, dhe një fakt që shifet edhe në përditshmërin e qytetareve ku tregjet e vendit janë të stërmbytur me produkte të falsifikuara, dhe të kontrabanduara në sy të inspektorëve, dhe mos thënë që vetë ata janë konsumatorë të produkteve në fjalë që përbëjnë shkelje të drejtave nga pronësia industriale.

PËRFUNDIMI

Të sfidosh mashtrimet, keqpërdorimet, vetit e këqija në një shoqëri është një luftë vazhdueshme në shoqëri në çdo aspekt në çdo sferë të jetës, si e tillë është një dukuri e komplikuar sa edhe e vështir për tu luftuar, pasi që ndikojnë shumë faktorë që pengojnë largimin e fenomeneve të tilla.

Poashtu edhe fusha e mbrojtjes të pronësisë industriale është gjithmonë nën sulme të vazhdueshme pasi që kulminacioni është interesi pa bazë (përfitime nga shfrytëzimi i të drejtave që gëzon dikush tjetër) si e tillë është tepër e vështir për tu luftuar posaqërisht në vendet me nivele arsimimi të ulët, edukata arsimore, stili i jetës, vlerat morale, njerzore, pamundësojnë një sistem që siguron mbrojtje maksimale të drejtave të cilat gëzojnë bartësit e tyre.

Problemet më të mëdha në fushën e mbrojtjes të drejtave nga pronësia industriale paraqiten pikërisht në vendet që janë zhvillim dhe një përqindje më të ulët në vendet e zhvilluara. Për kundër faktit se këta vende (në zhvillim) kanë shoqërinë më të re si në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri.

Aspekti social ndikohet nga disa faktorë kyç që janë të rëndësishëm poashtu edhe në fushën ekonomike, e juridike të vendit. Familja konsiderohet si e shenjtë, ku bazamenti i krijimit të personalitetit dhe hapat e para të vlerave njerzore meren pikërisht nga edukata familjare, pastaj ndikim të madh ka niveli arsimore, që për fat të keq vlerat arsimore i kemi rënë të vazhdueshme duke mos i kushtuar rëndësi, aspak, kreativiteti, dhe zbulimit të talentëve në gjitha fushat që mund të jepet kontributi.

Stili i jetës, punësimi, të ardhurat, poashtu janë faktorë të rëndësishëm social që kanë ndikim të lartë sa i përket vlerave sociale. Stili i jetës është tepër i rëndësishëm që është me ndikim të lartë në shoqëri, ku me globalizimin dhe zhvillimin e teknologjisë komunikative, me të vërtetë aq sa pozitive që janë porë kanë edhe efektet negative në shoqëri, pasi që sot në një smartphone, apo tablet eke mundësinë të shofësh se si jetonë një Amerikan, një Japonez, apo edhe një Afrikan dhe kanë ndikim të lartë në shoqëri, pasi që çdokush mundohet që si të përmisoj stilin e jetës, dhe si të arrij tek të ardhurat më të mira për të përmisuar stilin e jetës. Porë në vendet me ekonomi të brishtë është gati e pamundur një stil jete i mirë, pasi që në vendin tonë siç dimë të ardhurat për një familje nuk mjaftojnë për të siguruar kushtet minimale

jetësore, e kjo është tepër e rëndësishme për stilin e jetës. Poashtu punësimi është një element bazë për funksionimin e një shoqërie, ku për fatë të keq vendet në zhvillim kanë një përqindje të lartë të papunësis, dhe si e tillë ndikon në stilin e jetës.

Mbrojtja e të drejtave nga pronësia industriale është një sfidë e madhe si në aspektin ndërkombëtar poashtu edhe atë nacional, ku gati se e pamundur është luftimi i falsifikimit, imitimit, të markave, dizajneve industriale, të drejtat e autorit (si pjesë e pronësis intelektuale) kontrollimi e lëre eliminimin e tyre. Pasi që thamë se fusha e mbrojtjes juridike lartë poshtë është e harmonizuar me kërkesat, direktivat, parimet e marveshjeve ndërkombëtare, porë problemi qëndron në zbatim të tyre posaqërisht në vendet në zhvillim që kemi të bëjmë me fenomenin ku nuk është prioritet zgjedhja e brendit, porë luftimi për të siguruar kafshatën e gojës, dhe në këta vende është e pamundur kontrolli i mirëfillt, sa i përket kriminalitetit ekonomik.

Në një vend me të ardhura mesatare të cilat nuk mbulojnë harxhimet primare jetësore nuk mund të kërkojë mos eliminimin e produkteve të imituara, pasi që kërkesa dirigjon ofertën, gjersa kërkesa për produkte të tilla është e lartë, ku kushtet ekonomike blerësin nuk e lejojnë të blejë produkte origjinale të produkteve të brenduara që për një produkt të tillë duhet të shpenzohet 50% i të ardhurave mujore. Një fenomen i tillë që nuk është në vendet e zhvilluara.

Poashtu ndikim të madhë sa i përket mbrojtjes të drejtave nga fusha e pronësis industriale ka niveli i edukimit, mënyra se si pranohet dispozitat ligjore në shoqëri, dhe rëndësia e tyre mbi mënyrën e sjelljeve të qytetarëve ndaj dispozitave të tilla, në një shoqëri të zhvilluar dispozitat ligjore janë më të respektueshme, ndërsa në vendet në zhvillim e ulët. Si shembull i tillë është nëse në Japoni nuk paguan tatimin ndjelesh i turpëruar, ndërsa në vendin tonë është zotësi, gjenialiteti si të arish që të mos pagush tatimin.

Përqendrimi i kapitalit në një përqindje të ulët të njerëzve sa vin e ritet, dhe si të trendi i tillë ndikon në eliminimin e klasës së mesme, duke krijuar një gap (hapsirë) të madh në mes të pasurve dhe të varfërve, që poashtu ndikon në fushën e mbrojtjes së të drejtave.

Poashtu edhe bartësit e të drejtave në fushën e pronësis industriale, mendoj se menaxhojnë aqë mirë fushën e marketingut sa i përket të drejtave të tyre,

duke rritur vlerat monetare të brendëve të tyre, që gati se janë të pa përballueshme për shumicën e konsumatorëve në vendet në zhvillim.

Maqedonia si një vend në tranzicion gati 3 dekada në fushën politike kemi ngecje të vazhdueshme ndoshta jemi në të njejtën pikënisje që nga shkëputja e Federatës Jugosllave, duke krijuar politika jo të mira për zhvillimin ekonomik të vendit, dhe njëkohësisht më së shumti pësojnë qytetarët.

Çelësi i çdo suksesi në një shoqëri pamvarësisht sa është e zhvilluar porë ndikimin më të lartë kuptohet eka në vendet në zhvillim, me nivel të ulët shkollimi, është **korupsioni**. Në një shoqëri ku korupsioni dominon në çdo sferë të jetës është e pamundur për të realizuar objektiva, kyçe të mbrojtjes jo vetëm të drejtave nga pronësia industriale, korupsioni është smundje kronike e shoqërisë që bazën fillimin eka nga institucionet shtetore. Që janë nxitësit e fenomenit të till, që ndikon në mos zbatimin, mos respektimin e të drejtave dhe detyrimeve në një shoqëri. Në një vend me shtrirje të lartë të korupsionit është e pamundur të realizosh të drejtat dhe detyrimet që dalin nga e drejta pozitive në çdo aspekt.

Poasqërisht ndikim të lartë ka në fushën e mbrojtjes të drejtave nga pronësia industriale, pasi që vendi jonë është një nga vendet më të korruptuara edhe pse pretendojm, dhe mendojm se luftojmë korupsionin porë në fakt pikërisht institucionet të cilat janë faktorë kyç të mbrojtjes të drejtave janë më të korruptuarit, duke nisur nga gjykatat, doganat, inspektoratet, duke krijuar një zinxhir institucioneve, dhe si e tillë pamundësohet mbrojtja e të drejtave.

Maqedonia edhe pse duhet bërë edhe shumë në harmonizimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes të drejtave nga pronësis industriale, duke u bazuar në atë të vendeve të Bashkimit Evropian që gati dy dekada pretendojm të antarsohemi, është e pranueshme, porë prioritet i vendit tonë nuk është zbatimi praktik i të drejtës pozitive. Dhe lirshëm mund të konstatojmë se në një vend si vendi jonë nuk mundë të kërkojm mbrojtje ideale të drejtave nga pronësia industriale kurë siç thamë ke gjykata jo të drejta të korruptuara, dogana poashtu, inspektorati i tregut që është një organet më fleksibile dhe me përballje të përditshme me shkeljet nga fusha e pronësis industriale, gati se ua zënë sytë, dhe njëkohësisht ata janë konsumuesit e këtyre produkteve është e pamundur të mbrosh të drejtat e tilla.

Nga pamvarsimi i vendit tonë është me një sistem politik të brishtë ku mendohet ndryshe dhe punohet ndryshe shumë të kësaj vlera të mirfillta në shoqëri. Unioni Evropian investon në fushën e mbrojtjes të drejtave të pronësisë industriale porë suksesi është tepër tepër i ulët, pasi që institucionet tona seminarët, trajnimet nuk i konsiderojnë si fitim njohurive, si obligime që duhet të marrin për të çuar në fund një mision të caktuar, ata përkundrazi i konsiderojnë si ekskurzione kolektive institucionale për shëtitje, dhe dëfrim. Duke haruar se janë të zgjedhur nga populli, dhe pagesa e tyre sigurohet nga tatimet të cilat paguan çdo qytetarë, qoftë edhe nga blerja e një buke të vetme paguan një 5% .

Lirshëm si përfundim mund të konstatoj, se vendi jonë nuk ka prioritet mbrojtjen e të drejtave nga fusha e pronësisë industriale, ndoshta ndikon në zhvillimi ekonomik, politik, dhe social, edhe pikërisht nxitja e zbulimeve, shpikjeve është tepër e ulët si në shkollat të larta e universitete, ku vendet e zhvilluara investojnë në këtë fushë dhe kanë sukseset e tyre. Ndoshta mendimi imë është pesimist porë në një shoqëri për të aritur vlera dhe suksese duhet të punohet dhe njohësish duhet të egzistoj përgjegjësia për punën e kryer. Porë ky është realiteti politik, ekonomik dhe social në vendin tonë, që është shumë largë nga objektivat që duhet realizuar.

LITERATURA

Koçi, Elina “Pronësia Intelektuale (E drejta e autorit dhe market)”, dhjetor 2003.

Botime juridike “Komentar për patentat dhe markat”, tetor 2007.

Hetemi Mehdi “Mbrojtja e tregut të lirë nga konkurenca jolojale”(aspekti krahasimor), janar 2004.

Mac Queen, Hector “Contemporary intellectual property” 2-nd edition, may 2010.

Дабовиќ , Јадранка и Бучковски Владо “ Интелектуална сопственост и индустриска сопственост” 2004.

Bloch, Joel “Plagiarism, intellectual property and the teaching of L2 writing” March 2012.

May Christopher “A global political economy of intellectual property rights “ August 2000.

Deqa, Fatos “Pronësia Intelektuale” 2014.

WIPO (World Intellectual Property Organization)” Intellectual Property Handbook”

(http://www.wipo.int/edocs/pubdocs/en/intproperty/489/wipo_pub_489.pdf) 2004reprinted 2008.

Ligji për pronësi industrial (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 21/2009, me ndryshimet e fundit shtator , 2015(

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/eb2b444075114277b630a93e52706e69.pdf>).

Закон за државен пазарен инспекторат 01.03.2007 Службен весник 27/2007,со последни измени и дополнувања 03.09.2016

(<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/eb2b444075114277b630a93e52706c69.pdf>).

Marveshjet ndërkombëtare

Marëveshja për të drejtat e patentës, Miratuar në Gjenevë më 1 Qershor të vitit 2000, E shpallur në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr.163/09 (<http://www.ippo.gov.mk/SQ/Legjislacioni.aspx?In=SQ&cat=INT>).

Marëveshja e Lokranos për themelimin e Klasifikimit Ndërkombëtar për mostrat dhe modelet industriale, të nënshkruar në Lokrano më 8 tetor të vitit 1968 dhe ndryshuar më 2 tetor të vitit 1979, Publikuar në Gazetën zyrtare të RM-së nr. 5/74, (<http://www.ippo.mk/SQ/Legjislacioni.aspx?In=SQ&cat=INT>).

TRIPS (Marëveshja për aspektin tregëtar të të drejtave të pronësisë industriale në Marakesh më 15 Prill 1994. (<http://ippo.gov.mk/SQ/LegjislacioniView.aspx?lang=SQ&id=298&cat=INT>).

Akti i Gjenevës mbi Marrëveshjen e Hagës lidhur me regjistrimin ndërkombëtar të dizajnit industrial, shpallur në Gazetën zyrtare të RM-së nr.33/05.

Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale e mbajtur në 30 mars 1883 Rishikuar në Bruksel më 14 dhjetor të vitit 1900, në Uashington më 2 qershor të vitit 1911, në Hagë më 6 nëntor të vitit 1925, në Londër më 2 qershor të vitit 1934, në Lisbonë më 31 tetor të vitit 1958, në Stokholm më 14 korrik të vitit 1967 Shpallur në “Gazetën zyrtare të RM-së.” nr. 5/74.

Marrëveshja e Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave tregtare (nga 14 prilli i vitit 1891, reviduar në Bruksel më 14 dhjetor të vitit 1900, në Uashington më 2 qershor të vitit 1911, në Hagë më 6 nëntor të vitit 1925, në Londër më 2 qershor të vitit 1934, në Nicë më 15 qershor të vitit 1957, në Stokholm më 14 korrik të vitit 1967 dhe plotësuar më 28 shtator të vitit 1979).

Protokoli i Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave tregtare Shpallur në “Gazetën zyrtare të RM-së” nr. 12/02 të 16 shkurtit të vitit 2002.